



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 2118, date 4.07.2012

Per

“Miratimin e Dokumentit “Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit-Dokumenti Përfundimtar””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

| | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 4. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 04.07.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e Dokumentit “Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit-Dokumenti Përfundimtar””

mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga Grupi i Punës, të përbërë nga:

- i. Relacioni shpjegues;
- ii. Dokumenti “Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit-Dokumenti Përfundimtar”;
- iii. Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485.

BAZA LIGJORE:

- 1) Shkronja ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
- 2) Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*ligji nr. 8485*), i ndryshuar;
- 3) Shkronja e) e pikes 1 dhe pika 17 e nenit 21 të “Rregullores se Brendeshme te AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues te ERT-se, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe ne fuqi sipas pikës 3 te nenit 138 te ligjit nr. 9918;
- 4) “Rregullore per analizen e tregut”, miratuar me vendimin nr. 747, date 17.07.2009, te Keshillit Drejtues te AKEP (*Rregullorja*).
- 5) Vendim Nr.1887, datë 19.04.2012 Për “Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit - Konsultim Publik”

KESHILLI DREJTUES

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Projekt-Vendimi për “*Miratimin e Dokumentit “Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit-Dokumenti Përfundimtar”*”
2. Relacioni shpjegues mbi projektvendimin (*Relacioni*),
3. Komentet e palëve të intersuara për dokumentin “*Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit - Konsultim Publik*”:
 - a. Vodafone Albania sh.a. nëpërmjet shkresës me Referencë LGD/0192/OX, datë 20.06.2012.
 - b. Albanian Mobile Communications sh.a. me shkresën Nr. 3791 Prot., datë 20.06.2012.
 - c. Eagle Mobile sh.a., me shkresën Nr.1297 Prot, datë 19.06.2012 dhe Nr.1303 Prot, datë 20.06.2012.
 - d. Plus Communications sh.a. me shkresën Nr.709 Prot., datë 19.06.2012.
 - e. Albtelecom sh.a me shkresën Nr. 3122 Prot., datë 20.06.2012.
 - f. Nefofone sh.p.k me shkresën Nr.175 Prot., datë 19.06.2012.
 - g. Alban Tirana Nascendo Al sh.p.k me shkresën Nr.Prot.23, datë 19.06.2012.
4. Dokumenti i përgatitur nga Grupi i Punës “*Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit-Dokumenti Përfundimtar*” i cili përmban si Aneks 1: *Komentet në Konsultim Publik dhe Qëndrimi i AKEP për komentet;*

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar

V E R E N:

1. Këshilli Drejtus i AKEP me vendimin nr. 1887, datë 19.04.2012, miratoi nxjerrjen në konsultim Publik të dokumentit “*Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit - Konsultim Publik*”.

2. Këshillimi publik u krye më datë 20.04.2012-20.06.2012, dhe nga palët e interesuara kanë dërguar komente operatorët Albanian Mobile Communication, Vodafone Albania, Eagle Mobile, Plus Communications, Albtelecom, Neofone dhe Alban Tirana Nascendo.
3. Dokumenti “*Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit-Dokumenti Përfundimtar*”:
 - a. është përparitur pas kryerjes së këshillimit publik të zhvilluar më 20.04.2012-20.06.2012 dhe përmban komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimin e AKEP për komentet (Aneks 1 i dokumentit) në përputhje me nenin 35 të Ligjit 9918;
 - b. përmban një dokument të rëndësishëm rregullator në bazë të të cilit merren vendimet për FNT në tregjet e analizuar dhe masat rregulluese respektive, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimet rregullatore dhe tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri;
 - c. nga pikpamja e rregullsisë, është në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin 9918 dhe Rregulloren për Analizën e tregut;
 - d. nga pikpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara për analizen e tregut në nenin 31 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, dhe Rregullores, përfshirë përkufizimin e detajuar të tregjeve përkatës dhe analizën e testit të tre kritereve, kriteret e përcaktimit FNT, dhe detyrimet e parashikuara për FNT;
 - e. ka marrë në konsideratë rekomandimet dhe direktivat e Komisionit Europian dhe praktikën më të mirë rregullatore në vendet e Bashkimit Europian, parimet e ligjit të konkurrencës dhe kushtet aktuale të tregut Shqiptar celular;
 - f. vendosja, ndryshimi, mbajtja dhe heqja e detyrimeve për FNT është në përputhje, me përcaktimet e nenit 36 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, me pikën 5 të nenit 3 të Rregullores dhe me objektivat rregullatore të AKEP, të përcaktuara në nenin 7 të ligjit 9918.

A T E H E R E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar më lart, bazuar në pikën 1 të nenin 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe pika 17, neni 21 të Rregullores së Brendëshme të AKEP, e ndryshuar, si dhe në zbatim të kompetencës ligjore të përcaktuar në shkronjën ç) të nenit 8 të ligjit nr. 9918, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S:

1. Të miratojë Dokumentin “*Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit-Dokumenti Përfundimtar*” sipas përmbajtjes në Aneks 1.
2. Dokumenti i miratuar në pikën 1 të publikohet në faqen e Internetit të AKEP www.akep.al.
3. Kundra këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Këshillin Drejtues të AKEP, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes së njoftimit përkatës.
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Alketa MUKAVELATI**
- 3. Benon PALOKA**
- 4. Zamira NURÇE**

ANEKS 1

Dokumenti “Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/originimit-Dokumenti Përfundimtar”



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

ANALIZE

E

TREGUT

TE TELEFONISE SE LEVIZSHME

1. Tregjet me shumice te terminimit te thirrjeve ne rrjete publike telefonike individuale te levizshme
2. Tregu me shumice i aksesit dhe origjinimit te thirrjeve ne rrjetet telefonike publike te levizshme

Dokument Perfundimtar

Korrik 2012

(MIRATUAR ME VKD NR.2118 DATE 4.07.2012)

INDEKSI I PERMBAJTJES

| | |
|---|-----------|
| I. PERMBLEDHJE | 4 |
| II.HYRJE | 10 |
| II.1. PANORAME E SEKTORIT TE TELEFONISE CELULARE | 10 |
| II.2 KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR PER PERCAKTIMIN E SIPERMARRESVE ME FNT | 14 |
| I. <i>Objektivat e Ligjit dhe kuadri rregullator</i> | 14 |
| II. <i>Procesi i Konsultimit</i> | 15 |
| III. <i>Bashkepunimi me Autoritetin e Konkurences</i> | 15 |
| V. <i>Perkufizimi i tregut perkates</i> | 17 |
| VI. <i>Fuqia e Ndjeshme ne Treg dhe masat rregulluese</i> | 19 |
| III. TERMINIMI I THIRRJEVE NE RRJETET CELULARE | 21 |
| III.1 PERKUFIZIMI I TREGUT TE TERMINIMIT TE THIRRJEVE NE CELULARE | 22 |
| I. <i>Dimensioni i produkteve/sherbimeve te tregut perkates te terminimit</i> | 23 |
| II. <i>Dimensioni gjeografik i tregut</i> | 27 |
| III. <i>Zhvillime pas Analize 2010 dhe zhvillime te pritshme ne vitet ne vijim</i> | 27 |
| I. <i>Pjeset e tregut</i> | 29 |
| II. <i>Konkurrenca e mundshme ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare</i> | 30 |
| III. <i>Fuqia kundervepruese e blesesve te terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare</i> | 30 |
| IV. <i>Ecuria e tarifave te terminimit ne rrjetet celulare</i> | 32 |
| V. <i>Pervoja rregullatore ne vendet e BE-se</i> | 35 |
| VI. <i>Perfundim mbi FNT</i> | 35 |
| III.3 MASAT RREGULLUESE PER TERMINIMIN E THIRRJEVE ZANORE NE RRJETET CELULARE | 37 |
| I. <i>Problemet e FNT per terminimin e thirrjeve dhe masat rregulluese</i> | 37 |
| II. <i>Detyrimet aktuale te AMC, Vodafone Albania dhe EM per FNT</i> | 40 |
| III. <i>Detyrimet per terminimin e thirrjeve hyrese nderkombetare</i> | 41 |
| IV. <i>Detyrimet e propozuara per FNT</i> | 43 |
| IV. TREGU ME SHUMICE I AKSESIT DHE ORIGJINIMIT TE THIRRJEVE NE RRJETET CELULARE | 51 |
| IV.1 PERMBLEDHJE E PERFUNDIMEVE TE ANALIZE 2010 PER AKSES/ORIGJINIMIN DHE PERDITESIM I TYRE | 51 |
| IV.2 TREGU ME PAKICE I SHERBIMEVE CELULARE | 57 |
| I. <i>Pjeset e Tregut</i> | 59 |
| II. <i>Konkurrenca e mundshme ne tregun me pakice</i> | 62 |
| III. <i>Tarifat e sherbimeve celulare</i> | 63 |
| IV. <i>Ecuria dhe niveli i normes se fitimit</i> | 67 |
| V. <i>Perdorimi i sherbimeve nga perdoruesit</i> | 68 |
| VI. <i>Kostot dhe pengesat per te nderruar operatoret: portabiliteti i numrit</i> | 69 |
| VII. <i>Sherbime te reja: 3G</i> | 70 |
| VIII. <i>Perfundim per tregun me pakice te sherbimeve celulare</i> | 71 |
| IV.3 APLIKIMI I TESTIT TE TRE KRITEREVE PER AKSES/ORIGJINIMIN | 72 |
| IV.4 PERFUNDIM MBI TREGUN ME SHUMICE TE AKSESIT DHE ORIGJINIMIT TE THIRRJEVE NE RRJETET CELULARE | 74 |
| ANEKS 1. KOMENTET NE KONSULTIM PUBLIK DHE QENDRIMI I AKEP | 76 |

INDEKSI I TABELAVE DHE FIGURAVE

| | |
|--|----|
| FIGURA II.1. ECURIA E NUMRIT TË PAJTIMARWVE CELULARË 2000-2011..... | 12 |
| FIGURA II.2 ECURIA E PENETRIMIT TË TELEFONISË CELULARE DHE FIKSE 2003-2011..... | 12 |
| FIGURA II.3: TE ARDHURAT DHE PJESET E TREGUT TE OPERATOREVE CELULARE (2011)..... | 13 |
| FIGURA III. 1: ECURIA E TARIFAVE TE TERMINIMIT NE RRJETET CELULARE 2010-AKTUALISHT..... | 32 |
| TABELA III. 1: REDUKTIMI I PËRSHKALLËZUAR I TARIFAVE TË TERMINIMIT SIPAS BU-LRAIC (LEK/MINUTE) | 33 |
| FIGURA III. 2: KRAHASIM I TARIFAVE TE TERMINIMIT NE RRJETET CELULARE NE SHQIPERI ME MESTAREN E BE DHE VENDET E RAJONIT (NENTOR 2011)..... | 34 |
| TABELA III.2: REDUKTIMI I PËRSHKALLËZUAR I TARIFAVE TË TERMINIMIT NË RRJETET CELULARE PËR ORIENTIM NË KOSTO SIPAS BU-LRAIC (LEKË/MINUTE)..... | 49 |
| FIGURA IV.1. ECURIA E NUMRIT TE PERDORUESVE TË TELEFONISË CELULARE DHE FIKSE 2000-2011..... | 57 |
| FIGURA IV.2: TE ARDHURAT E OPERATOREVE CELULARE 2003-2011..... | 58 |
| FIGURA IV.3: PJESET E TREGUT TE OPERATOREVE CELULARE (2011)..... | 60 |
| TABELA IV.1. PJESET E TREGUT TE OPERATOREVE CELULARE 2009-2011..... | 61 |
| TABELA IV.2. VLERAT E INDEKSIT HHI (2006-2011)..... | 62 |
| TABELA IV.3: MBULIMI ME RRJET TE OPERATOREVE CELULARE 2011..... | 63 |
| FIGURA IV.5: CMIMI MESATAR PER MINUTE I THIRRJEVE CELULARE (EURO PER MINUTE PA TVSH)..... | 66 |
| FIGURA IV.6: E ARDHURA MESATARE PER PERDORUES CELULAR (EURO/VIT PA TVSH)..... | 66 |

I. PERMBLEDHJE

Ligji nr.9918, date 19.05.2008 "Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise" (ne vijim Ligji 9918), ne nenin 1 te tij, percakton se qellimi i ligjit eshte qe nËpËrmjet parimit tË asnjanesisË teknologjike tË promovojË konkurrencË dhe infrastrukturË eficiente nË komunikimet elektronike dhe tË garantojË shËrbimet e duhura dhe tË pËrshtatshme nË territorin e RepublikËs sË ShqipËrisË.

Ligji Nr.9918 parashikon ne Nenin 35 te tij detyrimin per zhvillimin e procedures se keshillimit me palet e interesit per analizen e tregut duke percaktuar edhe kohezgjatjen minimale te periudhes se konsultimit publik prej 60 ditesh.

Njekohesisht neni 36 percakton se AKEP vendos, ndryshon mban ose heq detyrime per FNT pas keshillimit me palet e interesuara.

Ky dokument permban analizen e tregjeve nr.16 dhe nr.17 te Rregullores se Analizes se Tregut (ne vijim referuar si Rregullore):

- 1) Tregun me shumice te terminimit te thirrjeve ne rrjetet individuale te levizshme;
- 2) Tregun me shumice te aksesit dhe origjinimin e thirrjeve ne rrjetet telefonike publike te levizshme

Ne baze te percaktimeve te Ligjit 9918 dhe praktikes se AKEP me analizat e tregjeve, periudha e konsultimit publik u mbajt prej 60 ditesh nga data 20.04.2012 deri me 20.06.2012, dhe procesi i konsultimit u krye per statusin e FNT dhe per detyrimet e propozuara per FNT.

Ne perfundim te periudhes se konsultimit nga palet e interesuara kane derguar komente ne lidhje me kete dokument operatoret Albanian Mobile Communication, Vodafone Albania, Eagle Mobile, Plus Communications, Albtelecom, Neofone dhe Alban Tirana Nascendo.

Komentet mbi dokumentin si dhe qendrimet e mbajtura rreth ketyre komenteve nga AKEP jane te reflektuara ne dokumentin e analizes ne seksionin e fundit, "ANEKS 1".

Kjo analize e tregjeve celulare u zhvillua ne ciklin e katert te saj dhe eshte ne vijim te analizes se vitit 2010, proces i cili perfundoi me publikimin e Analizes se Tregut te Telefonise se Levizshme, ne muajin Mars 2010, dhe Vendimet e Keshillit Drejtues te AKEP, VKD nr.1210, 1211, dhe nr.1212, date 31.03.2010, per shpalljen me FNT te operatoreve AMC; Vodafone Albania dhe Eagle Mobile ne tregjet perkates te meposhtem:

- AMC:
 - o terminimi i thirrjeve nË rrjetin AMC
 - o akses/originimi i thirrjeve nË rrjete celulare

- Vodafone Albania:
 - o terminimi i thirrjeve nË rrjetin Vodafone Albania

- akses/origjinimi i thirrjeve në rrjete celulare
- Eagle Mobile:
 - terminimi i thirrjeve në rrjetin Eagle Mobile.

Ne baze të parashikimeve ligjore dhe të Rregullores, analiza përmban:

- perkufizimin e tregjeve perkatese;
- shqyrtimin e secilit treg perkates për të analizuar konkurrencen në këto tregje dhe nëse ka operatore me fuqi të ndjeshme në treg, duke përdorur kriteret e përcaktuara në nenin 33 të Ligjit si dhe udhëzimin e KE;
- analizimin e problemeve në tregjet në të cilat nuk ka konkurrence efektive apo ku ka operatore me fuqi të ndjeshme në treg;
- detyrimet (masat rregullatore) për operatorët me fuqi të ndjeshme (FNT);

Perfundime të analizës së terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare:

Megjithatë ndryshimet e ndodhura në treg në periudhën 2010-2012, kushtet e tregut që ndikojnë në perkufizimin e tregut perkates të terminimit të thirrjeve në një rrjet celular nuk kanë ndryshuar dhe nuk pritet të ndryshojnë të paktën në një periudhë afatmesme për të justifikuar një perkufizim të tregut perkates të terminimit të thirrjeve të ndryshëm nga perkufizimi i bërë në Analizat e mëparshme të AKEP dhe nga rekomandimet e KE, që terminimi i thirrjeve zanore në rrjet celular përben treg me shumicë të vecantë për secilin rrjet celular aktiv në treg.

Bazuar në përcaktimin e mesipër për secilin nga rrjetet celulare, arrihet në përfundimin se tregjet perkatese të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare janë:

- Tregu i terminimit të thirrjeve zanore në rrjetin celular AMC, shërbim i ofruar nga sipërmarrësi AMC sh.a;
- Tregu i terminimit të thirrjeve zanore në rrjetin celular Vodafone Albania, shërbim i ofruar nga sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a;
- Tregu i terminimit të thirrjeve zanore në rrjetin celular Eagle Mobile, shërbim i ofruar nga sipërmarrësi Eagle Mobile sh.a;
- Tregu i terminimit të thirrjeve në rrjetin celular Plus Communication, shërbim i ofruar nga sipërmarrësi Plus Communication sh.a;

AKEP ka marrë në konsideratë ndryshimet e ndodhura pas vitit 2010 që kanë ndikim në perkufizimin e tregut të terminimit të thirrjeve në rrjet celular si implementimi i portabilitetit të numrit celular, fillimi i ofrimit të shërbimeve në treg nga Plus Communication në Nentor 2010, dhe ofrimi i shërbimeve celulare me standartin dhe rrjetet 3G nga Vodafone Albania dhe AMC. AKEP nuk pret që në të ardhmen afat-mesme të ndodhin ndryshime të cilat mund të behen shkak për një perkufizim të ri të tregut të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë celulare, i ndryshëm nga përcaktimet e bëra në këto analize tregu.

Ne analizen e faktoreve te marre ne konsiderate per fuqine e ndjeshme ne tregjet perkates, rezulton se:

- Secili prej operatoreve AMC, Vodafone Albania, Eagle Mobile dhe Plus Communication zoteron 100 per qind te tregut te terminimit te thirrjeve ne rrjetet e tyre;
- Operoret celulare nuk perballen me kercenimin e hyrjes ne tregjet e tyre te terminimit te operatoreve te tjere, qe do te ishin te afte te kryenin edhe terminimin e thirrjeve ne keto rrjete;
- Operoret celulare ndeshen me fuqi te ulet kundervepruese nga operoret e telefonise fikse (Albtelecom dhe operoret alternative);
- Ne mungese te nderhyrjes rregullatore, cdo operator celular do te jete ne gjendje t'ju impononte operatoreve vendas tarifa te larta per terminimin e thirrjeve ne rrjetin celular qe zoteron.
- Kriteret e marra ne shqyrtim nuk kane ndryshuar dhe nuk pritet te ndryshojne te pakten ne nje periudhe afatmesme, ne menyre qe te eliminojne aftesine ndikuese te operatoreve ne tregjet perkatese te terminimit te thirrjeve.

Duke marre ne konsiderate faktoret (argumentat) e mesiperm, AKEP gjykon se operoret Vodafone Albania, AMC, Eagle Mobile dhe Plus Communication, permbushin kriteret per fuqi te ndjeshme ne tregjet perkatese te terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetet e tyre celulare:

- Operatori AMC permbush kriteret e sipermarresit me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular AMC.
- Operatori Vodafone Albania permbush kriteret e sipermarresit me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Vodafone Albania.
- Operatori Eagle Mobile permbush kriteret e sipermarresit me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Eagle Mobile.
- Operatori Plus Communication permbush kriteret e sipermarresit me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Plus Communication.

Bazuar ne gjetjet e analizes rezulton qe te kater operoret AMC, Vodafone Albania, Eagle Mobile dhe Plus Communication jane operore qe kane Fuqi te Ndjeshme ne tregun e terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetet e tyre.

Ne reference me percaktimet ligjit 9918 dhe analizen dhe vendimet e meparshme per FNT, AMC, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile, te vazhdojne ne implementimin e masave rregullatore qe aktualisht mbajne, detyrime te cilat identifikohen te domosdoshme me qellim shmangien e problemeve te tilla si mungese transparence, diskriminim ne tarifa dhe cilesi, mosdhenie aksesit apo vonesa ne dhenien e aksesit per terminimin, sigurimi i kushteve te barabarta te konkurrences midis aktoreve ne treg.

Ne menyre te permbledhur detyrimet per AMC, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile jane:

- Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)
- Detyrimi i transparencës (Neni 40)

- Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)
- Detyrimi për ndarjen e llogarive (neni 41)
- Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (Neni 45)

Ne lidhje me detyrimin për kontrollin e tarifave, do të vazhdohet zbatimi i fazave të percaktuara në VKD 1506, 1507 dhe 1508 datë 10.02.2011, sipas metodologjise të rregullimit për orientimin në kosto të tarifave të terminimit në rrjetet publike telefonike të lëvizshëm.

Operatori Plus Communication shpallet për herë të parë si operator me FNT në tregun e terminimit të thirrjeve zanore në rrjetin e tij. AKEP vlereson që Plus të ketë të njëjtat detyrime kryesore si dhe AMC, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile. Një sërë detyrimesh lidhen me publikimin e RIO dhe meqenese formati i kesaj RIO është i gatshëm, dhe RIO-t e AMC, Vodafone dhe Eagle Mobile janë të njëjta, publikimi i RIO nga Plus nuk përben një barre të rende.

Tarifa e terminimit në rrjetin Plus Communication, është përcaktuar me Vendimet e KD të AKEP nr. 1351, datë 04.08.2010, dhe Vendimet 1663-1666 datë 28.07.2011, në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjes midis këtij operatori dhe katër operatorëve me FNT, për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit. Vendimet 1663-1666 datë 28.07.2011, në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjes midis këtij operatori dhe katër operatorëve me FNT, për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit, janë në fuqi të tarifës 18.9 lek/minute dhe krahas aplikimit të reduktimit të tarifave të terminimit të tre operatorëve të tjerë asimetria aktuale është në nivele shumë të larta, rreth 150 % ndaj rrjeteve AMC dhe VF dhe rreth 113 % ndaj rrjetit EM.

Niveli i asimetrise së tarifës së Plus duhet të reduktohet duke filluar nga Shtatori 2012, që përkon me fazën e tretë të reduktimit të tarifave të tre operatorëve të tjerë celularë, dhe për fazat e mëvonshme të vazhdojë reduktimi i asimetrise për të arritur në konvergjencën në afatin e parashikuar më 1.09.2015. Në seksionin përkatës janë dhënë niveli i tarifave të terminimit për Plus Communication në secilën prej fazave (Shtatori 2012-Shtatori 2015) të propozuara në dokumentin e konsultuar si dhe formalizimi i tyre në vendimin që do të merret sipas këtij dokumenti final të analizës.

Vazhdimi i reduktimeve të tarifave të interkoneksionit në nivelet e propozuara në këtë dokument, pritet të kenë efekt pozitiv në tregjet me pakicë të shërbimeve celularë dhe të telefonisë fikse. Efekti i reduktimit të tarifave të terminimit në rrjetet celularë do të ndikojë në rritjen e konkurrencës në tregun celular me pakicë. AKEP, siç ka cituar në Shkurt 2011 për orientimin në kosto BULRAIC me reduktimin e përshkallezuar, parashikon që ndikimi i reduktimit të tarifave të terminimit në rrjetet celularë në konkurrencën në tregun me pakicë celular, të jetë më i madh se thjesht reduktimi i tarifave të thirrjeve jashtë rrjetit në masë të njëjte me reduktimin absolut të tarifave të terminimit.

Perfundime nga analiza e tregut me shumicë i aksesit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet celularë

Tregu me shumice i aksesit dhe origjinimit te thirrjeve ne rrjetet te levizshme, eshte pjese e listes se tregjeve te Rekomandimit 2003 te KE-se, por nderkohe eshte hequr nga lista e tregjeve e Rekomandimit te viti 2007 te KE. Megjithese bazuar ne rregulloren e Analizes se tregut, nuk eshte nevojshme qe te kryhet nje analize e testit te tre kriterëve nese ky treg eshte treg perkates i justifikueshem per nderhyrje ex-ante, kur tregu eshte pjese e listes se Rekomandimit 2003 te KE, AKEP bazuar ne zhvillimet e tregut ne keto dy vite ka gjykuar si te nevojshme kryerjen e testit te tre kriterëve.

Para analizes se testit te tre kriterëve, AKEP ka bere nje rishikim te perfundimeve te Analize 2010 per kete treg si dhe vleresim te zhvillimeve te tregut me pakice celular, pasi tregu i aksesit/origjinimit edhe gjate analizes se bere ne vitin 2010, u trajtua si nje treg i lidhur ngushtesisht me tregun e pakices. AKEP i ka kushtuar nje seksion te vecante analizes se zhvillimeve ne tregun celular me pakice duke konkluduar se ky treg ka shenuar zhvillime pozitive ne dy vitet e fundit dhe konkurrenca midis operatoreve eshte rritur ndjeshem dhe pritet te rritet akoma me shume ne te ardhmen. Nje perfundim i tille eshte bazuar ne tregues te tille si:

- Renia e pjeseve te tregut te AMC dhe Vodafoe Albania dhe rritja e pjeseve te tregut per hyresit me te rinj ne treg Eagle Mobile dhe Plus Communication;
- Reduktimi i tarifave celulare te perdoruesve ku tregues te tille si shpenzimet per shportat OECD kane shenuar reduktime te ndjeshme, e ardhura mestare per minute eshte nder me te uletat ne rajon dhe dy here me ulet se mesatarja e BE si dhe ARPU eshte me e ulet se mesatarja e BE-se, ne me shume se 3 here dhe me e vogel se niveli me i ulet i ARPU ne vendet e BE;
- Pritshmeria per nje konkurrenca akoma me te madhe nga reduktimi dhe orientimi ne kostot BULRAIC i tarifave te terminimit ne rrjetet celulare si dhe reduktimet e metejshme ne tarifat e terminimit te SMS-ve;
- Reduktimi i te ardhurave, fitimeve dhe nomrave te fitimit te AMC dhe Vodafoe Albania;
- Rritja e ndjeshme e perdorimit mesatar te thirrjeve telefonike ne periudhen 2010-2011 krahasuar me periudhat e meparshme;
- Rritja e perfitimeve te perdoruesve nga implementimi i portabilitetit te numrit celular dhe fillimi i ofrimit te sherbimeve 3G nga dy operatore

Direktivat dhe rekomandimet e KE per tregjet perkates, e bejne te qarte se qe nje treg te jete i justifikueshem per nderhyrje ex-ante, duhet te realizohen te tre kushtet. Nese edhe njeri prej tyre nuk realizohet atehere tregu nuk mund te konsiderohet si treg i justifikueshem per nderhyrje ex-ante. Ne rekomandimin e vitit 2007 Komisioni ka shpjeguar edhe arsyet kryesore per heqjen e tregut te aksesit origjinimit te thirrjeve celulare nga lista e tregjeve perkates, arsyetime te cilat jane perdorur edhe nga AKEP si pike reference per aplikimin e ketij testi ne kushtet e tregut ne Shqiperi.

1. Prezenca e barrierave te larta dhe jo-kalimtare te hyrjes:

Faktoret e marre ne konsiderate per kete kriter rezultojne jo determinues pasi ka argumenta pro dhe kunder. Megjithate AKEP gjykon se argumentat pro prezences se pengesave jane me te forte dhe per kete arsye gjykon se Kriteri 1 i testit permbushet.

2. Nje strukture tregu e cila nuk ka tendence per te shkuar ne drejtimin te nje konkurrence efektive brenda afatit kohor perkates:

AKEP ka kryer edhe nje analize te zhvillimeve kreysore ne tregun me pakice celular dhe nivelin e konkurrences ne kete treg duke konkluduar se konkurrenca ne nivelin me pakice celulare eshte intensifikuar ndjeshem ne dy vitet e fundit si dhe pritshmerite jane qe kjo konkurrenca te rritet akoma dhe me shume ne te ardhmen. Nga analiza e tregut me pakice rezultoi gjithashtu se pjeset e tregut te dy operatoreve AMC dhe Vodafone kane filluar te kene ndryshime te ndjeshme me njeri tjetrin, ne te kundert te pjeseve te tregut te ngjashme ne vitet e meparshme. AKEP gjykon se Kriteri 2 i testit nuk permbushet

3. Pamjaftueshmeria e ligjit te konkurrences per te adresuar ne menyre te pershtatshme deshtimin e tregut te marre ne shqyrtim:

Situata ne Shqiperi ku ne treg tashme jane kater operatore dhe pjeset e tregut te dy operatoreve te medhenj jane reduktuar dhe nuk jane me te ngjashme, mundesite per sjellje te koordinuar te dy operatoreve jane reduktuar ndjeshem dhe sidomos mundesite e sjelljes se koordinuar nga kater operatore jane shume here me te vogla. Sikurse citohet dhe nga KE ky problem mund te zgjidhet nepermjet ligjit te konkurrences. AKEP gjykon se Kriteri 3 i testit nuk permbushet

Meqenese nga tre kriteret plotesohet vetem njeri prej tyre dhe dy te tjeret nuk plotesohen, ne perputhje me rregulloren e analizes se tregut dhe rekomandimet e KE, AKEP ka arritur ne perfundimin se tregu me shumice i aksesit dhe origjinimit te thirrjeve ne rrjetet celulare nuk ploteson testin e tre kriterëve dhe nuk konsiderohet si treg i justifikueshem per nderhyrje ex-ante. Ne baze te nenit 34, pika 3 te ligjit 9918, AKEP, keshtu qe heqja e detyrimeve aktuale per FNT te AMC dhe Vodafone Albania te percaktuara me VKD nr.1210 dhe nr.1211, date 30.03.2011, te behet efektiv 6 muaj pas marrjes se vendimit nga AKEP per FNT ne tregjet celulare, sipas ketij dokumenti.

Nese, pas kesaj periudhe te heqjes se detyrimeve ne treg do te shfaqet ndonje kerkese per ofrim te sherbimeve te cdo lloj forme te MVNO-s, ne mungese te arrijtes se marreveshjeve me operatoret celulare ne treg mbi baza komerciale per ofrimin e sherbimeve te kerkuara, atehere AKEP nderhyn duke e zgjidhur si nje mosmarreveshje me kompetencat qe ligji 9918 (neni 120) percakton.

II.HYRJE

II.1. PANORAME E SEKTORIT TE TELEFONISE CELULARE

Ne sektorin e telefonise celulare jane leshuar kater autorizime individuale (me pare licensa):

- AMC sh.a,
- Vodafone Albania, sh.a
- Eagle Mobile, sh.a
- Plus Communication sh.a

Operatori AMC eshte licensuar si operator publik kombetar i telefonise celulare ne vitin 1996 dhe ka funksionuar si kompani shtetore deri ne Shtator te vitit 2000, kur u krye privatizimi i 85 per qind te aksioneve¹, pjese e cila u ble nga Cosmote Group², operatori celular ne Greqi, e cila eshte vete pjese e grupit OTE, operatorit te telefonise fikse ne Greqi. Ministria e Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes zoteroi rreth 12.6% te aksioneve te AMC Sh.a, deri ne vitin 2008, kur u krye dhe shitja e kesaj pjese Cosmote Group. Afersisht 2.4% te aksioneve zoteroreshin nga aksionere te vegjel (punonjes te AMC ne kohen e privatizimit) te cilat me pas jane blere nga Cosmote Group.

Operatori Vodafone Albania eshte licensuar si operatori i dyte kombetar i sherbimit celular GSM ne Shqiperi me 9 Qershor 2001. Vodafone International Holding zoteron 51 per qind te kapitalit te Vodafone Albania, ndersa Vodafone Panafon International Holdings zoteron 49 per qind te aksioneve. (Kjo e fundit zoterohet ne menyre direkte dhe indirekte ne 99,4 per qind nga Vodafone Group). Ne 3 Gusht 2001 Vodafone Albania filloi ofrimin e sherbimeve te saj GSM ne Shqipëri.

Operatori “Eagle Mobile” eshte licensuar si operatori i trete kombetar i sherbimit celular GSM ne Shqiperi me 1 Mars 2004. Licensa i eshte dhene Albtelecom si pjese e paketes se privatizimit te kesaj kompanie, proces i cili perfundoi ne vitin 2007. Operatori Eagle Mobile filloi ofrimin e sherbimeve celulare ne Mars 2008.

Operatori Plus Communication (me pare Mobile 4 Al) eshte operatori i katert celular GSM, te cilit i akordua autorizimi individual nga AKEP me date 26.06.2009. Autorizimi individual iu dha konsorciumit te perfaqesuar nga Poste Telekomunikacioni i Kosoves (PTK) ne baze te Ligjit nr.10118, date 23.04.2009 “Për dhënien e së drejtës së përdorimit, për 15 vjet, në brezin e frekuencave E-GSM dhe GSM 1800, bashkimit të ofertuesve, përfaqesuar nga Postë Telekomunikacioni i Kosovës Sh.a., sipas procedurës “Tender i hapur ndërkombëtar”, e datës

¹ Kontrata e shitjes se aksioneve te AMC, eshte ratifikuar ne Kuvendin e Republikes se Shqiperise me Ligjin nr. 8660, date 18.09.2000.

² Cosmoholding Albania zoteron 85% te AMC sh.a. Cosmote Mobile Telecommunications S.A. zoteron 97% te Cosmoholding Albania. 3% e kesaj te fundit zoterohet nga Telenor International A.S.

20.02.2009". Plus Communication filloi ofrimin e shërbimeve të telefonisë së lëvizshme në fund të muajit Nentor 2010.

Te këta operatorë ofrojnë shërbime në gjeneratën e dytë (2 dhe 2.5G) të standartit GSM në frekuencat 900/1800 MHz, ndërsa Vodafone Albania dhe AMC ofrojnë gjithashtu shërbime bazuar në UMTS apo gjeneratën e tretë 3G, pasi janë pajisur me autorizime individuale për frekuencat 1900-2100 MHz në vitet 2010-2011.

Në fund të vitit 2011, numri i pajtimtarëve të telefonisë së lëvizshme arriti në afërsisht 5.2 milion, e cila përbën një normë penetrimi (numri i përdoruesve për 100 banorë) prej 185%³, një shifer e cila është shumë më e lartë se niveli prej 140% në vitin 2010⁴ apo niveli mesatar në vendet e BE prej 124% në 2010. Sic është shpjeguar në shënim numri i pajtimtarëve celularë i referohet numrit të kartave SIM aktive, dhe politikat e operatorëve janë që një kartë SIM mund të jetë aktive për një vit nga momenti kryerjes së thirrjes së parë, dhe nëse koha e bisedës përfundon para aftit 1 vjeçar pajtimtari mund të marrë thirrje hyrëse për 6 muaj. Ndërkohë nëse do të referoheshim numrit të pajtimtarëve që kanë kryer komunikim në tre muajt e fundit (aktivë), numri i pajtimtarëve celularë në fund të vitit 2011 do të ishte 3,108,087 (norma e penetrimit 110%) krahasuar me 3,157,404 në fund të 2010. AKEP gjykon se ndryshimi në vlerat e cituara më sipër ndodh për shkak se në shifrën numrit të kartave SIM referuar më sipër ka një numër të konsiderueshëm pajtimtarësh me përdorim sezonal, si p.sh emigrantë apo vizitorët në Shqipëri, si edhe një numër pajtimtarësh që mund të mos e përdorin më një kartë SIM, megjithëse ajo rezulton aktive. Megjithatë në referencat tjera në këtë analizë, AKEP i referohet numrit të kartave SIM aktive si numri i pajtimtarëve celularë, pasi kjo është praktikë që ndiqet edhe në vendet e tjera.⁵


Norma vjetore e rritjes së numrit të përdoruesve ishte rreth 15% (rreth 690 mijë përdorues më shumë), që është më e lartë se norma vjetore e rritjes prej 9% në vitin 2010. Gjatë vitit 2011 rritje më të madhe ka pasur operatori më i ri në treg Plus Communication me rreth 370 mijë pajtimtarë më shumë se 2010, i pasuar nga Eagle Mobile me rreth 290 mijë apo 35% rritje dhe Vodafone me 8% rritje vjetore. AMC operatori më i madh në treg për sa i përket numrit të pajtimtarëve ka pasur reduktim me 5% të tyre. Përdoruesit me parapagim vazhdojnë të përbëjnë më shumë se 90% të përdoruesve celularë dhe kjo strukturë abonentësh është e ngjashme në të katër operatorët. Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve celularë sipas operatorëve në periudhën 2000-2011

³ Numri i përdoruesve celularë i referohet numrit të kartave SIM aktive, dhe normat e larta të përdoruesve për 100 banorë shpjegohen nga mbajtja prej një individi e më shumë se 1 kartë SIM si dhe prej përdorimit të kartave SIM nga vizitorët në një vend.

⁴ Në këtë analizë, shifra e përdorur për popullsinë për vitin 2011 është rezultati paraprak i Census 2011 i publikuar nga Instat: 2,831,741. Treguesit e penetrimit (përdorimi në bazë të popullsisë) janë më të lartë se çdo tjetër po të përdorej numri i popullsisë sipas parashikimeve të mëparshme.

⁵ Mali i Zi ka normë penetrimi të telefonisë celule afërsisht 200%, e cila i dedikohet numrit të lartë të vizitorve/turistëve në raport me popullsinë rezidente të këtij vendi.


FIGURA II.1. ECURIA E NUMRIT TË PAJTIMARWVE CELULARË 2000-2011



Burimi: Të dhënat periodike të operatorëve.


Figura e mëposhtme paraqet ecurinë ndër vite të normes së penetrimit të telefonisë fikse dhe celulare, ku vëhet re rritja shumë e madhe e telefonisë celulare dhe rritja shumë e vogël e telefonisë fikse.

FIGURA II.2 ECURIA E PENETRIMIT TË TELEFONISË CELULARE DHE FIKSE 2003-2011



Te ardhurat totale te kater operatoreve celulare gjate vitit 2011⁶ ishin 39.2 miliard leke, qe perben nje reduktim prej 6% ne krahasim me vitin 2010, kur te ardhurat ishin 41.9 miliard leke. Renia e te ardhurave te ketij segmenti te tregut ka filluar ne 2009 dhe renia vjetore ne 2010 ka gene me madhe me 11%.

FIGURA II.3: TE ARDHURAT DHE PJESET E TREGUT TE OPERATOREVE CELULARE (2011)



Nder ndryshimet kryesore ne tregun e telefonise celulare qe prej vitit 2010 jane:

- Hyrja ne treg e Plus Communication qe filloi ofrimin e sherbimeve ne fund te muajit nentor 2010, duke e cuar ne 4 numrin e operatoreve celulare aktiv ne treg me standartin GSM;
- Dhenia e autorizimeve per Vodafone Albania (Nentor 2010) dhe AMC (Shtator 2011) per frekuencat 1900/2100 MHz per 3G, duke mundesuar ofrimin e sherbimeve broadband nepermjet rrjeteve celulare;
- Implementimi i portabilitetit te numrit celular ne Maj 2011. Deri ne fund te vitit 2011 jane portuar rreth 40 mije numra celular.

Nje panorame dhe analize me e detajuar e ndryshimeve dhe situates ne segmentin me pakice te sherbimeve celulare eshte dhene ne Kapitullin IV ne kete dokument analize tregu.

⁶ Sic eshte cituar edhe me lart, të dhënat financiare për vitin 2011, nuk janë të disponueshme për AKEP deri më 10.04.2012, kështu që te dhenat ne kete seksion i referohen vitit 2010.

II.2 Kuadri ligjor dhe rregullator per percaktimin e sipermarresve me FNT

I. Objektivat e Ligjit dhe kuadri rregullator

Ligji nr.9918, date 19.05.2008 "Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise" (ne vijim Ligji 9918) qe hyri ne force me 26.06.2009, ne nenin 1 te tij, percakton se qellimi i ligjit eshte qe nËpËrmjet parimit tË asnjansisË teknologjike tË promovojË konkurrencËn dhe infrastrukturË efiçente nË komunikimet elektronike dhe tË garantojË shËrbimet e duhura dhe tË pËrshtatshme nË territorin e RepublikËs sË ShqipËrisË.

Neni 7 i Ligjit 9918, Objektivat Rregullatore, percakton midis te tjerave:

AKEP-i nxit konkurrencËn efiçente pËr sigurimin e rrjeteve dhe tË shËrbimeve tË komunikimeve elektronike, facilitetet shoqËruese dhe shËrbimet e tjera:

a) pËr t'u krijuar mundËsinË çdo kategorie pËrdoruesish tË shËrbimeve tË komunikimeve elektronike, pËrfshirË edhe pËrdoruesit me nevoja tË veçanta, qË kundrejt tarifave nË çdo rast jo mË tË larta se tarifat mesatare tË vendeve tË BE-sË, mbi bazËn e pËrzgjedhjes tË pËrfitojnË maksimalisht shËrbime alternative, cilËsore dhe nË pËrputhje me standardet e miratuara nga AKEP-i;

b) pËr tË mbrojtur interesat e pËrdoruesve tË shËrbimeve tË komunikimeve elektronike, pËr tË mbrojtur tË dhËnat personale dhe privatËsinË e pËrdoruesve;

c) pËr tË siguruar konkurrencËn e lirË dhe efektive nË sektorin e komunikimeve elektronike;

d) pËr tË siguruar integritetin dhe sigurinË e rrjeteve tË komunikimeve elektronike publike;

dh) pËr tË nxitur investimet efiçente nË infrastrukturËn e komunikimeve elektronike dhe zhvillimet e reja teknologjike pËr njË cilËsi tË lartË tË produkteve tË tyre;

Ë) pËr tË siguruar mosdiskriminimin dhe barazinË nË trajtimin e ofruesve tË rrjeteve dhe shËrbimeve tË komunikimeve elektronike.

Kapitulli VI, Rregullimi i Konkurrences, permban percaktimet per rregullimin e konkurrences ne tregun e komunikimeve elektronike, dhe perfshin ndermjet te tjerave detyrimin e AKEP per kryerjen e analizes se tregut per vleresimin e konkurrences efektive dhe percaktimin e sipermarresve me fuqi te ndjeshme ne treg. Kreu VI, permban gjithashtu kriteret e perdorura nga AKEP per vleresimin e fuqise se ndjeshme ne treg, detyrimet/masat rregulluese ne rast te gjetjes se FNT.

Pika 4 e nenit 31, parashikon detyrimin per nje rregullore per analizen e tregjeve dhe percaktimin e FNT. AKEP me vendimin Nr.747, date 17.07.2009, ka miratuar Rregulloren per Analizen e Tregjeve (ne vijim referuara si Rregullorja). Rregullorja percakton midis te tjerave nje liste prej 18 tregje per tu analizuar nga AKEP per FNT, si dhe detyrimin per te kryer analizen e tre kriterëve per tregjet qe nuk jane pjese e rekomandimit Rekomandimit te Komisionit Europian, datË 11 Shkurt 2003.

Ligji 9918 është në linjë me direktivat e KE të vitit 2003 dhe metodologjia e analizës së tregjeve e përcaktuar në Ligj dhe në Rregullore, përcakton se AKEP duhet të marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit Europian.

Disa nga Rekomandimet dhe udhëzimet e KE-së të marra në konsideratë nga AKEP janë si më poshtë:

- Udhëzuesi e komisionit për analizën e tregut dhe vlerësimin e FNT (2002/C 165/03) sipas kuadrit rregullator për komunikimet elektronike, rrjetet dhe shërbimet të komunikimit elektronik (në vijim referuar si Udhëzimi i KE)
- Rekomandimi i Komisionit, datë 11 shkurt 2003, për produktet dhe shërbimet përkatëse të tregut brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregullara *ex ante* në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit në një kuadër të përgjithshëm rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik (2003/311/EC, OJ L 114, 8.5.2003, p. 45)
- Rekomandimi i Komisionit, datë 17 dhjetor 2007 për produktet dhe shërbimet përkatëse brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregulluara *ex ante* në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit në një kuadër të përgjithshëm rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik (2007/879/EC, OJ L 344, 28.12.2007, p. 65)

II. Procesi i Konsultimit

Ligji Nr.9918 dt. 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në RSH”, parashikon në Nenin 35 të tij, procedurën e keshillimit me paletë e interesit për analizën e tregut duke vendosur si afat, periudhën kohore prej 60 ditësh. Njekoheresisht nëni 36 përcakton se AKEP vendos, ndryshon, mban ose heq detyrime për FNT pas keshillimit me paletë e interesuara.

Në bazë të përcaktimeve të Ligjit 9918 dhe praktikës së AKEP me analizat e tregjeve, periudha e konsultimit publik ishte 60 ditë nga dita e publikimit zyrtar të këtij dokumenti në faqen e internetit të AKEP me 20.04.2012, dhe procesi i konsultimit u kryt për statusin e FNT dhe për detyrimet e propozuara për FNT. Në përfundim të procesit të konsultimit publik, 7 operatorë kanë dërguar komente për dokumentin e analizës. Komentet e paleve të interesuara së bashku qëndrimin e AKEP për to, janë publikuar në Aneks 1 të këtij dokumenti final të Analizës.

III. Bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës

Sipas Nenit 38 të Ligjit Nr.9918 dt. 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në RSH”, AKEP-i duhet të bashkëpunojë me Autoritetin e Konkurrencës. Gjithashtu AKEP dhe Autoriteti i Konkurrencës kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me datë 29.08.2007, ku midis të tjerave “Neni 6”, parashikon bashkëpunimin midis dy autoriteteve për përcaktimin e tregut, përcaktimin e dominancës / përcaktimi i FNT.

AKEP i ka kerkuar AK te shprehe opinionin e vet ne lidhje me dokumentin “Analize e Tregut te Telefonise celulare: Tregjet me shumice te terminimit dhe akses/origjinimit te thirrjeve ne rrjetet celulare: Konsultim Publik”. Perfundimet e analizes per konsultim publik ishin edhe objekt diskutimi ne takimin AKEP-AK me date 25.06.2012.

IV. Struktura e Dokumentit

Ky dokument permban analizen e tregjeve me shumice te terminimit ne rrjetet celulare si dhe tregun me shumice te akses/origjinimit ne rrjetet celulare, apo tregjet nr. 16 dhe 17 te Rregullores:

- 1) Tregjet me shumice te terminimit te thirrjeve per rrjete publike telefonike te levizshme individuale
- 2) Tregun me shumice te aksesit dhe origjinimin e thirrjeve ne rrjetet telefonike publike te levizshme

Kjo analize e tregjeve celulare mbahet pas analizes te vitit 2010, proces i cili perfundoi me publikimin e Analizes se Tregut te Telefonise se Levizshme, Dokumenti Perfundimtar, ne Mars 2010 si dhe Vendimet e Keshillit Drejtues te AKEP, VKD nr.1210; 1211, dhe 1212 date 31.03.2011, per shpalljen me FNT te AMC ; Vodafone Albania si dhe Eagle Mobile ne tregjet perkates me shumice te meposhtem:

- AMC: Tregu i terminimit te thirrjeve në rrjetin e AMC dhe tregu i akses/origjinimit te thirrjeve ne rrjetet celulare te shumices.
- Vodafone Albania:Tregu i terminimit te thirrjeve ne rrjetin Vodafone Albania tregu i akses/origjinimit te thirrjeve ne rrjetet celulare.
- Eagle Mobile:Tregu i terminimit te thirrjeve ne rrjetin e Eagle Mobile.

Ne baze te parashikimeve te Rregullores, analiza permban:

- perkufizimin e tregjeve perkatese;
- shqyrtimin e secilit treg perkates per te analizuar konkurrencen ne keto tregje dhe nese ka operatore me fuqi te ndjeshme ne treg, duke perdorur kriteret e percaktuara ne nenin 33 te Ligjit si dhe udhezimin e KE;
- analizimin e problemeve ne tregjet ne te cilat nuk ka konkurrence efektive apo ku ka operatore me fuqi te ndjeshme ne treg;
- detyrimet per operatoren me fuqi te ndjeshme ne treg;

Duke qene se kjo analize per telefonine celulare eshte ne ciklin e trete te saj, disa pjese te arsyetimeve teorike dhe koncepteve teknike ruajne te njejtin format duke iu referuar edhe dokumenteve te meparshem dhe ne shume pjese perben edhe rishikim te perfundimeve te analizes se meparshme.

Pjese te tilla perfshijne metodologjine e perkufizimit te tregut perkates, ne aspektin e produkteve dhe sherbimeve qe jane pjese e te njejtit treg perkates, kriterëve te perdorura per FNT apo dominance individuale.

V. Perkufizimi i tregut perkates

Ne kuader te analizave te kryera nga nje rregullator per qellime te analizes se konkurrences efektive dhe percaktimit te sipermarresit/sipermarresve me FNT, analiza e nje tregu perkates fillon me shqyrtimin e produkteve dhe sherbimeve qe konsiderohen te jene pjese e te njejtit treg.

Ne Analize 2007, 2009-2010 ERT (AKEP) ka perdorur perkufizimin e tregut perkates te dhene ne Rregullore 2005, perkufizim i marre nga Ligji per Mbrojtjen e Konkurrences:

***Treg perkates**- jane produktet qe vleresohen si te zevendesueshme nga konsumatorët ose klientët e tyre, per sa u perket karakteristikeve, çmimit dhe funksionit te tyre dhe qe ofrohen ose kerkohen nga ndermarrjet ne nje zone gjeografike me kushte te njejta konkurrençe, zone kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese.*

Ky perkufizim i Ligjit nr.9121, date 28.7.2003 “Per Mbrojtjen e Konkurrences” i ndryshuar, neni 3, pika 7, eshte i ngjashem me perkufizimin e dhene ne Udhezimin e KE, pika 44⁷, udhezim i perdorur nga ERT ne Analize 2007. Per kete arsye si dhe duke qene se udhezimi i KE, eshte pjese e dokumentave te KE te referuara ne Rregullore per analizen e tregut te miratuar me VKD nr.747, date 17.07.2009, AKEP ne kete Analize do te perdore te njejten metodologji per percaktimin e produkteve/sherbimeve qe jane pjese e te njejtit treg perkates, si dhe ne Analize 2007, sic eshte shtjelluar dhe ne paragrafet ne vijim.

Perkufizimi i tregut per nje produkt/sherbim merr parasysh efektin e zevendesueshmerise se produktit/sherbimit (ne anen e kerkeses dhe ofertes), si edhe dimensionin gjeografik. Nje instrument ndihmes qe perdoret per identifikimin e tregjeve eshte parimi i monopolistit hipotetik.

Parimi i monopolistit hipotetik

Nje produkt konsiderohet te perbeje nje treg me vete nese “monopolisti” (hipotetik) qe ofron produktin mund te rrise çmimin e ketij produkti per nje periudhe kohe jo tranzitore dhe te mos kete renie ne shitje deri ne nivelin qe kjo te jete jo- fitimprures. Pra, rritja e çmimit duhet te jete fitimprures dhe e qendrushme-monopolisti te kete aftesine te mbaje çmimin mbi nivelin konkurrues.

Testi i monopolistit hipotetik kryhet per te analizuar produktet/sherbimet te cilat mund te bejne pjese ne te njejtin treg duke marre ne konsiderate efektin e zevendesueshmerise se produkteve ne anen e kerkeses dhe/ose ofertes. Nese monopolisti perballet me kufizime nga ana e kerkeses-konsumatorët do te zhvendosen drejt konsumit te nje produkti tjeter, qe do ishte zevendesues dhe, nga ana e ofruesve- ofrues te tjere do te futeshin ne kete treg per te ofruar produktin me çmim dhe perfitim te larte, atehere produktet e tjera qe jane zevendesues te ngushte te produktit te analizuar duhet te perfshihen ne kete treg.

⁷ According to settled case-law, the relevant product/service market comprises all those products or services that are sufficiently interchangeable or substitutable, not only in terms of their objective characteristics, by virtue of which they are particularly suitable for satisfying the constant needs of consumers, their prices or their intended use, but also in terms of the conditions of competition and/or the structure of supply and demand on the market in question (32). Products or services which are only to a small, or relative degree interchangeable with each other do not form part of the same market (33). NRAs should thus commence the exercise of defining the relevant product or service market by grouping together products or services that are used by consumers for the same purposes (end use).

Zevendesimi ne anen e kerkeses

Nese nje subjekt, qe eshte monopol ne ofrimin e nje produkti/sherbimi, do te rriste çmimin e ketij produkti, çfare mundesish kane konsumatorët te zevendesojne perdorimin e ketij produkti me nje tjetër ?

Produkti/sherbimi qe analizohet krahasohet me produkte te tjere, nese ato mund te zevendesohen nga ana e konsumatorit. Nese konsumatorët mund te zevendesojne produktin e ofruar nga monopolisti hipotetik me nje produkt apo produkte te tjera, keto te fundit duhet te perfshihen ne perkufizimin e tregut perkates.

Zevendesimi ne anen e ofertes

Nese monopolisti hipotetik do te rriste çmimin e produktit/sherbimit per nje periudhe kohe jo tranzitore, a do te kishte presion nga ofrues te tjere te mundshem te ketij sherbimi? Operatore te tjere, te cilet nuk e ofrojne sherbimin ne fjale, mund te zhvendosin burimet e tyre ne drejtim te ofrimit te ketij sherbimi.

Ne zevendesimin ne anen e ofertes duhet te merren parasysh vetem operatoret, te cilet mund te zhvendosin burimet e tyre drejt ofrimit te sherbimit te marre ne konsiderate, per nje kohe te shkurter dhe pa kosto te larta te pakthyeshme. Pra, operatore te rinj qe nuk jane ne treg nuk mund te merren parasysh, pasi reagimi i tyre ndaj nje rritjeje te çmimit te produktit nuk do te ishte i shpejte (ne periudhe afatshkurter) por do te kerkonte kohe per investime kapitale qe kerkojne nje periudhe afatgjate. Ofruesit e mundshem jane operatore qe ofrojne sherbime te tjera dhe lehtesisht per nje periudhe kohe te shkurter mund te prodhojne edhe produktin, çmimi i te cilit eshte rritur.

Efekti i operatoreve te rinj ne treg, qe duhet te kryejne investime kapitale, merret ne konsiderate vetem ne analizen e fuqise se ndjeshme ne treg, pra te konkurrences se mundshme qe keta operatore mund te ushtrojne.

Nje faktor tjetër qe merret ne konsiderate ne perkufizimin e tregut perkates eshte nese ekzistojne kufizime te perbashketa ne tarifim (common pricing constraints) midis klienteve, sherbimeve apo zonave te ndryshme. Kjo do te thote qe operatori te mos jete i pavarur ne tarifimin e sherbimeve te ndryshme: s'ka mundesi te rrise çmimin e nje sherbimi pa reduktuar çmimin e nje sherbimi tjetër, i cili ne vetevete nuk eshte zevendesues per sherbimin tjetër.

Nderkohe para se te behet percaktimi i produkteve/sherbimeve qe jane pjese e te njejtit treg perkates, eshte e nevojshme te behet nje analize nese tregu i sherbimit/sherbimeve te marra ne shqyrtim eshte treg perkates i justifikueshem per nderhyrje ex-ante. Detyrimi per kryerjen e kesaj analize eshte pjese e Rregullores, Pika 4 e nenit 3, e cila percakton:

Nese nje treg i analizuar nga AKEP nuk eshte pjese e listes se Rekomandimit te KE te dates 11 Shkurt 2003 (2003/311/EC), atehere AKEP vlereson gjithashtu nese ky treg ploteson tre kriteret e meposhteme :

- I. prezenca e barrierave te larta dhe jo-kalimtare te hyrjes ;*
- II. nje strukture tregu e cila nuk ka tendence per te shkuar ne drejtimin te nje konkurrence efektive brenda afatit kohor perkates; dhe*

III. pamajftueshmeria e ligjit te konkurences per te adresuar ne menyre te pershtatshme deshtimin e tregut te marre ne shqyrtim

VI. Fuqia e Ndjeshme ne Treg dhe masat rregulluese

Pekufizimi i FNT eshte dhene ne nenin 33 te ligjit:

Një sipërmarrës vlerësohet me fuqi të ndjeshme në treg nëse, i vetëm, apo së bashku me të tjerë, zotëron një pozitë të tillë ekonomike, që i mundëson një zgjerim të ndjeshëm, pavarësisht nga konkurrentët, klientët apo përdoruesit fundorë.

Ky perkufizimi eshte pothuajse i njejte me perkufizimin e Direktives Kuader te KE 2002, neni 14⁸ (EC 2002 Framework Directive).

Neni 33 i Ligjit percakton gjithashtu kriteret kryesore qe duhet merren ne konsiderate per analizen per FNT, duke bere nje ndarje per rastet kur ne treg dyshohet per nje sipermarres me FNT, qe do te thote dominance individuale, dhe per raste kur dyshohet per me shume se nje sipermarres me FNT apo dominance e bashkuar. Perkufizimi i dominances se bashkuar i dhene ne nenin 33 eshte si vijon:

Dy ose më shumë sipërmarrës vlerësohen se kanë një pozitë zotëruese nëse edhe në mungesë të lidhjeve strukturore apo të lidhjeve të tjera, veprojnë në treg në një strukturë dhe mënyrë të tillë, e cilatë çon në një sjellje të bashkërenduar, në mënyrë të pavarur nga konkurrentët, klientët ose përdoruesit.

Per percaktimin e FNT, dominace individuale apo e bashkuar, sic theksohet dhe ne pikat 79 dhe 98 te Udhezimit te KE, kriteret e perdorur duhen marre te gjithë ne konsiderate dhe ne kombinim me njeri tjetrin dhe jo ne menyre te vecante per secilin kriter me vete, pasi evidenca e kritereve te vecante mund te mos jete percaktuese e FNT.

Analiza per FNT eshte nje analize e cila merr ne konsiderate zhvillimet e kaluara dhe njekoheisht tendencen per te ardhmen (forward looking), pasi mungesa e konkurrences ne te kaluaren nuk do te thote qe nje treg nuk ka tendence per te qene ne konkurrence ne te ardhmen. Ne kete menyre Analiza krahas shqyrtimit te kritereve per vleresimin e konkurrences efektive ne treg ne te kaluaren, ben vleresin se si pritet te evoluojë tregu ne te ardhmen. Analiza kryhet per te shqyrtuar nese nje treg perkates vleresohet te jete ne konkurrence efektive ne nje periudhe te pakten 2 vjecare, dhe mungesa e konkurrences efektive ne nje treg perkates te justifikueshem per nderhyrje ex-ante eshte e barazvlefshme me ekzistencen e fuqise se ndjeshme ne treg, prej nje ose me shume sipermarresish.

⁸ *‘an undertaking shall be deemed to have significant market power if, either individually or jointly with others, it enjoys a position equivalent to dominance, that is to say a position of economic strength affording it the power to behave to an appreciable extent independently of competitors customers and ultimately consumers’*

Ekzistenca e FNT do te thote qe ne treg ka probleme te cilat identifikohen dhe ne baze te problemeve te evidentuara, propozohet marrja masave rregulluese apo detyrimeve per tu zbatuar nga sipermarresi/sipermarresit me FNT. AKEP ne baze te nenit 34, ka detyrimin qe ne rast te gjetjes se FNT ne nje treg perkates te vendose nje disa apo te gjitha detyrimet e cilesuara ne nenet 39-45 dhe neni 56 te Ligjit. Vendorsja e detyrimeve/masave rregulluese per FNT duhet te marre ne konsiderate objektivat rregullatore te percaktuar ne Ligj.

Nese nga analiza arrihet ne perfundimin se tregu perkates eshte ne konkurrence efektive, pra nuk ka FNT, atehere AKEP nuk vendos detyrime dhe ne rast se ndaj sipermarresve jane vendosur detyrime (per shkak te statusit te meparshem me FNT) atehere AKEP i heq keto detyrime duke percaktuar dhe nje afat kohor jo me te gjate se 6 muaj per berjen efektive te tyre. Ky percaktim aplikohet edhe per tregjet e analizuara, por qe nuk permbushin testin e tre kriterëve per nevojen per nderhyrje ex-ante.

III. TERMINIMI I THIRRJEVE NE RRJETET CELULARE

Terminimi është një nga shërbimet e interkoneksionit të analizuar edhe në raundin e analizave të mbajtura në vitin 2006, 2007 si dhe 2009-2010, dhe si i tillë edhe në këto analize mbart me vetë aspekte teorike dhe arsyetime të trajtuara edhe më parë në dokumentet e analizave të sipërcituara.

Por në këto dokumente analize ky shërbim do të ketë vëmendje të veçantë dhe arsyetim të zgjeruar në aspektet e nevojshme të tij, dhe për raste të përkrahme të përgjithshme mund të referohet në dokumentet e mëparshme të analizave që kanë trajtuar këto shërbime.

Shërbimi i terminimit të thirrjeve zanore në një rrjet celular është një shërbim interkoneksioni i përcaktuar edhe në ofertën referencë të operatorëve celularë, si dhe në Marrëveshjet e Interkoneksionit (MI) të lidhura ndërmjet operatorëve celularë, i cili është perkufizuar si më poshtë:

Sherbimi nepermjet te cilit operatori celular (ofruesi i terminimit ne rrjetin e tij), ne emer te Operatorit perfitues percjell Thirrjet nga Pika e Interkoneksionit per ne nje Pike fundore te Rrjetit te tij ne Republiken e Shqiperise, te identifikuar nepermjet numrave te operatorit celular (ofruesi i terminimit ne rrjetin e tij), sipas planit te numeracionit.

Nderkohe me implementimin e portabilitetit të numrit celular, përcaktimi i mesipër që identifikon si abonent/pajtimtar të një rrjeti celular pajtimtarët që zotërojnë numër celular që i përket serive numerike të alokuara nga AKEP operatorit përkatës celular, nuk është me i vlefshëm. Për këto arsye, AKEP me vendimet e datës 20.04.2011, ka bërë disa ndryshime në ofertat referencë të interkoneksionit për perkufizimin e termave të terminimit dhe abonent/pajtimtar si më poshtë:

“Sherbimi i Terminimit ne rrjetin e operatorit celular X”

Sherbimi nepermjet te cilit operatori celular X, ne emer te Operatorit Perfitues percjell Thirrjet nga Pika e Interkoneksionit per ne nje Pike fundore te Rrjetit te tij ne Republiken e Shqiperise, te identifikuar nepermjet numrave te abonenteve/pajtimtareve te operatori celular X.

“Abonent/pajtimtar i rrjetit operatori celular X”: Abonentet/pajtimtarët që:

Kane numer celular qe i perket serive numerike 06Y⁹ xx xxxxx të alokuar nga AKEP operatorit celular X, numer i cili nuk është portuar në rrjetin e një operatori tjetër, ose

Kane numer qe nuk i perket serive numerike 06Y xx xxxxx të alokuar nga AKEP operatorit celular X, por qe është portuar në rrjetin e operatorit celular X.

⁹ Y=6, 7, 8 ose 9.

Terminimi i thirrjeve ne rrjetet celulare eshte nje sherbim me shumice, i cili perben nje input te domosdoshem per operatoret e rrjeteve te tjere (fikse dhe celulare) qe t'u ofrojne thirrje perdoruesve te rrjetit te vet drejt perdoruesve te nje rrjeti celular.

Terminimi i thirrjeve ne rrjetet e operatoreve celulare ne Shqiperi eshte kryer dhe kryhet nepermjet interkoneksionit direkt midis operatoreve (Albtelecom-celulare, celular-celular, Nderkombetare-celulare apo celular-operatore alternative), ose nepermjet interkoneksionit indirekt, duke bere tranzitim nepermjet rrjeteve te tjera te cilat mundesojne sherbimin e tranzitimit.

Ne raundin e fundit te analizes se tregut celular per terminimin e thirrjeve te kryer ne 2009-2010 jane shpallur me FNT tre operatoret celulare: AMC, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile. Ne baze te vendimeve te shpalljes me FNT te Vodafone Albania, AMC dhe Eagle Mobile ne vitin 2010, AKEP ka miratuar ofertat reference te interkoneksionit te ketyre tre operatoreve, te cilat rregullojne marredheniet per terminimin e thirrjeve ne rrjetet celulare Vodafone Albania, AMC dhe Eagle Mobile ndermjet ketyre operatoreve dhe operatoreve te tjere te licensuar/autorizuar nga AKEP.

Per Plus Communication (me pare Mobile 4 Al) u konkluda se nuk eshte e drejte qe AKEP te prononcohet per ekzistencen e nje tregu perkates te terminimit te thirrjeve ne rrjetin Mobile 4 Al dhe rrjedhimisht per FNT, per aq kohe sa ky operator nuk eshte aktiv ne treg ne ofrimin e sherbimeve perdoruesve fundore dhe sherbimin e terminimit ne rrjetin e tij. Nderkohe Plus Communication tashme eshte aktiv ne treg qe prej Nentor 2010, dhe ne vitin 2011, AKEP percaktoi kete operator si edhe tre operatoret e tjere celulare si operator me FNT per terminimin e SMS-ve ne rrjetin e vet.

Meqenese perdorimi i teknologjise UMTS apo standart 3G, tashme eshte realitet edhe ne Shqiperi, ku dy operatoret Vodafone Albania dhe AMC jane pajisur me autorizime individuale per perdorimin e frekuncave 1900/2100 pwr teknologjine UMTS apo 3G, dhe kane filluar ofrimin e sherbimeve mbi kete teknologji, ky dokument analize trajton edhe faktin ne se ka apo jo ndikim ne sherbimin e terminimit te thirrjeve perdorimi i teknologjise 3G apo eshte i njejt sherbim me karakteristikat qe percaktoheshin mbi teknologjine 2G.

III.1 Perkufizimi i tregut te terminimit te thirrjeve ne celulare

Tregu me shumice i terminimit te thirrjeve ne rrjetet individuale te levizshme, eshte pjese e listes se tregjeve te Rekomandimit 2003 te KE-se si edhe te Rekomandimit te vitit 2007 te KE per tregjet perkates, dhe per kete arsye AKEP nuk e konsideron te nevojshme te beje nje analize te tre kriterave nese ky treg eshte treg perkates i justifikueshem per nderhyrje ex-ante. Perkufizimi i ketij tregu si treg i justifikueshem per nderhyrje ex-ante eshte tashme nje praktike rregullatore e konsoliduar dhe e aplikuar ne te gjithe vendet anetare dhe kandidate te BE, si edhe me gjere.

Ne raundin e fundit te analizes se tregut celular per terminimin e thirrjeve te kryer ne 2009-2010, AKEP percaktoi tregje perkatese te vecanta per terminimin e thirrjeve ne secilin rrjet celular te operatoreve aktive ne treg: AMC, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile. Per Plus Communication (me pare Mobile 4 Al) u konkludua se nuk mund te percaktohej nje treg perkates per sa kohe ky operator nuk ishte ende aktiv ne treg.

Operaret celulare AMC, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile nuk kane pasur kundershime ne lidhje me perkufizimin e tregut perkates te terminimit te thirrjeve ne secilin rrjet individual celular.

Por gjithesesi ne diskutimin per perkufizimin e tregut perkates te ketij sherbimi ne kete analize do trajtohen ceshtjet e meposhteme:

1. Nese ka ndonje ndryshim ne percaktimin e ketij tregu ne secilin rrjet individual;
2. Nese sherbimi i terminimit te thirrjeve zanore ne 2G dhe 3G ben pjese ne te njejtin treg apo krijojne tregje te ndryshme;
3. Nese terminimi i thirrjeve ne rrjetin Plus Communication perben treg perkates te vecante si edhe terminimi i thirrjeve ne secilin prej rrjeteve te tre operatoreve te tjere celulare.
4. Nese ka pasur ndryshime ne periudhen 2010-aktualisht dhe nese priten ndryshime te tjera ne te ardhmen qe te ndikojne ne perkufizimin e tregut perkates.

Pergjigje perkatese per secilen nga pikat e mesiperme do te merret ne trajtimin e detajuar ne vijim, per te cilen do te jete nje arsyetim me i zgjeruar per secilin rast. Per sa i perket trajtimit te ceshtjes nese terminimi i SMS-ve eshte ne te njetin treg perkates si terminimi i thirrjeve zanore, AKEP nuk ka perfshire kete diskutim pasi kjo eshte trajtuar ne Analizen e vitit 2010, ku konkluzioni ishte qe jane dy tregje te ndryshem si dhe ne Analizen e tregut te terminimit te SMS-ve te kryer ne vitin 2011.¹⁰

I. Dimensioni i produkteve/sherbimeve te tregut perkates te terminimit

1. Terminimi i thirrjeve zanore ne secilin rrjet celular

Faktoret kryesore te trajtuar edhe ne analizat e meparshme, qe çojne ne identifikim te tregjeve te vecante per çdo operator celular dhe qe kane bere te mundur te vertetohet hipoteza se terminimi i thirrjeve zanore perben nje treg te vecante per secilin rrjet celular, si:

a- Praktika, sipas te ciles: pala thirrese paguan (CPP-Calling Party Pays)

b- Mungesa e alternativave te tjera te komunikimit, qe mund te ushtrojne presion te efektshem ne tarifat e terminimit.

¹⁰ Per me shume detaje mund ti referoheni dokumentit te Analizes se terminimit te SMS-ve:
http://www.akep.al/images/stories/AKEP/konsultime/Analize_e_tregut_te_terminimi_te_SMS-ve_.pdf

c- Ne nivelin me shumice te ofertes dhe kerkeses nuk ka alternativa zevendesimi per terminimin e thirrjeve ne rrjetin e nje operatori celular.

Arsyetimi i dhene edhe me pare se pavaresisht se kush qendron ne anen e kerkeses, operator celular apo operator fiks, perballe nevojës për të realizuar terminimin e thirrjes së bere nga pajtimtari i tij, në një rrjet specifik, është i kushtezuar me blerjen e shërbimit të terminimit në nivelin e shumicës në këtë rrjet specifik duke e patur të pamundur zëvendësueshmerinë me një rrjet tjetër që plotëson kërkesën e pajtimtarit të tij.

Kështu që çdo thirrje e destinuar drejt një numri që është i lidhur në një rrjet specifik celular, e ka të pamundur të sigurojë zëvendësueshmerinë e kësaj kerkese me një rrjet tjetër të ndryshëm nga rrjeti specifik drejt të cilit është destinuar kjo thirrje.

Per sa i perket zëvendësueshmerisë në anën e ofertës, arsyetimi i dhene në analizat e mëparshme ngelet i pandryshuar, se operatorët e tjere nuk kanë mundësi të ofrojnë shërbimin e terminimit të thirrjeve drejt përdoruesve të një rrjeti tjetër.

Aftësia e një operatori celular për të rritur tarifën e terminimit të thirrjeve në rrjetin e vet nuk mund të kufizohet nga presioni në anën e kerkeses (paragrafet a-b) apo ofertës (paragrafi c).

Rrjedhimisht, pavaresisht kush qendron në anën e kerkeses për shërbimin e terminimit, nëse janë operatore të tjere celulare, Mobile Network Operators ('MNOs'); Operatore Celulare Virtual, Mobile Virtual Network Operators ('MVNOs'): Rrjete të tjera fikse apo Wireless, rezultojnë që:

Ne përkufizimin e tregut të terminimit të thirrjeve në celulare, nuk mund të përfshihet terminimi në rrjete të tjera celulare dhe/ose fikse, duke e përcaktuar këtë si një shërbim të lidhur në mënyrë individuale me rrjetin e destinuar.

Në pjesën më poshtë do të gjëni trajtimin dhe arsyetimin e përdorur edhe në analizat pararendëse për secilën nga pikat a); b); c); dhe konkretisht:

a- Praktika, sipas të ciles: pala thirrrese paguan (CPP-Calling Party Pays)

Per shkak se pala e thirrur nuk paguan per thirrjet marrese, ne procesin e zgjedhjes se operatorit celular perdoruesi i rrjetit celular nuk ndikohet nga tarifa e terminimit. Pra, ndikimi qe mund te kete pala e thirrur ne tarifat e terminimit eshte eliminuar per shkak se nuk paguan per thirrjet e marra.

Terminimi nuk eshte pjese e te njejtit treg si aksesit dhe origjinimi i thirrjeve pasi perdoruesit jane te interesuar vetem per koston e aksesit dhe thirrjeve dalese (si edhe shërbimeve të tjera celulare), për të cilat ata paguajnë dhe jo për terminimin e thirrjeve marrese, shërbim për të cilin ata nuk paguajnë.

b- Mungesa e alternativave të tjera të komunikimit, që mund të ushtrojne presion të efektshëm në tarifat e terminimit.

Ne rast të rritjes së tarifës së terminimit nga operatori celular A dhe, për pasoje, të çmimit të thirrjeve drejt përdoruesve të këtij operatori nga përdorues të operatorëve të tjere, a ka mundësi pala thirrrese të zëvendësojë këto thirrje, duke bërë rritjen e tarifës së terminimit nga operatori A, jo-fitimprurëse? Nëse mundësitë e zëvendësimit të thirrjeve drejt përdoruesit të një operatori celular mund të përmendim: thirrjet drejt një numri fikse, SMS-te, përdorimi i me shumë se një

karte SIM. Megjithate, presioni i ketyre faktoreve apo menyrave te komunikimit ne tarifat e terminimit te thirrjeve ne rrjetin e nje operatori celular vleresohet shume i vogel, per keto arsye:

- Thirrja ne aparatin celular nuk mund te zevendesohet nepermjet nje thirrjeje ne aparatin fiks, per shkak te karakteristikave te ndryshme te dy sherbimeve. Mundesia e zevendesimit te thirrjeve ne celulare me thirrje ne telefon fiks eshte shume me e kufizuar edhe per shkak te numrit te vogel te perdoruesve te telefonise fikse.

- Sherbimi SMS nuk mund te konsiderohet si sherbim zevendesues i thirrjeve drejt celulareve dhe perdorimi i mesazheve SMS nuk eshte i mjaftueshem per te ushtruar presion ne tarifat e terminimit ne celulare.

- Mundesia e perdorimit te me shume se nje karte SIM do te ndikonte vetem ne zevendesimin e thirrjeve celular-celular jashte rrjetit me thirrje brenda rrjetit, por nuk mund te ndikojne ne zevendesimin e thirrjeve fiks-celular. Gjithashtu, kjo menyre nuk eshte shume praktike si dhe shoqerohet me kosto te konsiderueshme: aparat celular, karte SIM.

c- Ne nivelin me shumice te ofertes dhe kerkeses nuk ka alternativa zevendesimi per terminimin e thirrjeve ne rrjetin e nje operatori celular.

Operatoret nuk kane mundesi tjeter pervecse te blejne terminim te operatorit ku destinohen thirrjet e perdoruesve te vet. Gjithashtu, operatoret e tjere nuk kane mundesi te ofrojne sherbimin e terminimit te thirrjeve drejt perdoruesve te nje rrjeti tjeter.

Aftesia e nje operatori celular per te rritur tarifen e terminimit te thirrjeve ne rrjetin e vet nuk mund te kufizohet nga presioni ne anen e kerkeses (paragrafet a-b) apo ofertes (paragrafi c). Pra, ne perkufizimin e tregut te terminimit te thirrjeve ne celulare, nuk mund te perfshihet terminimi ne rrjete te tjera celulare dhe/ose fikse, si edhe sherbimi i aksesit apo origjinimit te thirrjeve.

Pas arsyetimeve te dhena me sipër dhe përvijës së deritanishme në analizën e shërbimit të terminimit, AKEP i përmbahet konkluzionit se:

Sherbimi i terminimit të thirrjeve zanore në rrjetin celular është një treg i vecantë për secilin operator dhe nuk mund të konsiderohet pjesë e një tregu me të gjërë shërbimesh në rrjetin celular.

2.Terminimi ne rrjet 2G dhe rrjet 3G

Me fillimin e ofrimit të shërbimeve 3G dhe rrjeteve 3G në Shqipëri, një çështje që nuk është trajtuara në analizat e mëparshme është nëse shërbimi i terminimit të thirrjeve zanore në rrjet 2G dhe rrjet 3G të të njëjtit operator janë pjesë e të njëjtit treg apo krijojnë tregje të ndryshëm përkatës.

Nëse do të merreshin në konsideratë zëvendësueshmëria në anën e kërkesës dhe ofertes për terminimin e thirrjeve në rrjetin 2G dhe rrjetin 3G të të njëjtit operator, rezulton se nuk ka zëvendësueshmëri as në anën e kërkesës dhe as në atë të ofertes, pasi kjo lidhet me pamundësinë e palës thirrëse për të përcaktuar nëse operatori i rrjetit të thirrur përdor rrjetin 3G apo 2G në

terminimin e nje thirrjeje. Kjo do te conte ne perkufizimin e tregjeve te ndryshem per terminimin e thirrjeve ne rrjet 3G dhe rrjet 2G te te njetit operator. Megjthate, sic eshte permendur ne seksionin parardhes nje faktor tjetër qe merret ne konsiderate ne perkufizimin e tregut perkates eshte nese ekzistojne kufizime te perbashketa ne tarifim (common pricing constraints), dhe kjo rezulton te ekzistojne per nje operator ne tarifimin e terminimit ne rrjet 2G dhe rrjet 3G. Nga praktika ne Shqiperi me fillimin e ofrimit te sherbimeve 3G nga dy operatore si dhe nga parktikat rregullatore ne vendet e tjera rezulton se terminimi i thirrjeve ne rrjetin 2G dhe rrjetin 3G te te njetit operator kryhet me te njejten tarife dhe jo me dy tarifa te ndryshme. Aplikimi i dy tarifave te ndryshme nga i njejti operator nuk eshte i relazueshem ne parkatike pasi pala blerese e terminimit nuk mund te percaktojte dot nese terminimi i nje thirrje drejt pedoruesit te rrjetit celular kryhet nga operatori i ketij rrjeti duke perdorur rrjetin 2G apo 3G.

Ne te gjitha percaktimet e bera nga rregullatore homologe per sherbimin e terminimit eshte ruajtur parimi i teknologjise neutrale, gje qe do te thote qe eshte konkluduar ne te njejten tarife terminimi per nivelin e shumices pa marre parasysh teknologjine 2G apo 3G te te njetit operator dhe sherbimi i terminimit te thirrjeve ne nje rrjet celular perfshin terminimin ne rrjetet 2G dhe 3G.

Perfundimi mbi faktorin teknologji 2G apo 3G

AKEP, konkludon qe sherbimi i terminimit te thirrjeve zanore ne nje rrjet celular eshte neutral pavaresisht teknologjise dhe se tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin 2G apo 3G eshte pjese e te njejtut treg.

Perfundim i AKEP, ne percaktimin e tregut te terminimit ne nivelin e shumices

Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne nivelin e shumices ne rrjetin celular, konsiderohet:

1. Individualisht ne secilin nga rrjetet celulare;
2. Sherbimet e tjera te telefonise celulare nuk bejne pjese ne te njejtin treg me terminimin e thirrjeve zanore ne nivelin e shumices;
3. Sherbimi i terminimit te thirrjeve zanore eshte neutral nga teknologjia 2G apo 3G.

3.Terminimi i thirrjeve ne rrjetin Plus Communication

Sic eshte theksuar me lart, ne Analizen e vitit 2010 AKEP gjykoi qe te mos percaktojte terminimin e thirrjeve ne rrjetin celulare te Plus Communication si treg perkates, pasi megjithese Plus Communication ishte licensuar nga AKEP per ofrimin e sherbimeve celulare, ai nuk ishte ende aktiv ne treg. Kjo praktike eshte ndjekur edhe me Eagle Mobile qe eshte licensuar ne vitin 2004, por nuk ka pasur perkufizim te tregut perkates te ketij operatori ne Analizat e kryera ne vitet 2006 dhe 2007, por vetem ne 2010, pasi Eagle Mobile ishte bere aktiv ne treg ne vitin 2008.

Te gjithë faktoret e mesiperme per dimensionin e produktit/sherbimit dhe ate gjeografik te cilet ndikojne ne perkufizimin e tregut perkates te terminimit te thirrjeve, jane te aplikueshem per cdo operator rrjeti celular aktiv ne treg, pra edhe per Plus Communication. Ne vijim edhe te praktikës se ndjekur me Eagle Mobile si dhe te praktikave rregullatore ne vendet e BE, ku terminimi i

thirrjeve ne rrjetin e cdo operatori celular aktiv ne treg eshte percaktuar si treg perkates i vecante, AKEP gjykon se terminimi i thirrjeve ne rrjetin celular te Plus Communication perben treg perkates te vecante.

II. Dimensioni gjeografik i tregut

Ne lidhje me dimensionin gjeografik te tregut perkates, Udhezimimi i KE, paragrafet 56, 59 dhe 60 citojne midis te tjerave,se,dimensioni gjeografik i tregut perkates perfshin zonen gjeografike ne te cilen operojne sipermarresit ofrues dhe kerkues te sherbimeve, zone e cila ka kushte te ngjashme te konkurrences, si dhe praktiken tradicionale te percaktimit te tregjeve te sherbimeve te komunikimeve elektronike ne baze te zonave te mbuluara nga rrjeti.

Operatoret e rrjeteve celulare ne baze te autorizimeve individuale dhe te pergjithshme, ofrojne sherbimet e tyre ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise. Ne kete menyre mund te konkludojme se:

Dimensioni gjeografik i sherbimit te terminimit ne rrjetet celulare eshte kombetar, d.m.th territori i Republikes se Shqiperise.

III. Zhvillime pas Analize 2010 dhe zhvillime te priteshme ne vitet ne vijim

Tregu i telefonise se levizshme ne periudhen 2 vjecare pas analizes 2010 ndodhet nen efektin e ndryshimeve te rendesishme, ndryshime te cilat nje pjese e tyre kane edhe lidhje te drejteperdrejte me tregun e terminimit te thirrjeve zanore ne nivel shumice, ndryshime te cilat jane:

- a) percaktimi i kostove te sherbimit te terminimit te thirrjeve zanore, ku aktualisht per operatoret AMC/VF/EM eshte percaktuar tarifa e terminimit, e cila eshte e orientuar drejt kostos sipas rezultateve te BU-LRAIC,per te cilen jane percaktuar vlerat e tarifes se terminimit si dhe afati kohor i asimetrise ndermjet rrjeteve te operatoreve celulare ne treg;
- b) Portabiliteti i numrit i cili aktualisht eshte bere aktiv dhe ka nje numer te konsiderueshem portimesh te kryera ndermjet rrjeteve celulare;
- c) Berja aktive e teknologjise 3G,per dy nga rrjetet celulare,Vodafone Albania dhe AMC, dhenia e autorizimit per 3G per Vodafon ne fillim te vitit 2011,ndersa per AMC eshte dhene pas nje periudhe 6 mujore. Nderkohe ne fund te vitit 2011 filluan procedurat per dhenin e autorizimit se trete 3G, dhe dy operatoret e tjere celulare paraqiten interes duke marre pjese ne tender, megjithese kjo procedure deshtoi me 24.02.2012.
- d) Hyrja ne treg e Plus Communication ne muajin Nentor 2010.

Ndryshimet e cituara ne germat 'b', 'c' dhe 'd' me siper dhe qe kane ndikim ne perkufizimin e terminimit te thirrjeve jane trajtuar ne seksionet e mesiperme, ndersa orientimi ne kostot

BULRAIC trajtohet me ne detaje ne sekionin e detyrimeve per FNT. Nderkohe AKEP nuk pret qe ne te ardhmen afat-mesme te ndodhin ndryshime te cilat mund te behen shkak per riperkufizim te tregut te terminimit te thirrjeve ne rrjetet e telefonise celulare, i ndryshem nga percaktimet e bera ne kete anlyze tregu.

Bazuar ne sa me siper, konkluzioni eshte se tregjet perkates te terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare jane:

- **Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin celular AMC, sherbim i ofruar nga sipermarresi AMC sh.a;**
- **Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin celular Vodafone Albania, sherbim i ofruar nga sipermarresi Vodafone Albania sh.a;**
- **Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin celular Eagle Mobile, sherbim i ofruar nga sipermarresi Eagle Mobile sh.a;**
- **Tregu i terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Plus Communication, sherbim i ofruar nga sipermarresi Plus Communication sh.a;**

III.2 Analiza per Fuqi te Ndjeshme ne Treg

Edhe ne raundin e analizave te mbajtura ne 2007 dhe 2010, ne lidhje me operatoret te cilet kane qene ne fokusin e ketyre analizave (ne lidhje me tregun e terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetet perkatese) eshte arritur ne konkluzionin se operatoret celulare, plotesonin kriteret per FNT ne tregjet perkatese te terminimit. Per te analizuar ekzistencen apo jo te fuqise se ndjeshme ne treg, neni 33 percakton nje sere kriteresh qe duhet te merren ne konsiderate.

Sipas perkufizimit te tregjeve perkates te terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetet celulare, çdo operator celular eshte monopolist ne ofrimin e sherbimit te terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin e vet,dhe mund te konkludohet qe secili prej tyre ka FNT. Megjithate, terminimi i thirrjeve eshte nje sherbim i cili i ofrohet operateve te tjere te rrjeteve, dhe per te arritur ne perfundimin se nje operator ka FNT, qe do te thote ka aftesi ndikuese ne percaktimin e cmimit te ketij sherbimi pavaresisht operateve te tjere apo konsumatoreve, eshte e rendesishme te analizohen edhe disa faktore te tjere qe mund te kene aftesi ndikuese. Ashtu sikurse edhe ne dokumentet e meparshme te analizave te mbajtura per kete treg, (sic theksohet edhe ne dokumentin shpjegues te KE per rekomandimin e tregjeve perkates e vitin 2007, EC(2007) 1483/2, COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT EXPLANATORY NOTE¹¹, nder faktoret/kriteret e tjere (pervec pjeseve te tregut) te konsideruar me te rendesishem per tregjet e terminimit dhe te analizuar jane :

- konkurrenca e mundshme;
- fuqia kundervepruese e bleresve te sherbimit;
- tarifimi i sherbimit te terminimit;

I. Pjeset e tregut

Percaktimi i tregut te terminimit te thirrjeve si treg me vete per çdo operator celular, do te thote qe secili operator celulare eshte monopolist ne ofrimin e sherbimit te terminimit te thirrjeve ne rrjetin e vet, pra secili operator celular zoteron 100 per qind te tregut perkates. Ne Udhezimin e BE, shprehet qarte se pjesa e tregut me e madhe se 50 per qind eshte nje tregues i rendesishem i fuqise se ndjeshme ne treg dhe, vetem ne raste te rralla mund te ndodhe qe nje operator me pjese tregu te tille te mos kete fuqi te ndjeshme ne treg¹². Secili nga operatoret aktiv ne nje treg, zoteron 100% te tregut te terminimit te thirrjeve ne rrjetet e tyre, nivel shume me i larte se pragu

¹¹ A market definition for call termination on each mobile network would imply that currently each mobile network operator is a single supplier on each market. However, whether every operator then has market power still depends on whether there is any countervailing buyer power, which would render any non-transitory price increase unprofitable

¹² According to established case-law, very large market shares — in excess of 50 % — are in themselves, save in exceptional circumstances, evidence of the existence of a dominant position (78). An undertaking with a large market share may be presumed to have SMP, that is, to be in a dominant position, if its market share has remained stable over time.

50% per qind i cituar me lart. Keto pjese tregu nuk kane ndryshuar qe nga fillimi i ofrimit te sherbimeve nga secili operator celular dhe nuk pritet te ndryshojne ne nje periudhe afatmesme.

II. Konkurrenca e mundshme ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare

Pozita monopoliste e nje operatori (ofrues) mund te vihet nen presion nga operatore (ofrues) te tjere, nese do te ishte e mundur hyrja e tyre ne treg. Mundesite qe operatore te tjere te hyjne ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin e nje operatori celular nuk ekzistojne. Qe nje operator te ofroje sherbimin e terminimit te thirrjeve te perdoruesit e nje operatori celular, duhet qe te kete akses ne karten SIM te perdoruesve te ketij operatori. Kjo mundesi nuk ekziston. Aktualisht kjo mundesi nuk ekziston per ofrimin e terminimit te asnje lloj operatori rrjeti celular apo fiks.

Rrjedhimisht, cdo operator celular, nuk kercenohet nga operatore te tjere te mundshem qe te hyjne ne tregun individual te secilit prej tyre dhe te ofrojne sherbimin e terminimit te thirrjeve ne rrjetet e tyre celulare.

III. Fuqia kundervepruese e bleresve te terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare

Pozita e nje operatori, qe eshte monopol ne ofrimin e nje sherbimi dhe nuk perballat me mundesine (kercenimin) e futjes ne treg te subjekteve te tjere, mund te jete me e dobet nese ekzistojne bleres te sherbimit, te cilet zoterojne fuqi te larte negociuese. Fuqia e larte negociuese eshte rezultat, kryesisht, i sasise se madhe te sherbimit te kerkuar nga pala blerese, dhe interesit te shitesit per te mos humbur kete klient. Ky eshte nje nder kriteret me te rendesishem per analizimin e FNT ne tregun e terminimit, pasi megjithese nje operator eshte monopolist, shpesh ky sherbim i ofrohet nje numri te kufizuar bleresish dhe ne kete rast fuqia kundervepruese e bleresve eshte shume me e madhe se ne rastet kur bleresit jane perdorues te vegjel, sic eshte shpesh rasti ne tregjet me pakice. Mund te ndodhe madje qe ne anen e bleresit te jete nje operator i vetem, dhe pozita e ofruesit monopolist nuk eshte e njejte me rastin kur jane shume bleres te vegjel te sherbimit. Tarifat e terminimit jane rezultat i negociatave midis operatoreve, te cilet ne baze te fuqise blerese mund te ushtrojne presion ne tarifa me te uleta nga ofruesi tjetër.

Eshte e rendesishme te theksojme se operoret kane detyrim te negociojne per interkoneksion dhe ne rast mosmarrveshesh ato i referohen AKEP, i cili urdheron lidhjen e MI. Megjithese ne blerjen e terminimit nga operoret eshte e pritshme te ekzistojne fuqi kundervepruese e bleresit, ky kriter duhet shqyrtuar ne aspektin e aftesise se bleresit apo bleresve per te bere jofitmprures per ofruesin nje rritje jo-kalimtare te cmimit prej tij.

Ne anen e bleresit te terminimit te thirrjeve ne nje rrjet celular jane operoret e tjere (fiks dhe celulare), vendas dhe te huaj. Gjithashtu pale blerese e terminimit te thirrjeve mund te konsiderojme dhe divizionin me pakice (retail) te vete operatorit celular.


AKEP ne analizen e vitit 2010 ka konkluduar se tre operoret celulare AMC, Vodafone dhe Eagle Mobile nuk ndeshen me fuqi kundervepruese te tille qe te kufizojne fuqine e ndjeshme te secilit prej tyre ne percaktimin e tarifes se terminimit te rrjeteve respektive celulare. Gjate kesaj periudhe dhe ne periudhen e ardhshme afatmesme nuk ka pasur apo priten ndryshime qe te

ndikojne ne kete perfundim te AKEP per keta tre operatore.Nderkohe ne lidhje me Plus Communication,AKEP gjykon se,ky operator nuk ndeshet me fuqi kundervepruese nga operatoret e tjere (celulare dhe/ose fiks), te tille qe, ne mungese te rregullimit nga AKEP, te kene mundesine te mos lejone kompanine Plus Communication te aplikojte tarifat e terminimit mbi nivelin qe do rezultonte ne kushte e nje tregu konkurrues. Mosmarrveshjet e lindura midis Plus Communicaton dhe 4 operatoreve me te medhenj ne treg (3 operatoret celulare dhe Albtelecom) ne lidhje me tarifen e terminimit ne rrjetin Plus Communication ne vitin 2010 dhe 2011, tregojne se,ky operator ka mundesine e imponimit te tarifave te larta te terminimit ne rrjetin e vet ne mungese te nderhyrjes nga AKEP.

IV. Ecuria e tarifave te terminimit ne rrjetet celulare

Figura e meposhteme paraqet ecurine e tarifave te terminimit ne rrjetet celulare te kater operatoreve per periudhen 2010 deri aktualisht.¹³

FIGURA III. 1: ECURIA E TARIFAVE TE TERMINIMIT NE RRJETET CELULARE 2010-AKTUALISHT



Tarifat e terminimit per tre operatorët e FNT (AMC, Vodafone dhe Eagle Mobile) duke filluar nga 1.03.2011 jane percaktuar ne baze te Vendimeve nr.1505, 1506, 1507 dhe 1508, date 10.02.2011, per orientimin ne koston BULRAIC te tarifave celulare, nepermjet reduktimit te pershkallezuar i cili synon qe ne 1.03.2013 tarifat e ketyre tre operatoreve te arrijne nivelin 4.57 lek/minute qe eshte rezultati i modelit te kostove BULRAIC. Tarifa e terminimit në rrjetin Plus Communication, është përcaktuar me Vendimet e KD të AKEP nr. 1351, datë 04.08.2010, dhe Vendimet 1663-1666 date 28.07.2011, në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjes midis këtij operatori dhe kater operatorëve me FNT, për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit.

Dokumenti “Orientimi në koston e tarifave të shërbimeve celulare të operatorëve me FNT”, i miratuar me Vendimin Nr.1505 date 10.02.2011, ka percaktuar nivelin e asimetrise ndermjet rrjeteve celulare dhe afatin kohor ne te cilen rrjetet celulare do te jene ne simetri ndermjet tyre ne lidhje me tarifen e terminimit. Niveli i tarifave te terminimit per te kater operatorët celulare sipas ketij dokumenti eshte dhene ne tabelen e meposhteme.

¹³ Per nje historik te tarifave te terminimit ne rrjetet celulare 2000-2010 shiko Analiza Tregut Celular Mars 2010, Kapitulli III/2/ Seksioni IV “Ecuria e tarifave te terminimit dhe struktura e tyre” fq.43

TABELA III. 1: REDUKTIMI I PËRSHKALLËZUAR I TARIFAVE TË TERMINIMIT SIPAS BU-LRAIC (LEK/MINUTE)

| | Para aplikimit te BU-LRAIC ¹⁴ | 1 Mars 2011 | 1Shtator 2011 | 1Shtator 2012 | 1 Shtator 2013 | 1 Shtator 2014 | 1 Shtator 2015 |
|----------------------------|--|--------------|---------------|---------------|----------------|----------------|----------------|
| AMC, Vodafone | 10.5 | 8.85 | 7.57 | 6.1 | 4.57 | 4.57 | 4.57 |
| Eagle Mobile | 12.92 | 10.89 | 8.85 | 6.52 | 4.57 | 4.57 | 4.57 |
| Plus Communications | 18.9 | 15.93 | 12.92 | 8.85 | 6.1 | 5.3 | 4.57 |


Burimi: Dokumenti “Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve celulare të operatorëve me FNT”, i miratuar me Vendimin Nr.1505 date 10.02.2011.

Në dokumentin e cituar, AKEP është shprehur se në kuadër të përcaktimit të tarifës së terminimit të Plus Communication për periudhat e dhëna në tabelë, meqenëse Plus Communication formalisht (me vendim të AKEP) nuk ka status me FNT, vlerat e dhëna në tabelë do të shërbejnë si tarifë rekomanduese për këtë operator, deri në shpalljen me FNT të këtij operatori për terminimin e thirrjeve në rrjetin e vet. Vendimet 1663-1666 date 28.07.2011, në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjes midis këtij operatori dhe kater operatorëve me FNT, për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit, kanë lene ne fuqi tarifen 18.9 lek/minute per Plus Communication, deri ne nje vendim-marje tjeter.

Grafiku me poshte paraqet krahasimin e tarifave te terminimit per te gjithë operatorët celulare per te gjitha vendet e rajonit si dhe mesataren e BE-se, (EU-27).

¹⁴ Tarifat para rregullimit me BU-LRAIC përfshijnë një tarifë fikse për thirrje që ishte e barabartë me 3% të tarifës për minute. Tarifat e periudhave të tjera, duke filluar nga 1 Mars 2011 nuk përmbajnë tarifë fikse për thirrje.

FIGURA III. 2: KRAHASIM I TARIFAVE TE TERMINIMIT NE RRJETET CELULARE NE SHQIPERI ME MESTAREN E BE DHE VENDET E RAJONIT (NENTOR 2011)



Burimi: "Cullen International" Supply of services in monitoring regulatory and market developments for electronic communications and information society services in Enlargement Countries" Report I, November 2011

Nga figura mund te vihet re se:

- tarifat e terminimit ne rrjetet AMC dhe Vodafone jane ne nivelin mesatar te BE (ndryshimi me vetem 0.02 eurocent)
- tarifa e terminimit Eagle Mobile eshte 17% me larte se tarifa mesatare e terminimit ne vendet e BE;
- tarifa e terminimit ne rrjetin Plus Communication eshte me e larta ne rajon dhe 150% me e larte se tarifa mesatare e terminimit ne vendet e BE.

Duke iu referuar ecurise se tarifave ne periudhen 2010 deri aktualisht si edhe ne periudhen para vitit 2010, vihet re se reduktimet ne vite te tarifes se terminimit ne rrjetet celulare (2006, 2008-2011), perafrimi i tarifes se terminimit me nivelet mesatare te BE, dhe percaktimet per orientim ne kosto te tyre nuk kane ardhur si pasoje e presionit konkurrues ne tregjet perkatese te terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare, por per shkak te nderhyrjes se AKEP nepermjet procedurave te zgjidhjeve te mos-marreveshjeve, implementimit te metodologjive te rregullimit te tarifave si edhe orientimit ne kosto. Ne mungese te nderhyrjes rregullatore, operatoret celulare do te ishin dhe do jene ne gjendje t'u impononin operatorëve vendas tarifa me te larta per terminimin e thirrjeve ne rrjetet e tyre celulare.

V. Pervoja rregullatore ne vendet e BE-se

Referuar dokumentave rregullatore te KE-se, dhe specifikesht dokumentit ERG (07) 83 final 080312 te ERG (European regulators Group) **ERG's Common Position on symmetry of fixed call termination rates and symmetry of mobile call termination rates, (faqe 66).**

All commercially-active operators were designated SMP operators by initial proposed decisions by NRAs (but some decisions may have been suspended or annulled).

Consequently, the number of MNOs designated as SMP operators is identical to the number of MNOs licensed and commercially active when the market analysis is notified in each country (for countries with ex ante regulation).

Nga te gjitha pervojat nderkombetare, rezulton se,te gjithë operatorët e rrjeteve celulare aktive ne treg jane percaktuar si operatore me FNT per terminimin e thirrjeve zanore ne rrjetet e tyre.

VI. Perfundim mbi FNT

Ne analizen e faktoreve te marre ne konsiderate per fuqine e ndjeshme ne tregjet perkatese, rezulton se:

- Secili prej operatoreve AMC, Vodafone Albania, Eagle Mobile dhe Plus Communication zoteron 100 % te tregut te terminimit te thirrjeve ne rrjetet e tyre;
- Operoret celulare nuk perballen me kercenimin e hyrjes ne tregjet e tyre te terminimit te operatoreve te tjere, qe do te ishin te afte te kryenin edhe terminimin e thirrjeve ne keto rrjete;
- Operoret celulare ndeshen me fuqi te ulet kundervepruese nga operoret e telefonise fikse (Albtelecom dhe operoret alternative);
- Ne mungese te nderhyrjes rregullatore, cdo operator celular do te jete ne gjendje t'ju impononte operatoreve vendas tarifa te larta per terminimin e thirrjeve ne rrjetin celular qe zoteron.
- Kriteret e marra ne shqyrtim nuk kane ndryshuar dhe nuk pritet te ndryshojne te pakten ne nje periudhe afatmesme, ne menyre qe te eliminojne aftesine ndikuese te operatoreve ne tregjet perkatese te terminimit te thirrjeve.

Duke marre ne konsiderate faktoret (argumentat) e mesiperme, AKEP gjykon se operoret Vodafone Albania, AMC, Eagle Mobile dhe Plus Communication, permbushin kriteret per fuqi te ndjeshme ne tregjet perkatese te terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetet e tyre celulare:

- **Operatori AMC permbush kriteret e sipermarresit me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular AMC.**

- **Operatori Vodafone Albania permbush kriteret e sipermarresit me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Vodafone Albania.**
- **Operatori Eagle Mobile permbush kriteret e sipermarresit me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Eagle Mobile.**
- **Operatori Plus Communication permbush kriteret e sipermarresit me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Plus Communication.**

III.3 Masat rregulluese per terminimin e thirrjeve zanore ne rrjetet celulare

Nga analiza per FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetet e telefonise celulare, rezulton se permbushen kriteret per FNT (dominance individuale) ne tregun perkates te secilit nga rrjetet celulare aktive ne Shqiperi, AMC, Vodafone Albania, Eagle Mobile dhe Plus Communication.

Ne baze te parashikimeve te ligjit, **neni 34**,

Nëse AKEP-i përcakton se një ose disa sipërmarrës kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës, pra nuk ka konkurrencë efektive, atëherë ajo vendos ndaj tyre një, disa ose të gjitha detyrimet e veçanta të nevojshme, të cilësuar në nenet 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 e 56 të këtij ligji.

Detyrimet qe mund te vendosen ne lidhje me sherbimin e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular te AMC, Vodafone Albania, Eagle Mobile dhe Plus Communication, jane :

- Mosdiskriminimi (neni 39),
- Transparenca (neni 40),
- Dhenie Akses dhe Interkoneksion dhe perdorimi i perbashket i faciliteteve te rrjetit (neni 42),
- Kontrolli i tarifave dhe sistemi i mbajtjes se llogarive(neni 45)
- Ndarja e llogarive (neni 41)

Nderkohe nenet 55-59, permbajne percaktime ne lidhje me detyrimet per kontrollin dhe rregullimin e tarifave dhe zbatimin e tyre.

Ne vendosjen e detyrimeve, AKEP duhet te mbaje parasysh objektivat rregullatore dhe detyrimet ndaj operatoreve me FNT duhet te jene proporcionale me masen e problemit dhe te mos jene barre e tepert per operatorin.

I. Problemet e FNT per terminimin e thirrjeve dhe masat rregulluese

Problemet qe lindin ne nje treg nga FNT per terminimin e thirrjeve ne rrjetet celulare jane evidentuar edhe ne analizat e meparshme te tregut celular dhe mund te permbliidhen si me poshte:

Sherbimi i terminimit te thirrjeve ne celulare eshte nje sherbim me shumice dhe tarifate e terminimit ndikojne ne tarifate e perdorimit te thirrjeve telefonike (drejt celulareve), si dhe ne konkurrencen midis operatoreve.

Tarifate e terminimit ne celulare jane pjese perberese e koston se thirrjeve drejt celulareve nga perdoruesit e telefonise fikse dhe celulare, vendas dhe te huaj. Si te tilla, tarifate e larta te terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare ndikojne mbi tarifate e thirrjeve drejt celulareve, duke imponuar tarifate te larta te thirrjeve fiks-celulare dhe celulare-celulare jashte rrjetit dhe, per pasoje, çojne ne perdorimin ne nivel te ulet te ketyre thirrjeve.

Tarifat e larta te terminimit ne celulare (sherbim me shumice) ndikojne negativisht ne tarifat e thirrjeve telefonike te paguara nga perdoruesit fundore te rrjeteve te tjere.

Tarifat e larta te terminimit perkeqesojne gjendjen e operatoreve te rinj dhe/ose te vegjel ne treg: tarifat e larta per terminimin e thirrjeve ne rrjetet celulare te operatoreve ekzistues rrisin koston per thirrjet telefonike per keta operatore, per shkak te trafikut jo te balancuar.¹⁵ Per kete shkak, ndikon negativisht ne konkurrencen midis operatoreve te rinj (me numer te vogel perdoruesish) dhe operatoreve te stabilizuar ne treg (me numur te madh perdoruesish).

Diferencat ne tarifat e terminimit sipas origjines se thirrjes,pervecse nuk justifikohen nga diferencat ne kosto, krijojne mundesi per arbitrazh: thirrjet e origjinuara brenda vendit mund te rrugesohen per t'u terminuar ne rrjetet celulare sikur te ishin thirrje hyrese nderkombetare. Kjo praktike e mundesuar nga diferencat ne tarifat e terminimit sipas origjines se thirrjes dhe jo mbi baze te koston, krijon stimuj per veprime joligjore.

Grupi i Rregullatoreve Europiane (ERG) ne dokumentin , ERG (06) 33, Revised ERG Common Position on the approach to Appropriate remedies in the ECNS regulatory framework, Final Version May 2006, citon 4 probleme per konkurrencen ne lidhje me terminimin:

- koluzioni i nenkuptuar;
- tarifim i tepert
- diskriminim ne tarifa
- refuzimi per te negociuar apo mosdhenie interkoneksioni

Rekomandimet e ERG per zgjidhjen e ketyre problemeve eshte vendosja e detyrimit per orientim ne kosto te tarifave te terminimit, cka do te rriste perfitimet e tregut ne teresi. Aplikimi vetem i detyrimeve te mos-diskriminimit dhe transparences nuk konsiderohen te mjaftueshme per eliminimin e ketyre problemeve. ERG trajton gjithashtu ceshtjen e asimetrise, duke rekomanduar aplikimin e asimerise midis operatoreve te rinj ne treg dhe operatoreve te meparshem, por me objektivin qe asimetria te jete e lejuar per nje periudhe kohore te kufizuar ne vite.

Gjithashtu, ERG citon se probleme te tjera qe mund te krijojne sipermaresit me FNT, jane diskriminimi me terma jo-tarifore. Keto probleme mund te krijohen edhe ne prezence te detyrimit te mos-diskriminimit dhe kontrollit te tarifave, nese detyrimi i mosdiskriminimit nuk shoqerohet me masa te tjera parandaluese. Nder keto probleme te diskriminimit jo-tarifor mund te permendim vonesen ne dhenien e aksesit, ku operatori me FNT ka interes te aplikojte strategji vonuese ndaj operatoreve te cileve u jep akses ne rrjetin e tij.

Rekomandimi i ERG per te eliminuar strategjite vonuese,eshte shoqerimi i detyrimit te mos-diskriminimit me detyrimin per dhenien e Garancive apo marrveshjes se Nivelit te Sherbimit (Service Level Agreement-SLA) si dhe publikimin e Treguesve Kryesore te Performances (Key

¹⁵ Operoret e rinj dhe/ose te vegjel kane nje trafik dales me te madh drejt operatoreve me te medhenj se sa trafik hyres prej ketyre te fundit.

Performance Indicators -KPI). Nepermjet ketyre detyrimeve, sipermarresi me FNT detyrohet te paguaje kompensim per vonesat apo deshtimin e ofrimit te sherbimit sipas afateve kohore dhe cilesise se rene dakort.

Masat rregulluese

Transparenca lidhet me detyrimin e operatorit per publikimin e tarifave dhe ndryshimeve te propozuara te tyre, me pare se ato te hyjne ne fuqi, dhe te jene te qarta, te dallueshme dhe lehtesisht te kuptueshme. Publikimi paraprakisht i tarifave dhe ndryshimeve te tyre rrit transparencen per monitorimin e sjelljeve te mundshme antikonkurruese.

Por, transparenca ne vetvete nuk u krijon stimuj operatoreve celulare per te ulur tarifat e terminimit te thirrjeve ne rrjetet e tyre.

Mosdiskriminimi synon te parandaloje operatoret qe te mos diskriminojne midis operatoreve te ndryshem, si edhe midis sherbimeve te ofruara operatoreve te tjere dhe rrjetit te vet te tregtimit te sherbimeve te perdoruesit fundore (integrimi vertikal). Sherbimet e operatoreve te telekomunikacioneve mund te ndahen ne sherbime me shumice (shitje e sherbimeve te interkoneksionit tek operatoret e tjere dhe rrjetit te vet, apo filialeve) dhe sherbime me pakice, te cilat i tregtohen perdoruesit.

Detyrimi per mosdiskriminim do te thote qe operatori me FNT t'u jape operatoreve te tjere interkoneksion me cilesi dhe tarife te njejte me ato qe ai ofron per sherbimet e veta dhe te filialeve, partnereve ose ortakeve te tyre. Detyrimet per transparencen dhe mosdiskriminimin nuk rrisin apo krijojne stimuj per te ulur tarifat e terminimit, ato thjesht jane masa paraprake qe operatoret te mos abuzojne me poziten e tyre ne treg.

Ndarja e llogarive do te thote qe operatori te mbaje bilanc dhe llogari te te ardhurave dhe shpenzimeve per aktivitete te ndryshme: me shumice dhe tregtimin me pakice. Ndarja e llogarive duhet te aplikohet edhe per sherbime te ndryshme: thirrjet fiks-celulare, thirrjet celulare-celulare jashte rrjetit, terminimi i thirrjeve ne rrjetin e vet, thirrjet dalese. Efekti i detyrimeve per transparencen dhe mosdiskriminimin, te shoqeruara edhe me detyrimin per ndarje te llogarive dhe nxjerrje te koston nuk rrisin apo krijojne stimuj te mjaftueshem per te ulur tarifat e terminimit.

Kontrolli i tarifave eshte menyra me efektive per te ndikuar qe tarifat e terminimit te thirrjeve ne celulare te jene te orientuara drejt koston. Qellimi i çdo autoriteti rregullues sektorial eshte qe tarifat te jene te orientuara drejt koston, qe do te ndodhte normalisht ne nje treg ku konkurrenca eshte efektive.

Menyra te ndryshme, te cilat gjejne zbatim edhe ne praktiken europiane per kontrollin e tarifave te terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare, mund te permendim:

- tarifa te orientuara drejt koston, si p.sh., kosto kontabile (FAC) apo LRIC;
- tarifa sipas praktikës me te mire (benchmarku,);
- rregullim ne baze te cmimit tavan.

Rregullimi i tarifave sipas koston LRIC (apo LRAIC) eshte menyra me efektive e rregullimit te te tarifave te terminimit e rekomanduar edhe nga KE. Nderkohe AKEP deri ne vitin 2010 ka perdorur edhe rregullimin me benchmark me tarifate mesatre te BE, para se te perfundonte e studimin mbi koston e terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare ne Shqiperi me metoden BULRAICNe vitin 2011, AKEP percaktoi skedarin e reduktimit te tarifave te terminimit per orientim ne koston BULARIC me reduktim te pershakkllzuar (glide path), metode e rekomanduar nga KE.

II. Detyrimet aktuale te AMC, Vodafone Albania dhe EM per FNT

AKEP bazuar ne gjetjet e analizese pararendese nepermjet vendimeve te dates 31.03.2010 dhe ndryshimeve te mevonshme mbi keto vendime, ka percaktuar masat rregullatore ndaj operatoreve me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve, ne reference te Ligjit 9918 dhe kuadrit rregullator, qe ne permbledhje jane:

1. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)
2. Detyrimi i transparencës (Neni 40)
3. Detyrimi per ndarje te llogarive (neni 41)
4. Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)
5. Detyrimi për kontroll të tarifave; (Neni 45)

Detyrimi per publikimin e ofertes reference te interkoneksionit (RIO) eshte plotesuar nga AMC, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile me miratimin nga AKEP te ketyre ofertave me 23.12.2010 dhe publikimin e tyre ne faqet respektive te internetit dhe te AKEP. Keto Oferta reference te interkoneksionit te miratuara nga AKEP kane pesuar edhe ndryshime te tjera ne vijim te implementimit te portabilitetit te numrit celular, si dhe perfshijne edhe SLA dhe KPI. Ne zbatim te detyrimit per kontrollin dhe rregullimin e tarifave dhe orientimin ne koston efciente, AKEP ka percaktuar nivelin i asimetrise si dhe shtrirjen kohore te saj ne tregun e telefonise se levizshme, te percaktuar me VKD nr. 1505, datë 10.02. 2011 “Për miratimin e Dokumentacionit Final për Orientimin në koston të tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT”. Orientimi ne koston i tarifave te terminimit eshte percaktuar nepermjet vendimeve nr.1506, 1507 dhe 1508, datë 10.02. 2011, ku eshte percaktuar niveli maksimal i tarifave te terminimit dhe reduktimi I pershakkllzuar duke arritur vleren 4.57 lek/minute me 1.09.2013 per te tre operoret me FNT, vlere e cila eshte rezultati i koston se terminimit sipas modelit BULRAIC te zhvilluar nga AKEP me konsulence nderkombetare ne vitin 2010.Operoret kane zbatuar vendimet dhe grafikun e reduktimit dhe aktualisht ky grafik ndodhet ne fazen e dyte te implementimit te metodologjise sipas rezultateve BU-LRAIC per percaktimin e tarifese se terminimit ne rrjetet celulare, ne te cilen ka percaktuar tarifate maksimale te terminimit per rrjetet AMC, VF dhe EM dhe konkretisht per dy rrjetet e medha AMC/Vadone kjo tarife eshte 7.57 leke/minute, ndersa per rrjetin e EM kjo tarife eshte 8.85 leke/minute.

III. Detyrimet per terminimin e thirrjeve hyrese nderkombetare

AKEP ne dokumentin e Analizes finale te tregut cellular ne 2010 ka perfshire nje seksion te plote me argumnetat pro dhe kunder rregullimit te tarifes se terminimit te thirrjeve hyrese nderkombetare. Ne vendimet per FNT ne Mars 2010 u la ne fuqi rregjimi i meparshem i rregullimit te tarifes se thirrjeve hyrese nderkombetare ne nivele te njejte me ate te thirrjeve kombetare. Me vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP-it - Nr. 1345, 1346, 1347, datë 23.07.2010, të cilat respektivisht i referohen sipërmarrësve AMC, Eagle Mobile (EM), Vodafone Albania, AKEP-i kishte vendosur që *“tarifa e terminimit të thirrjeve dhe shërbimeve të interkoneksionit të lidhura me terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre për thirrjet hyrëse ndërkombëtare, të jenë objekt i negociatave komerciale”*. Pas investimit të AKEP për zgjidhjen e disa mosmarrëveshjeve të lindura gjatë negociatave të sipërmarrësve për përcaktimin e tarifave të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, pasi çmoi se *“sipërmarrësit me FNT nuk arritën të administronin në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme heqjen e masës rregulatore për rregullimin ex-ante të tarifës së terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe përcaktimin e saj nëpërmjet negociimit në terma komerciale të pranueshme në mënyrë të dyanshme, si dhe nga natyra e mosmarrëveshjeve të depozituara në AKEP lidhur ngushtësisht me aplikimin e tarifave për thirrjet hyrëse ndërkombëtare”*

AKEP-i me vendimet Nr. 1436, 1437, 1438, datë 03. 11. 2010 të Këshillit Drejtues të tij, vendosi që të ndryshonte vendimin e mësipërcituar duke ripërcaktuar që *“tarifa e terminimit të thirrjeve dhe shërbimeve të Interkoneksionit të lidhura me terminimin e thirrjeve në rrjetet e këtyre sipërmarrësve (AMC, V-Al, EM), të jenë objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP.*

Me vendimet Nr.1739, 1740 dhe 1741 date 20.12.2011, AKEP vendosi qe te anulonte vendimet e Nentor 2010 dhe linte ne fuqi vendimet e Korrikut 2010.

Bazuar ne vendimet e fundit te Dhjetor 2011 si dhe ne vendimet e Korrik 2010, operatoret me FNT per terminimin e thirrjeve kane detyrimin per te dhene akses per terminimin e thirrjeve hyrese nderkombetare per operatoret vendas qe tranzitojne keto thirrje, por me tarifa komerciale te cilat vendosen ne negociata midis operatorit terminues dhe atij tranzitues. Ne kendveshtrim te perkufizimit te tregut perkates ky trajtim nenkupton qe tregu perkates i terminimit te thirrjeve ne nje rrjet, perfshin thirrjet hyrese me origjine kombetare dhe nderkombetare, si dhe secili operator ka FNT per kete treg perkates, por detyrimet per FNT jane te ndryshme per dy llojet e thirrjeve. Nese do ti referoheshim argumentave te perdorur per de-rregullimin e tarifes se terminimit te thirrjeve hyrese nderkombetare (mungesa e impaktit direkt ne tregun me pakice ne Shqiperi), atehere mund te merret ne konsiderate edhe trajtimi nese keto thirrje duhet te jene pjese e tregut perkates te terminimit te thirrjeve ne nje rrjet. Terminimi i thirrjeve ne nje rrjet celular sherben si input per operatoret e tjere per te ofruar thirrje perdoruesve te tyre drej ketij rrjeti celular:

- terminimi i thirrjeve kombetare eshte input per operatoret per thirrjet e perdoruesve (tregu me pakice) ne Shqiperi drejt abonenteve te ketij rrjeti.

- terminimi i thirrjeve hyrese nderkombetare sherben si input per operatoret ne vende te tjera (tregjet me pakice ne keto vende) per te ofruar thirrje drejt abonenteve te ketij rrjeti. Ne kete rast ky input mund te sigurohet nga nje marredhenie direkte e operatoreve te huaj apo me karrier nderkombetar/ ne marredhenie me operatore vendas qe kryejne tranzitim drejt ketyre rrjeteve.

Tranzitimi i thirrjeve si sherbim, sherben per te lidhur dy rrjete qe nuk kane lidhje direkte me njeri-tjetrin apo kur kjo lidhje direkte nuk konsiderohet ekonomike nga palet. Per tranzitimin e thirrjeve kombetare Albtelecom eshte operator me FNT dhe tarifat e tranzitimit kontrollohen dhe rregullohen nga AKEP. Per tranzitimin e thirrjeve nderkombetare nuk ka operator me FNT. Tranzitimi i thirrjeve nderkombetare deri ne vitin 2005 eshte kryer nga Albtelecom dhe te gjithë operatorët e tjere ishin te detyruar qe thirrjet hyrese dhe dalese nderkombetare te kalonin nepermjet Albtelecom. Nderkohe duke filluar nga vitit 2005 dhe me pas ne vitin 2008 me hyrjen ne fuqi te ligjit 9918, nuk ka kufizime per ofrimin e tranzitimit te thirrjeve nderkombetare. Nje sere operatoresh alternative vazhdojne qe per tranzitimin e thirrjeve nderkombetare te perdorin rrjetin e Albtelecom pasi nuk kane mundesi te lidhen direkt me karriera nderkombetare dhe ne kete rast kerkesa per tranzitim eshte e operatoreve vendas. Per tranzitimin e thirrjeve hyrese nderkombetare aktualisht kerkesa duket se eshte kryesisht nga operatorët e huaj dhe jo nga operatorët vendas dhe operatorët tranzitues bazohen ne lidhjet qe kane me operatorët e huaj per sasine e trafikut qe duhet te tranzitohen per terminim ne rrjetet vendas. Kjo ka cuar dhe ne ndryshime te ndryshme te sasise se trafikut te tranzituar nga nje operator ne periodha te ndryshme duke cuar ne problem te cilesise se sherbimeve ne rrjetin terminues. Shpesh here mund te kete ndryshime midis sasise se trafikut qe origjinohet nga operatorët e huaj qe percillet per tranzitim me operatorët vendas dhe sasise se trafikut percillet nga keta te fundit per terminim ne rrjetin vendas. Nderkohe, nese kerkesa per sherbimet e tranzitimit do te vinte nga operatori terminues, kjo do te bente te mundur qe te dy operatorët (terminues dhe tranzitues) te parashikonin me mire sasite e trafikut te tranzituar dhe terminuar duke garantuar dhe cilesine e tij. Ne kete menyre nevoja apo kerkesa per sherbimet e tranzitimit te trafikut nderkombetar, lidhet direkt me operatorët vendas dhe operatori tranzitues ka interes te plotesoje dhe kerkesat e operatorit terminues: te dy operatorët (terminues dhe tranzitues) kane interes komercial per sherbimet e tranzitimit. Kjo ndryshon nga skema aktuale kur sherbimet e operatorit tranzitues paraqesin interes komercial vetem per operatorin origjinues (apo nje tranzitues tjetër) ne vendet e huaja.

Pra sherbimet e tranzitimit te thirrjeve se pari duhen pare ne interesin apo kerkesen e operatoreve vendas per keto sherbime dhe me pas ne rast te problemeve te tregut nese eshte e nevojshme nderhyrja per rregullim. Sic eshte theksuar edhe me siper, terminimi i thirrjeve hyrese nderkombetare eshte input per operatorët dhe tregjet me pakice ne vendet e huaja, ndersa terminimi i thirrjeve kombetare per operatorët dhe tregun me pakice ne Shqiperi. Sherbimet e tranzitimit te thirrjeve kombetare kerkohen nga operatorët vendas, origjinues dhe/ose terminues, kur keta dy operatore nuk kane mundesi te lidhen ose eshte me ekonomike te perdorin sherbimet e tranzitimit te nje pale te trete. Ne kete rast operatori tranzitues i thirrjeve blen terminimin ne rrjetin celular (apo edhe fiks) per llogari te operatorit origjinues i cili ofron thirrje ne tregun me pakice ne Shqiperi dhe operatori terminues celular duhet te kete detyrimin per te ofruar terminim per operatorin tranzitues te thirrjeve kombetare dhe me tarifa te rregulluara.

Nderkohe per thirrjet hyrese nderkombetare, duke qene se efekti eshte ne tregjet me pakice ne vendet e huaja, eshte e diskutueshme jo vetem rregullimi i tarifes por edhe vendosja e detyrimit mbi operatorin terminues qe ti ofroje akses operatorit tranzitues qe ky i fundit ti ofroje sherbimin operatorëve ne vendet e huaja. Ne kete kendveshtrim, per sa diskutuam me siper, dhenia e aksesit ne keto raste duhet lene edhe ne interesin komercial te pales terminuese.

Nje faktor tjetër ne favor te de-rregulimit te tarifes dhe te aksesit per thirrjet hyrese nderkombetare eshte trajtimi nga KE i roamingut nderkombetar. KE bazuar ne problemet e

tarifave e larta te romingut per thirrjet dhe te dhenat per perdoruesit, ka vendosur nen-rregullim tarifave e roamingut nderkombetar (me pakice dhe me shumice) ne vendet e BE, duke imponuar tarifa maksimale (cmime tavan) per operoret ne vendet e BE, por vetem ne marredheniet midis operatoreve te vendeve te BE: tarifave e roamingut qe operoret e vendeve te BE i paguajne njeritjetrit jane nen-rregullim (operatori Vodafone UK nuk mund te tarifoje operatorin T-Mobile ne Gjermani me shume se tarifa e percaktuar nga komisioni,ne rastin kur nje perdorues i T-Mobile perdor rrjetin Vodafone UK gjate qendrimit ne kete vend), por tarifave qe paguajne operoret jashte vendeve te BE operatoreve te vendeve te BE per roaming nderkombetar nuk jane nen-rregullim. Pra,vete KE ka bere nje ndarje midis vendeve te BE dhe jo te BE, pasi masat e marra kane impact per perdoruesit ne vendet e BE.

Bazuar edhe ne komentet e operatoreve si dhe ne informacionin nga vendet e rajonit ne raportin e Mars 2012 te Cullen International¹⁶, ku ne te gjitha vendet e rajonit tarifave e terminimit te thirrjeve nderkombetare percaktohen ne marrveshje konfidenciale dhe jane jashte rregullimit, AKEP gjykon qe terminimi i thirrjeve hyrese nderkombetare te mos jete me pjese e tregut perkates te terminimit te thirrjeve ne rrjet celular, pra qe ky sherbim (ku secili operator ka FNT) te perfshije vetem thirrjet me origjine kombetare.

Zgjedhja e alternatives ne pyetjen 5 te konsultimit publik, eshte e lidhur me perfundimin e arritur ne pyetjen 4. Bazuar ne perfundimin e arritur per pyetjen 4 (paragrafi i mesiperme), qe terminimi i thirrjeve hyrese nderkombetare te mos jete pjese e tregut perkates te terminimit te thirrjeve hyrese ne nje rrjet celulare, pra qe sherbimi ku operatori eshte me FNT te perfshije vetem terminimin e thirrjeve kombetare, gjykon se alternative e duhur eshte alternative 'c': dhenia e aksesit dhe tarifa e terminimit te thirrjeve hyrese nderkombetare ne nje rrjet celular eshte objekt i negociatave komerciale midis paleve.

Duke qene se ky derregullim perben nje heqje detyrimi per FNT te operatoreve celulare AMC, Vodafone dhe EM, AKEP gjykon se efektet e tij te fillojne nga 1.09.2012 duke dhen kohen e duhur lojatrve te tregut per pershtatje ne vijim edhe te derregullimit te tarifave se ketyre thirrjeve qe hyri ne fuqi me 1.02.2012.

IV. Detyrimet per FNT

Bazuar ne gjetjet e analizes rezulton qe te kater operoret AMC, Vodafone Albania, Eagle Mobile dhe Plus Communication jane propozuar si operoret qe kane Fuqi te Ndjeshme ne tregun e terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetet e tyre.

Rrjedhimisht ne reference me percaktimet ligjit 9918, propozohet qe AMC, Vodafone Albania, Eagle Mobile te vazhdojne ne implementimin e masave rregullatore qe aktualisht mbajne, detyrime te cilat identifikohen te domosdoshme me qellim shmangien e problemeve te tilla si

¹⁶ As for calls originated from abroad, termination rates are not regulated in most countries (Croatia, Montenegro, Albania, Macedonia, Turkey Serbia and Kosovo), and are defined by commercial agreement (confidential).

mungese transparence, diskriminim ne tarifa dhe cilesi, mosdhenie aksesit apo vonesa ne dhenien e aksesit per terminim.

Zbatimi i detyrimeve dhe shmangia e ketyre problemeve avantazhon realizimin e objektivit te pergjithshem rregullator, sigurimi i konkurrences efektive, dhe objektivave te tjere pjese e nenit 7 te Ligjit 9918.

Ne menyre te permbledhur detyrimet propozuara per AMC, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile jane:

- 1) Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)
- 2) Detyrimi i transparencës (Neni 40)
- 3) Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)
- 4) Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (Neni 45)
- 5) Detyrimi per ndarjen e llogarive (neni 41)

1. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)

Ky detyrim i percaktuar dhe pershkruar ne nenin 39 te Ligjit, per FNT ne terminimin e thirrjeve, kerkon midis te tjerave publikimin e ofertes reference te interkoneksionit per ofrimin e sherbimit te terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular te sipermmarresit me FNT. Ky detyrim sherben per te mos-lejuar diskriminim midis operatoreve perfitues si edhe diskriminin e tyre ndaj filialeve apo partnereve te vet. Per rritjen e efektivitetit te ketij detyrimi, AKEP gjykon se eshte e nevojshme edhe detyrimi per dhenien e Garancive apo marrveshjes se Nivelit te Sherbimit (Service Level Agreement-SLA) si dhe publikimin e Treguesve Kryesore te Performances (Key Performance Indicators -KPI), te pershkruar me siper.

Detyrimi per mos-diskrimin nuk konsiderohet i mjaftueshem per te eliminuar stimujt per mos-dhenie apo vonesa ne dhenie aksesit per terminim, tarifa te larta terminim dhe jo te orientuara ne kosto ,mungese transparence.

2. Detyrimi i transparencës (Neni 40)

Ky detyrim pervec publikimit te RIO, kerkon publikimin e informacionit per tarifate e sherbimeve te aksesit/interkoneksionit.

Ashtu si edhe detyrimi i mos-diskriminimit, ky detyrim nuk konsiderohet i mjaftueshem *per te eliminuar stimujt per mos-dhenie apo vonesa ne dhenie aksesit per terminim, tarifa te larta terminim dhe jo te orientuara ne kosto*

3. Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)

Ky detyrim i percaktuar dhe pershkruar ne nenin 39 te Ligjit, kerkon qe AKEP te vendose një, disa, apo të gjitha prej masave të parashikuar ne piken 3. AKEP gjykon se per FNT per terminimin e thirrjeve ne rrjetet celulare, jane te nevojshme masat:

- a) t'u ofrojë palëve të treta akses dhe interkoneksion në rrjet dhe elementet e tij;
- b) të ofrojë shërbime të veçanta në nivel shumice, për t'u rishitur nga palët e treta;
- c) të mos anulojë aksesin në facilitetet, kur e ka dhënë atë;
- ç) të negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses;
- d) të ofrojë akses të hapur në ndërfaqet teknike, protokollet ose teknologjitë e tjera të rëndësishme, të domosdoshme për ndërveprimin e shërbimeve ose për shërbimet e rrjetit virtual;
- dh) të ofrojë bashkëvendosje ose forma të tjera të përdorimit të përbashkët, përfshirë ndërtesat, tubacionet kabllore ose shtyllat, kullat;
- e) të krijojë kushtet e nevojshme për të siguruar ndërveprimin e shërbimeve pikë fundore – pikë fundore, duke përfshirë facilitetet për shërbimet e rrjetit inteligjent dhe/ose *roaming*-ut në rrjetet *mobile*;
- ë) të ofrojë akses në sistemet mbështetëse funksionale ose sistemet e ngjashme informatike (*software*), të nevojshme, për të siguruar konkurrencë të ndershme në ofrimin e shërbimeve;
- f) të interkonektojë rrjetet ose facilitetet e rrjetit.

Keto detyrime janë të nevojshme dhe aktualisht shumica e tyre janë implementuar në interkoneksionin me operatorët celularë. Për pikat d, dh, e, ë, AKEP gjykon se është e nevojshme të sqarohet se detyrimi për akses i referohet vetëm për mundësimin e terminimit të thirrjeve në rrjetet celularë, dhe duhet të jenë të zbatueshme sipas mundësive/aftësive teknike dhe ekonomike të operatorit celular me FNT për terminim si edhe me tarifa të cilat mbajnë parasysh investimet e kryera dhe një normë të arsyeshme fitimi.

Keto detyrime, përfshirë sqarimin e bërë, shërbejnë për realizimin e objektivit të konkurrencës efektive në tregun e shërbimeve celularë si dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, pasi terminimi në rrjetet celularë është një input i përdorur jo vetëm nga operatorët celularë por edhe nga sipërmarrës të tjerë, ofrues të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike. Gjithashtu pika 4 e nenit 42, lejon që një operator të mos japë akses në rast se dëshmon, apo justifikon (operatorit kërkuar dhe AKEP) bazuar në standartet objektive, se përdorimi i facilitetit mund të rrezikojë mirëmbajtjen e tërësisë së rrjetit ose funksionet e rrjetit

4. Detyrimi për kontroll i tarifave dhe sistemit e mbajtjes së llogarive (Neni 45)

AKEP gjykon se detyrimi për kontrollin e tarifave të operatorëve me FNT, është një masë efektive, që shërben për realizimin e objektivave rregullatore të AKEP, për konkurrencë efektive në tregjet e komunikimeve elektronike.

Reduktimi dhe orientimi në kosto të tarifave të terminimit në rrjetet celularë, ka efekte pozitive në uljen e kostove të thirrjeve drejt rrjeteve celularë, duke rritur mundësitë konkurruese të operatorëve/ofruesve të shërbimeve si dhe përfitimet e përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, për thirrjet dalese dhe hyrese (rritet numri i thirrjeve dalese drejt celularëve duke rritur numrin e thirrjeve hyrese, të marra nga përdoruesit celularë).

Keshtu qe ne lidhje me kete mase rregullatore, AKEP ka te percaktuar ne terma konkrete, skedulimin kohor te asimetrise si dhe tarifate respektive sipas cdo segmenti kohor, te percaktuar nepermjet metodologjise perkatese dhe vendimarrjeve te kryera bazuar ne rezultatet BU-LRAIC per tre operatoret AMC/VF dhe EM.

Komisioni European ne rekomandimin me te fundit per orientimin ne kosto te tarifave te terminimit: **COMMISSION RECOMMENDATION of 7 May 2009 on the Regulatory Treatment of Fixed and Mobile Termination Rates in the EU (2009/396/EC)**, ka rekomanduuar autoriteteve rregullatore, midis te tjerave:

- Percaktimin e tarifave te terminimit (fiks dhe celular) bazuar ne koston e ofrimit nga nje operator eficient. Kjo nenkupton gjithashtu qe tarifate duhet te jene simetrike;
- Vleresimi i kostove efiente te bazohet ne koston korrente dhe perdorimin kostove afatgjate inkrementale me metoden BU, si metodologjia e duhur e kostove;
- Mund te perdorin krahasimin e rezultateve te modelit BU me model TD i cili perdor te dhena te audituara per te permirësuar konsistencen e rezultateve dhe mund te bejne rregullimet e nevojshme;

Rekomandimi percakton dhe disa zgjedhje qe duhen bere ne modelimin BU, ku me i rëndesishmi duket se eshte perdorimi i LRIC per shërbimin e terminimit d.m.th inkrementi te jetë vetëm terminimi dhe jo te gjitha shërbimet si ne rastin e LRAIC. Pritshmerite per aplikimin e te gjitha zgjedhjeve te rekomandimit te KE, eshte se tarifa e terminimit ne rrjete celulare ne fundin te vitit 2012 pritet te jetë shumë me ulet se niveli aktual. Kjo çështje ka qene objekt diskutimi ne modelin BULRAIC te ndertuar nga konsulenti nderkombetar ICC, dhe lexuesit mund t'i referohen dokumentave te publikuar nga AKEP per modelin BULRAIC. Disa prej vendeve me te zhvilluara kane filluar implementimin e ketij rekomandimi duke percaktuar afatet kohore te reduktimeve te tarifave te terminimit bazuar ne modelin e paster LRIC, vlera te cilat jane shume me te uleta se niveli aktual mesatar ne vendet e BE.

AKEP gjykon qe aktualisht te vazhdoje me implementimin e fazave te reduktimit te pershkallezuar (glide path) te percaktuara ne Shkurt 2011, qe pritet te perfundoje ne aplikimin e fazes se fundit duke filluar nga Shtator 2013 per tre operatoret me te medhenj. Per periudhen pas 2013 AKEP gjykon se aplikimi i modelit BULRAIC i paster dhe rekomandimit te KE do te ishte menyra me e mire per rregullimin e tarifave te terminimit ne rrjetet celulare. Per te realizuar kete AKEP, do te ndertoje nje model te ri te paster BULRAIC ose do te perdore nivelin benchmark te vendeve qe e kane ndertuar keto modele per percaktimin e tarifave te terminimit ne rrjetet celulare (sipas rekomandimit te KE), si dhe do te ndjeke te gjitha procedurat e konsultimit publik dhe njoftimit te paleve te intersuara per ket procedura.

Ne lidhje me detyrimin per kontrollin e tarifave, propozohet zbatimi i fazave te percaktuara ne VKD 1506, 1507 dhe 1508 date 10.02.2011, sipas metodologjise te rregullimit per orientimin ne kosto te tarifave te terminimit ne rrjetet publike telefonike te levizshem. Marrja ne konsiderate e rekomandimit te mesiperme te KE do te jete objekt shqyrtimi ne periudha te ardhshme nga AKEP.

Operatori Plus Communication sh.a, duke qene se shpallet per here te pare si operator me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin e tij, AKEP gjykon se eshte e arsyeshme te kete te njejtat detyrime kryesore si dhe AMC, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile dhe konkretisht:

- *detyrimet per mosdiskriminim, dhenie aksesit per terminim dhe transparence:*

Plus Communication duhet te publikoje nje oferte reference interkoneksioni per sherbimin e terminimit te thirrjeve ne rrjetin Plus. Ne vijim te praktikese se ndjekur me AMC, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile duhet te publikoje RIO-n e vet e cila duhet te jete ne permbajtje dhe forme e ngjashme (ndryshimet kryesisht ne termat teknike dhe specifike per Plus) me RIO-t e tre operatoreve te tjere celulare.

Megjese formati kesaj RIO eshte i gatshem, dhe RIO- e AMC, Vodafone dhe Eagle Mobile jane te njejta, publikimi i RIO nga Plus nuk perben nje barre te rende.

- *detyrimet per ndarjen e llogarive, kontrollin e tarifese dhe orientimin ne kosto:*

Tarifa e terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin e Plus Communication duhet qe te orientohet drejt koston efciente, duke bere te mundur qe te perfshihet ne fazat e uljes, sipas metodologjise se rregullimit te tarifese se terminimit sipas rezultateve BU-LRAIC, me qellim qe parashikimi i bere per konvergimin e tarifese se terminimit dhe arritjen e simetrise se plote ndermjet te gjitha rrjeteve te jete afati kohor 1 Shtator 2015. Per sa i perket detyrimeve per ndarjen e llogarive dhe sistemin e mbajtjes se llogarive ky detyrim mund te vendoset si per operatoren e tjere, megjithese per nje operator te ri kjo mase mund te perbeje barre me te madhe dhe pa efekte te dukshme pozitive ne kushtet e rregullimit te tarifese duke e orientuar ne koston BULRAIC. Kjo mase do te ishte e justifikuar nese operatori do te zhvilloje modelin top-down te koston efciente dhe keto detyrime do te sherbejne per justifikimin e kostove sipas nenit 59.

Tarifa e terminimit ne rrjetin Plus Communication, eshte percaktuar me Vendimet e KD te AKEP nr. 1351, date 04.08.2010, dhe Vendimet 1663-1666 date 28.07.2011, ne kuader te zgjidhjes se mosmarrveshjes midis ketij operatori dhe kater operatorëve me FNT, per lidhjen e marrveshjes se interkoneksionit. Asimetria (ne perqindje) e tarifave midis operatorëve ne treg eshte e nje rendesie te vecante dhe si e tille ka qene vazhdimisht ne fokusin e vendimarrjeve te AKEP, duke marre ne konsiderate rekomandimet e BE si dhe praktikat me te mira rregullatore per ulje te vazhdueshme te tyre dhe me tendence eliminimin e asimetrise ndermjet rrjeteve.

Por faza ne te cilen ndodhej vendimarrja e AKEP per orientimin e tarifese se terminimit drejt koston dhe analiza e situates ku ndodhej hyresi i fundit ne tregun e telefonise se levizshme, mungesa e statusit me FNT per Plus Communication, beri te mundur qe AKEP te konsideronte zgjerimin e fazave te aplikimit te asimetrise per rrjetet AMC/VF/EM dhe Plus Communication, dhe percaktoi qe per dy rrjetet e medha AMC/VF asimetria te eliminohej deri ne 1 Shtator 2013, periudhe ne te cilen vlere e tarifese maksimale te terminimit ne rrjetet AMC/VF te jete 4.57 leke/minute, ndersa per EM ne periudhen 1 Shtator 2013, vlere e tarifese se terminimit te jete 6.1 leke/minute, per te arritur ne simetri me dy rrjetet AMC dhe VF ne periudhen 1 Shtator 2014.

Perjashtimi per Plus Communication per aplikimin ne te njejtën kohe te tarifese se terminimit sipas skedulimit kohor te parashikuar, si pasoje jo vetem e mungeses se statusit me FNT ne periudhen kur u be ky percaktim, por edhe per faktin qe Plus Communication ne ndryshim nga

parashikimet akoma nuk kishte arritur peshen e duhur ne kete treg, beri te mundur qe te skedulohej nje faze e re, faze ne te cilen parashikohet qe tarifa e terminimit të arrije ne simetri te plote me atë të tre operatorëve të tjerë në vlerën 4.57 lekë/minutë në 01.09.2015. Vendimet 1663-1666 date 28.07.2011, në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjes midis këtij operatori dhe kater operatorëve me FNT, për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit, lane ne fuqi tarifen 18.9 lekë/minute dhe krahas aplikimit te reduktimit te tarifave te terminimit te tre operatoreve te tjere asimetria aktuale eshte ne nivele te larta, rreth 150 % ndaj rrjeteve AMC dhe Vodaone dhe rreth 113 % ndaj rrjetit EM.

Aplikimi i asimetrise se tarifave te terminimit midis operatoreve te rinj dhe atyre te meparshem , rekomandohet edhe nga ERG (aktualisht BEREC) dhe AKEP ne vendimet e cituara me lart ka dhene arsytimin dhe faktoret qe kane ndikuar ne percaktimin e tarifes se terminimit ne Plus dhe asimetrine e aplikuar deri tani, bazuar ne rekomandimet e ERG dhe pervoja ne vendet e tjera. Nderkohe aplikimi i asimetrise gjykohet i arsyeshme te mbahet vetem per periudha tranzitore, me qellim qe te mos krijoje efektin e kundert. Thellimi i nivelit te asimetrise ne periudhat e ardhshme ndermjet rrjetit te Plus Communication dhe rrjeteve te AMC; VF dhe EM, do te krijonte nje barriere per thirrjet e origjinuara nga rrjetet e operatoreve te tjere drejt rrjetit te Plus, duke ndikuar ne kete menyre deri ne ndryshimin e sjelljes konsumatore per thirrjet qe destinohen drejt ketij rrjeti. Kjo sjellje ndikohet nga aplikimi ne operatoret e rrjeteve te tjere celulare te tarifave te perdoruesit drejt Plus ne nivele shume me te larta se ndaj njeri-tjetrit, per shkak te kostove me te larta te ketyre thirrjeve te diskutuara nga niveli i larte i tarifes. Njekohesisht vlen te permendet se perdoruesit mund te mos jene koshient per tarifa me te larta ndaj Plus. Ne te dy rastet rritja e metejshtme e nivelit te asimetrise ne periudhat e ardhme do te krijonte efektin e kundert te qellimit te aplikimit te asimetrise, duke ndikuar negativisht ne konkurrencen ne treg dhe aplikimin e tarifave me te uleta per perdoruesit. Keto efekte perkeqesohen ne kushtet e implementimit te portabilitetit te numrit, asimetria e larte pertej niveleve te arsyeshme do te shnderrohet ne efekt negativ, pasi ndikon ne sjelljen konsumatore.

Per sa me siper, AKEP gjykon qe niveli i asimetrise se tarifes se Plus me tarifat e terminimit ne rrjetet e tjera celulare per periudhat e ardhme duhet te reduktohet duke filluar nga Shtator 2012, qe perkon me fazen e trete te reduktimit te tarifave te tre operatoreve te tjere celulare, dhe per fazat e mevonshme te vazhdoje reduktimi i asimetrise per te arritur konvergjencen ne afatin e parshikuar me 1.09.2015.

Per sa me siper, AKEP, edhe pas komenteve te depozituar ne konsultimin publik, gjykon se:

- Per AMC, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile te vazhdoje zbatimin i fazave dhe niveleve te tarifave te percaktuara ne VKD 1506, 1507 dhe 1508 date 10.02.2011, sipas metodologjise të rregullimit për orientimin në kosto të tarifave të terminimit në rrjetet publike telefonike të lëvizshëm;
- Per Plus Communication te reduktohet tarifa e terminimit sipas fazave dhe niveleve te dhena ne tabelen e meposhteme. Nivelet e dhena ne tabelen e meposhteme ndryshojne nga propozimi i bere per Plus Communication ne dokumentin e dates 10.02.2012, por ruajne nivelin dha aftin e fundit te skedarit kohor. Nivelet e tarifave te Plus per tre fazat 1-vjecare duke filluar nga 1.09.2012 deri ne 31.08.2014 jane te njejta me ato te Eagle Mobile me distance 2-3 vjet.

TABELA III.2: REDUKTIMI I PËRSHKALLËZUAR I TARIFAVE TË TERMINIMIT NË RRJETET CELULARE PËR ORIENTIM NË KOSTO SIPAS BU-LRAIC (LEKË/MINUTE)

| | 2010- 28.02.201 1 | 1.03.2011 - 31.08.201 1 | 1.09.2011 - 31.08.201 2 | 1.09.2012 - 31.08.201 3 | 1.09.2013 - 31.08.201 4 | 1.09.2014 - 31.08.201 5 | 1.09.201 5- |
|-------------------------------------|-------------------------|----------------------------------|----------------------------------|----------------------------------|----------------------------------|----------------------------------|----------------|
| AMC, Vodafone | 10.5 | 8.85 | 7.57 | 6.1 | 4.57 | 4.57 | 4.57 |
| Eagle Mobile | 12.92 | 10.89 | 8.85 | 6.52 | 4.57 | 4.57 | 4.57 |
| Plus Communicatio ns | 18.9 | 18.9 | 18.9 | 12.92 | 8.85 | 6.52 | 4.57 |

***Shenim:** Tarifa aktuale terminimit te Plus eshte 18.9 leke/minute dhe 0.57 leke per thirrje. Ndersa per fazat nga 1 Shtator 2012 dhe ne vazhdim do te aplikohet vetem tarife per minute, ne te njejten menyre si operatoret e tjere.*

Reduktimet e tarifave të interkoneksionit në nivelet e përshkruara me sipër, pritet të kenë efekt pozitiv në tregjet me pakicë të shërbimeve celulare dhe të telefonisë fikse. Ndikimi në telefoninë fikse do të jetë direkt tek pagesat më të ulëta për terminimin e thirrjeve dhe në kosto me të ulëta për thirrjet telefonike fiks-celulare, pra dhe në tarifa më të ulëta për këto thirrje. Gjithashtu, reduktimi i diferencës midis tarifave të terminimit në rrjetet celulare dhe fiks do të ndikojë pozitivisht në aftësinë konkurruese të operatorëve fiks, edhe me shërbimet celulare, ku vihet re një efekt zëvendësimi më i ndjeshëm se në vitet e mëparshme.

Efekti i reduktimit të tarifave të terminimit në rrjetet celulare do të ndikojë në rritjen e konkurrencës në tregun celular, nëpërmjet:

- Uljes së kostos së thirrjeve off-net celulare për operatorët duke krijuar mundësinë e reduktimit të tarifave të këtyre thirrjeve në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.
- Reduktimit të mundësive të operatorëve celulare për subvencionimin e thirrjeve telefonike në nivelin retail, një praktike e vënë re sidomos me thirrjet brenda grupeve të mbyllura të përdoruesve.

Tarifat aktuale të thirrjeve jashtë rrjetit dhe të SMS-ve, brenda dhe jashtë rrjetit, në shumicën e programeve tarifore, përveç promocioneve dhe programeve të caktuara, duket se janë shumë me të larta se kostoja e ofrimit eficient të tyre (përfshirë edhe një vlerësim për koston retail). Reduktimi i tarifave të terminimit për këto shërbime, duhet që në kushtet e konkurrencës efektive në tregun me pakicë të shoqërohet apo ndjehet në reduktime të tarifave me pakicë për këto shërbime.

AKEP, parashikon që ndikimi i reduktimit të tarifave të terminimit në rrjetet celulare në konkurrencën në tregun me pakicë celular, të jetë më i madh se thjesht reduktimi i tarifave të thirrjeve jashtë rrjetit në masë të njejte me reduktimin absolut të tarifave të terminimit. Këto reduktime të tarifave të thirrjeve pritet të shoqërohen me reduktime të tarifave të SMS-ve (për shkak të reduktimit edhe të tarifave të terminimit të SMS-ve) ku pritet të çojnë në reduktime të mëtejshme të tarifave celulare, reduktime keto dhe më të mëdha se ato që kanë ndodhur dy vitet e fundit.

IV. TREGU ME SHUMICE I AKSESIT DHE ORIGJINIMIT TE THIRRJEVE NE RRJETET CELULARE

Tregu me shumice i aksesit dhe origjinimit te thirrjeve ne rrjetet individuale te levizshme, u analizua per here te pare nga AKEP ne analizen e tregut celular ne 2010, dhe perfundim te ketij procesi AMC dhe Vodafone Albania u percaktuan si operatore me FNT ne kete treg. Perfundimet kryesore te kesaj analize jane dhene ne seksionin IV.1 me poshte. Ne analizen e tregut 2010, u arsyetua se meqenese ky treg eshte pjese e listes se tregjeve te Rregullores se analizes se tregut dhe pjese e listes se tregjeve te Rekomandimit 2003 te KE-se, nuk ishte e nevojshme qe AKEP te kryente nje analize te testit te tre kriterëve nese ky treg eshte treg perkates i justifikueshem per nderhyrje ex-ante. Nderkohe, bazuar:

- ne zhvillimet e tregut celular me pakice ne keto dy vite (te dhena ne seksion IV.2);
- ne zhvillimet ne vendet e BE ku tregu me shumice i aksesit dhe origjinimit te thirrjeve ne rrjetet individuale te levizshme, eshte hequr nga lista e tregjeve e Rekomandimit te viti 2007 te KE,
- faktit qe edhe ato vende qe e kane konsideruar kete treg me pare te justifikueshem per nderhyrje ex-ante e kane hequr kete treg nga rregullimi ex-ante,

AKEP gjykon se eshte e nevojshme qe ne kete analize te behet nje analize e testit te tre kriterëve. Para analizes se testit te tre kriterëve, AKEP ka bere nje permbledhje dhe perditesim te perfundimeve te Analize 2010 dhe nje vleresim te tregut me pakice celular dhe zhvillimeve ne kete treg ne keto dy vite, pasi tregu i akses/origjinimit edhe gjate analizes se bere ne vitin 2010, u trajtua si nje treg i lidhur ngushtesisht me tregun e pakices.

IV.1 Permbledhje e perfundimeve te Analize 2010 per akses/origjinimin dhe perditesim i tyre

Perfundimet kryesore te analize 2010 jane dhene ne seksionin 1 me poshte, ndersa seksioni 2 permabn perditesim te disa prej perfundimeve kryesore.

1. Permbledhje e perfundimeve te Analize 2010 per akses/origjinimin e thirrjeve.

Ne Analize 2010, AKEP analizoi kete treg duke shqyrtuar perkufizimin e tregut perkates, analizen per FNT dhe masat rregulluese per FNT. Perfundimet kryesore jane dhene me poshte.

Tregu perkates

Ne perkufzimin e tregut perkates me shumice te akses/origjinimit te thirrjeve ne rrjetet celulare, AKEP arriti ne perfundimet e meposhtme:

- (i) sherbimet me shumice te akses/origjinimit te ofruara nga operatore te rrjeteve te ndryshem celulare jane pjese e te njejtit treg perkates. Pra ky treg perfshin ofrimin e akses/origjinimit nga te gjithë operatorët celulare (ndryshim nga terminimi ku tregu perkates eshte i vecante per secilin operator);
- (ii) sherbimet me shumice te akses/origjinimit te ofruara MVNO-ve, ofruesve te pavarur jane pjese e te njejtit treg perkates;
- (iii) vetofrimi i akses dhe origjinimit te thirrjeve ne rrjetet celulare, nga operatorët e ketyre rrjeteve eshte pjese e tregut perkates me shumice te aksesit dhe origjinimit te thirrjeve ne rrjetet celulare.
- (iv) Dimensionimi gjeografik i tregut me shumice te akses dhe origjinimit ne rrjetet celulare eshte kombetar, d.m.th territori i Republikës së Shqipërisë.

Per sa me me siper, percaktimi i tregut te akses/origjinimit te thirrjeve ne rrjetet celulare, ishte:

Tregu me shumice i aksesit dhe origjinimit te thirrjeve ne rrjetet celulare, sherbime te ofruara nga AMC, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile (tre operatorët celulare aktive ne kohen e perfundimit te analizës).

Analiza per FNT

Ne lidhje me analizen per percaktimin e operatoreve me FNT ne kete treg, AKEP shqyrtoi nje sere kriteresh dhe arriti ne perfundime si me poshte:

- Pjeset e tregut

Ne baze te pjeseve te tregut, ne terma te numrit te perdoruesve, thirrjeve dhe te te ardhurave, te matura ne menyre dinamike, AMC dhe Vodafone Albania zoterojne pjese tregu mbi 40% secila, apo mbi 85% te tregut te per numrin e perdoruesve apo aksesin dhe mbi 80% per origjinimin e thirrjeve celulare te dy se bashku. Eagle Mobile si hyresi i ri ne treg per vitin 2008 ka perfituar afersisht 9% pjese tregu ne numer perdoruesish, por vetem 4% ne thirrje dalese dhe pjesa e tregut ne te ardhurat e perfituara ishte vetem 1.2%. EM gjate vitit 2009, ka vazhduar rritjen e pjeseve te tregut duke arritur ne fund te vitit 2009 14.4% pjese tregu per perdoruesi dhe 9% ne te ardhura, dhe ne gjashtemujorin e pare te vitit 2009 17% pjese tregu per thirrjet dalese.

Eshte e qarte se analiza per FNT ne kete rast duhet te perqendrohet ne dominacën e bashkuar dhe jo individuale. Neni 33 i ligjit 9918 percakton kriteret per analizen per dominancë e bashkuar apo rastet kur me shume se nje sipermerres mund te kete FNT.

- *Zhvillimi i shtysave për konkurrencë të tarifave;*

Megjithese gjate viteve 2007-2009 jane vene re reduktime te tarifave, reduktimi i tarifave te dy programeve me parapagim, Vodafone Card dhe Albakarta, ka ardhur si rezultat i imponimit te aplikimit te metodologjive te rregullimit te tarifave celulare te Vodafone dhe AMC, te miratuara me VKM nr.853 dhe nr.855 date 18.06.2008, dhe jo prej reduktimit nga ana e operatoreve si pasoje e stimujve per konkurrence. Madje te dy operatoret celulare kane ankimuar aplikimin e VKM-ve ne rruge gjyqesore, duke kerkuar revokimin e aplikimit te metodologjive, perfshire reduktimin e dyte te parashikuar ne Shtator 2009.

Aplikimi i tarifave te larta (mbi kosto) se bashku me fitimet e larta te AMC dhe Vodafone Albania eshte tregues per stimuj per sjellje te koordinuar te dy operatoreve.

Aplikimi i tarifave me te larta nga Vodafone dhe AMC krahasuar me Eagle Mobile, eshte tregues i aftesise ndikuese te dy operatoreve dhe mundesise per te vepruar pavaresisht nga Eagle Mobile.

Gjithashtu ky fakt perforcohet nga aftesia e ketyre dy operatoreve per te aplikuar tarifa me te larta se niveli mestar ne vendet e BE dhe njekohesisht me te medha se operatori tjetër celular Eagle Mobile.

- *fuqia ekonomike dhe financiare të sipërmarrësit.*

Nga te dhenat e cituara ne seksionin e treguesve financiare si dhe nga pjesa e ulet e tregut te Eagle Mobile ne te ardhura, vihet re qarte se te dy siper marrsit AMC dhe Vodafone Albania kane fuqi ekonomike shume me te larte se Eagle Mobile. Ky faktor ndikon negativisht ne aftesite e EM per te kundervepruar ne treg ndaj sjelljes se dy rivaleve AMC dhe Vodafone.

Normat e larta dhe te qendrueshme te fitimit te AMC dhe Vodafone Albania, jane tregues i konkurrences se ulet dhe stimujve per koordinim midis ketyre dy kompanive.

- *Pengesa per Hyrjen ne tregun me shumice te akses dhe origjinimit te thirrjeve*

Sic eshte permendur ne analizen e tregut me pakice, megjithe ndryshimet ne kuadrin ligjor, qe ndikojne pozitivisht ne zvogelim te pengesave te hyrjes ne tregun e sherbimeve celulare me pakice, aktualisht ne tregun celular me pakice nuk ka ende ofrues te pavaruar sherbimesh apo MVNO. Ky fakt perben nje tregues se tregu celular me pakice vazhdon te kete de facto pengesa per hyrjen ne treg te ofruesve te sherbimeve, pengesa qe mund te vijne nga mungesa e detyrimeve per operatoret celulare per te dhene akses ne nivel me shumice per akses dhe origjinim te thirrjeve. Nderkohe hyrja ne tregun me shumice te aksesit dhe origjinimit te thirrjeve mund te behet vetem si operator rrjeti celular dhe pengesat me natyre ekonomike dhe teknike, per hyrjen ne treg si operator rrjeti celular, si kufizimi i spektrit te radiofrekuencave, numri i operatoreve te rrjeteve celulare ne treg, kostot e pakthyeshme dhe integrimi vertikal, jane karakteristike e sektorit te telefonise celulare. Keto pengesa, sidomos ne lidhje me spektrin theksohen edhe nga KE ne dokumentin: Explanatory Note to Recommendation 2007/879/EC per tregjet perkates **(C(2007) 5406)**

Niveli i konkurrencës efektive apo mungesa e saj në tregun me pakice celulare është tregues i rëndësishëm i problemeve që ekzistojnë në tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit të thirrjeve. Siç është theksuar dhe në kapitullin e mëparshëm, megjithatë AKEP gjykon se tregu me pakice celulare, nuk është me i justifikueshëm për nderhyrje ex-ante, nuk do të thotë që ky treg është tashmë në konkurrencë efektive.

AKEP gjykon se është ende herët të konkludohet se konkurrenca e mundshme e operatorëve të rinj të rrjeteve si dhe ofruesve të shërbimeve, do të zvogelojë ndjeshëm aftësitë ndikuese dhe stimujt për koordinim të AMC dhe Vodafone, për të rezultuar në konkurrencë efektive në tregun celulare me pakice.

AMC dhe Vodafone Albania kanë struktura të ngjashme të rrjetit, përdoruesve dhe për rrjedhojë edhe të kostove të ofrimit të shërbimeve. Simetria apo ngjashmëria e operatorëve në tregues të ndryshëm përben faktor ndikues në rritjen e stimujve për të koordinim dhe konkurrencë me të ulët.

AMC dhe Vodafone Albania janë dy operatorë të rrjeteve celulare:

- me të mëdhenj të tregut dhe pjesë tregu të ngjashme në vite,
- me numër dhe struktura përdoruesish, trafik telefonik dhe struktura të rrjetit të ngjashëm midis tyre;
- që operojnë në një treg me nivel penetrimi 110%;
- që janë të integruar vertikalisht dhe që në gjithë periudhën e aktivitetit të tyre nuk kanë pasur marrëdhënie me MVNO (megjithatë pretendohet se nuk ka pasur kërkesë);
- me norma shumë të larta fitimi;
- me pjesë tregu në të ardhura për shërbimet celulare me shumë se 95% (dhe afërsisht 80% të gjithë tregut të komunikimeve elektronike në Shqipëri)
- kanë aplikuar historikisht tarifa të larta të shërbimeve celulare me pakice. Nivelet e larta të tarifave, pas reduktimit të detyruar nga Metodologjia e rregullimit të tarifave celulare, janë me problematike për përdoruesit me kontratë;
- që lehtësisht mund të monitorojnë tarifën me pakice të njëri tjetrit
- operojnë në një treg që ka karakterike barriera të larta strukturore të hyrjes në treg si operator rrjeti apo MVNO;
- me FNT në tregjet e terminimit në rrjetet e tyre

Këta faktorë krijojnë stimuj për AMC dhe Vodafone Albania për koordinim të sjelljes së tyre, dhe konkurrenca të ulët në tregun me shumicë të aksesit origjinimit të thirrjeve celulare, pra për dominancë të bashkuar të këtyre dy operatorëve në këtë treg.

AKEP bazuar në përfundimet e mësipërme në Analizën 2010 gjykoj se tregu celulare me shumicë të aksesit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare nuk është në konkurrencë efektive dhe:

- sipërmarrësit AMC sh.a dhe Vodafone Albania sh.a përmbushin kriteret për FNT në tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit të thirrjeve nëpërmjet rrjeteve celulare.

- Masat Rregulluese

AKEP, gjykoi se detyrimet per AMC dhe Vodafone Albania, per FNT ne tregun e aksesit dhe origjinimit te thirrjeve ne rrjetet celulare, duhet te jene:

1. Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)
2. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)
3. Detyrimi i transparencës (Neni 40)
4. Detyrimi për ndarjen e llogarive (Neni 41)
5. Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (Neni 45)

AKEP, gjykoi ne 2010 se eshte e arsyeshme dhe proporcionale qe detyrimet e Vodafone dhe AMC per aksesin dhe origjinimin e thirrjeve ne rrjetet celulare, te jene:

- i. ne terma te rregulluara, perfshire tarifat, nga oferta reference e interkoneksionit per sherbimet drejt numrave te ofruesve te thirrjeve me karta te parapaguara (OSHKP) dhe numrave pa pagese 0800xxx;
- ii. ne terma komerciale per sherbimet e tjera te akses dhe origjinimit te thirrjeve perfshire MVNO, rishites te sherbimeve celulare te Vodafone Albania dhe AMC

Detyrimet e vendosura ne 2010, perfshinin midis te tjerave:

- Sipermarresit AMC sh.a. dhe Vodafone Albania Sh.a., te perditesojne Ofertat Referencë të Interkoneksionit, te miratuar me VKD nr.628, dhe nr.629 date 10.02.2009, per te perfshire sherbimin e akses dhe origjinimit te thirrjeve te pershtatur me ndryshimet dhe nevojat e tregut:
- Tarifa e aksesit dhe origjinimit te thirrjeve te thirrjeve dhe sherbimeve te interkoneksionit te lidhura me aksesin dhe origjinimin e thirrjeve ne rrjetet AMC dhe Vodafone Albania jane:
 - i. Objekt kontrolli nga AKEP per sherbimet origjinimit te thirrjeve drejt numrave te ofruesve te thirrjeve me karta te parapaguara (OSHKP) dhe numrave pa pagese 0800xxx, sipas percaktimeve ne pikat 2 dhe 3 me poshte;
 - ii. Objekt negociatash komerciale per sherbimet e tjera te akses dhe origjinimit te thirrjeve perfshire MVNO, rishites te sherbimeve celulare te sipermarresit Vodafone Albania Sh.a dhe AMC

Ne seksionin e meposhtem paraqiten disa perditesime mbi perfundimet kryesore te Analize 2010 dhe zbatimin e detyrimeve per akses/origjinimin e thirrjeve.

2. Perditesim mbi perfundimet e Analize 2010 per akses/origjinimin

Per sa i perket perkufizimit te tregut perkates, nuk ka ndryshime ne terma te dimensionit te produktit dhe sherbimeve, pervec faktit qe tregu i akses/origjinimit tashme perfshin edhe Plus Communication qe hyri ne treg ne fund te vitit 2010.

Nderkohe ne lidhje me faktoret e marre ne kosniderate per FNT:

- Gjate viteve 2010-2011 pjeset e tregut kane ndryshuar ndjeshem dhe dy operatoret e rinj kane rritur pjeset e tyre te tregut. AMC dhe Vodafone nuk kane me pjese tregu te ngjashme ne tregues te ndryshem si perdorues, thirrje, te ardhura sic kane pasur historikisht deri ne 2008-2009, madje tashme kane diferenca te ndjeshme (analize me e detajuar e pjeseve te tregut eshte bere ne seksionin IV.3);
- Konkurrenca ne nivelin me pakice per tarifat e sherbimeve eshte rritur ndjeshem dhe ka sjelle reduktime te tarifave edhe te AMC dhe Vodafone Albania-pa nderhyrje rregullatore ne nivel me pakice (analize me e detajuar e tarifave me pakice eshte bere ne seksionin IV.3);
- Te ardhurat dhe normat e fitimit te AMC dhe Vodafone Albania jane reduktuar ndjeshem ne 2010-2011 ne krahasim me periudhat e meparshme;
- Simetria midis rrjeteve per tregues te ndryshem ka ndryshuar ndjeshem ne 2010-2011.

Per sa i perket zbatimit te masave rregullatore:


- AMC dhe Vodafone Albania kane perfshire sherbimin e origjinimit te thirrjeve per kartat e OSHKP-ve ne RIO dhe me tarifat e rregulluara nga AKEP, perfshire tarifat e percaktuara ne 10.02.2011 per orientim ne kostot BULRAIC;
- Deri me tani nuk ka pasur kerkesa per MVNO, ndersa Vodafone ka lidhur 2 marrveshje me OSHKP dhe AMC eshte ne proces lidhjeje te nje marrveshje me OSHKP.

IV.2 Tregu me pakice i sherbimeve celulare

Në fund të vitit 2011, numri i pajtimtareve të telefonisë së lëvizshme u rrit me 15% krahasuar me vitin 2010 dhe arriti në afërsisht 5.2 milion, i cili përbën një normë penetrimi (numri i përdoruesve për 100 banorë) prej 185%¹⁷, që është shumë me e larte se niveli prej 140% ne vitin 2010¹⁸ apo niveli mesatar ne vendet e BE prej 124% ne 2010. Sic eshte theksuar edhe me pare rritja e numrit te pajtimtareve te telefonise celulare qe prej vitit 2001 ka qene ne shume me madhe se rritja e numrit te pajtimtarëve të telefonisë fikse. Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2011, arriti në rreth 339 mijë, nivel i cili përbën një rritje me rreth 7000 pajtimtare apo 2.2% në krahasim me rreth 332 mijë në fund të vitit 2010. Norma e penetrimit te telefonise fikse ne Shqiperi arriti në 12% krahasuar me 10% në vitin 2010, megjithatë ky nivel është ende shumë i ulët krahasuar me vendet e BE (me një mesatare prej 45%) dhe vendet e rajonit.

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë ndër vite të numrit të pajtimatrëve të telefonisë fikse dhe celulare, ku vihet re rritja shumë e madhe e telefonisë celulare dhe rritja shumë e vogël e telefonisë fikse.

FIGURA IV.1. ECURIA E NUMRIT TE PERDORUESVE TË TELEFONISË CELULARE DHE FIKSE 2000-2011




Ne figuren e meposhteme paraqitet tendenca e te ardhurave celulare ne periudhen 2003-2011, ku mund te vihet re se ne vitin 2010 ka pasur nje renie te konsiderueshme (11%) te te ardhurave ne

¹⁷ Numri i përdoruesve celularë i referohet numrit të kartave SIM aktive, dhe normat e larta të përdoruesve për 100 banorë shpjegohen nga mbajtja prej një individi e më shumë se 1 kartë SIM si dhe prej përdorimit të kartave SIM nga vizitorët në një vend.

¹⁸ Ne kete raport, shifra e perdorur per popullsine per vitin 2011 eshte rezultati paraprak i Census 2011 i publikuar nga Instat: 2,831,741. Treguesit e penetrimit (perdorimi ne baze te popullsise) jane me te larte se cdo te ishin po te perdoresh numri i popullsise sipas parashikimeve te meparshme.

krahasim me vitin e meparshem 2009, i cili ishte viti i pare qe shenoi renie te te ardhurave te ketij segmenti te tregut. Renia e te ardhurave ka vazhduar edhe ne vitin 2011 megjithese me nje norme me te ulet prej 6%. Totali i te ardhurave te kater operatoreve celulare per 2011 ishte rreth 39.2 miliard lek. Gjate 2011 renie me te madhe ka pasur AMC me 20% dhe Eagle me 6%. Ndersa Vodafone ka psur ndryshim te vogel me rritje prej 1%. Plus si operatori me i ri ka psur rritje te madhe me rreth 75 here, por duhet marre ne konsiderate se per vitin 2010 Plus ishte ne treg per vetem 1 muaj.

FIGURA IV.2: TE ARDHURAT E OPERATOREVE CELULARE 2003-2011



Aktualisht tregu i telefonise se levizshme ka kater lojtare aktive, me sherbimet e tyre por ne periudhen te cilen po analizojme, si ndryshime kryesore me efekte direkte apo indirekte ne tregun me pakice celular mund te konsiderohen:

- Hyrja ne treg e operatorit te 4-et celular, Plus Communication i cili u be aktiv ne Nentor 2010.
- Portabiliteti i numrit i cili aktualisht eshte bere aktiv dhe ka nje numer te konsiderueshem portimesh te kryera ndermjet rrjeteve celulare per nje periudhe kohore rreth 9 mujore;
- Berja aktive e teknologjise 3G per dy nga rrjetet celulare Vodafone Albania dhe AMC, dhenia e autorizimit per 3G per Vodafone, ne fillim te vitit 2011, ndersa per AMC eshte


dhene pas nje periudhe 6 mujore, si dhe eshte ne proces procedura per dhenien e autorizimit te trete per 3G;

- Percaktimin e kostove te sherbimit te interkoneksionit ne nivelin e shumices, te terminimit dhe origjinimit, ku aktualisht eshte percaktuar tarifa e terminimit dhe origjinimit e cila eshte e orientuar drejt kosos sipas rezultateve te BU-LRAIC, ne varesi te statusit te operatoreve te analizuar per FNT ne tregjet respektive, duke percaktuar edhe skedulin kohor ne te cilin jane percaktuar vlerat perkatese si dhe afati kohor i asimetrise ndermjet rrjeteve te operatoreve celulare ne treg;
- Reduktimi i tarifave te terminimit te SMS-ve nga operoret ne 2011 dhe percaktimi nga AKEP i skedarit kohor per reduktime te metejshme te kesaj tarife ne vitet ne vijim.

I. Pjeset e Tregut

Figurat e mëposhtme paraqesin pjesët e tregut për vitin 2011 për disa tregues kryesorë. Nga figurat mund të vëmë re AMC zotëron pjesë tregu më të madhe për numër pajtimtarësh me 37%, ndërsa Vodafone ka pjesë më të mëdha tregu për thirrje dalëse dhe SMS, me 51%. Eagle Mobile ka arritur në 21% pjesë tregu për numrin e pajtimtarëve ndërsa Plus rreth 8%.

FIGURA IV.3: PJESET E TREGUT TE OPERATOREVE CELULARE (2011)



Struktura e perdoruesve celulare, ne perdorues me parapagim dhe me pas-pagim (kontrate), vazhdon te jete e qendrueshme nder vite. Ne vitin 2011, 91% e pajtimtareve ishin perdorues me parapagim. Struktura e perdoruesve eshte e ngjashme per te kater operatoret celulare, megjithese Eagle Mobile ka rreth 14% te perdoruesve total me kontrate per vitin 2011, ne ndryshim nga tre operatoret e tjere qe kane 6-8% te perdoruesve total me kontrate.

Në tabelen e mëposhtme parqitet ecuria e pjesëve të tregut për 2009-2011 për numër pajtimtarësh, thirrje dalëse, dhe të ardhurat. Nga të dhënat vihet re se pjesët e tregut të AMC janë reduktuar për të katër treguesit, Vodafone ka reduktim në pjeset e tregut të pajtimtarëve dhe ndërsa ka rritje në tre treguesit e tjere. Eagle Mobile ka pasur rritje ne tregusit e pajtimtareve dhe te ardhurave dhe renie/rritje ne dy treguesit e tjere. Plus kanë rritje të pjesëve të tregut për të katër treguesit.

TABELA IV.1. PJESET E TREGUT TE OPERATOREVE CELULARE 2009-2011

| | | AMC | VODAFONE ALBANIA | EAGLE MOBILE | PLUS COMMUNICATION |
|---------------------------|------|------------|-----------------------------|-------------------------|-------------------------------|
| Perdorues | 2011 | 37% | 35% | 21% | 8% |
| | 2010 | 44% | 37% | 18% | 1% |
| | 2009 | 46% | 40% | 14% | - |
| Thirrje dalese | 2011 | 37% | 51% | 10% | 2% |
| | 2010 | 46% | 45% | 9% | - |
| | 2009 | 38% | 47% | 15% | - |
| SMS | 2011 | 37% | 51% | 10% | 2% |
| | 2010 | 34% | 57% | 9% | - |
| | 2009 | 36% | 49% | 15% | - |
| Te ardhura | 2011 | 34% | 52% | 12% | 2% |
| | 2010 | 40% | 48% | 12% | 0% |
| | 2009 | 42% | 49% | 9% | - |

Vlerat e indeksit HHI¹⁹ (Herfindahl-Hirschman Index) per vitin 2010-2011 per tregun celular ne Shqiperi i bazuar ne pjeset e tregut per numrin e perdoruesve dhe te ardhurat jane pasqyruar ne Tabelen e meposhtme (jane dhene ne vijim te tabelës qe pasqyronte keto vlera deri ne fund te vitit 2009).

TABELA IV.2. VLERAT E INDEKSIT HHI (2006-2011)

| | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 |
|----------------------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| Numri i Perdoruesve | 5007 | 5004 | 4248 | 3888 | 3630 | 3076 |
| Te ardhura | 5008 | 5004 | 4885 | 4254 | 4048 | 4008 |

Nga te dhenat e tabelës vihet re nje renie e vazhdueshme e ketyre vlerave, gje e cila tregon per renie te nivelit te perqendrimit te tregut. Vlerat e larta te treguesit HHI krahasuar me tregje qe konsiderohen jo te perqendruara apo moderisht te tilla eshte e pramueshme per telefonine celulare pasi eshte nje treg me numer te kufizuar lojtaresh. Vihet re se HHI per numrin perdoruesve ka reduktim te ndjeshem pas hyrjes ne treg te dy operatoreve me te rinj EM dhe Plus.

Ecuria e pjeseve te tregut nder vite tregon se dy operoret e medhenj AMC dhe Vodafone qe u shpallen me FNT ne tregun e akses dhe origjinimit ne 2010 kane humbur pjese tregu dhe dy operoret me te rinj Eagle Mobile dhe Plus Communication kane fituar dhe rritur pjeset e tyre te tregut.

II. Konkurrenca e mundshme ne tregun me pakice

Tregu celular aktualisht ndodhet ne nje faze ne te cilen operojne 4 operoret me rrjete te cilat kane nje mbulim te territorit por edhe te popullsisë pothuajse ne menyre te ngjashme pavaresisht se AMC dhe Vodafone Albania kane hyre ne treg shume vite me perpara se Eagle Mobile dhe Plus Communication. Dy operoret me te rinj ne treg zoterojne rrjetet e tyre celulare dhe me mbulim pothuajse te njejte territorial dhe te popullsisë me sinjal dhe rrjete GSM. Të dhenat për mbulimin territorial dhe të popullsisë deri në fund të vitit 2011, janë dhënë në tabelën e mëposhtme ku vihet re se mbulimi territorial me sinjal GSM është 90-93%, ndërsa mbulimi i pupullsisë me rrjet GSM është mbi 98% për secilin operator.

19 Vlera e HHI llogaritet si shuma e katroreve te pjeseve te tregut te te gjithe ofruesve. HHI <1000 tregu jo i perqendruar; HHI =1000-1800 tregu moderisht i perqendruar; HHI >1800 shume i perqendruar

TABELA IV.3: MBULIMI ME RRJET TE OPERATOREVE CELULARE 2011.

| DIMENSIONI I RRJETIT TE TELEFONISE SE LEVIZSHME | | AMC | VODAFONE | EAGLE | PLUS |
|---|---|------|----------|-------|------|
| Mbulimi i territorit me rrjet GSM | % | 90.0 | 93 | 92,3 | 90 |
| Mbulimi i territorit me rrjet UMTS | % | 71.0 | 65.5 | | |
| Mbulimi i popullsise me rrjet GSM | % | 99.8 | 99.7 | 98,41 | 98 |
| Mbulimi i popullsise me rrjet UMTS | % | 94.0 | 78 | | |

Nderkohe AMC dhe Vodafone kane mbulim edhe me rrjet UMTS, dhe kjo mund te konsiderohet avantazh ne konskuurencen ne retail. Megjithate dhenia e te drejtave per 3G eshte bere me tender publik dhe te kater operatoret kane pasur mundesine dhe kane marre pjese ne procedura konkurruese per alokimin e frekuencave 3G.

Njekohesisht ndikim pozitiv ne te ardhmen do te kene reduktimet e metejshme te tarifave të terminimit ne rrjetet celulare, te pershkruara ne kapitullin e analizes se tregut te terminimit. Sic eshte theksuar me pare efekti i reduktimit të tarifave të terminimit në rrjetet celulare do të ndikojë në rritjen e konkurrencës në tregun celular, nëpërmjet:

- Uljes së kostos së thirrjeve off-net celulare për operatorët duke krijuar mundësinë e reduktimit të tarifave të këtyre thirrjeve në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.
- Reduktimit të mundësive të operatorëve celulare për subvencionimin e thirrjeve telefonike në nivelin retail, një praktike e vënë re sidomos me thirrjet brenda grupeve të mbyllura të përdoruesve.

AKEP,parashikon që ndikimi i reduktimit të tarifave të terminimit në rrjetet celulare në konkurrencën në tregun me pakicë celular, të jetë më i madh se thjesht reduktimi i tarifave të thirrjeve jashtë rrjetit në masë të njejte me reduktimin absolut të tarifave të terminimit. Këto reduktime të tarifave të thirrjeve pritet të shoqërohen me reduktime të tarifave të SMS-ve (për shkak të reduktimit edhe të tarifave të terminimit të SMS-ve) ku pritet të çojnë në reduktime të mëtejshme të tarifave celulare dhe më të mëdha se ato që kanë ndodhur dy vitet e fundit.

III. Tarifat e shërbimeve celulare

Ne figurat e mëposhtëme paraqiten ecuria e tarifave celulare e matur me shpenzimet per shportat OECD dhe krahasimi me rajonin dhe mesataren e BE, sipas publikimit te Cullen International në Nëntor 2011. Nga ecuria dhe krahasimi rezulton se në vitin 2011 tarifat e matura me shpenzimet per shportat OECD janë reduktuar mesterisht me 30% dhe shpenzimet janë kryesisht sa niveli mesatar në vendet e BE ose më të ulëta.

- ♦ Shporta Low Usage: reduktim me 24%-45%

- ♦ Shporta Medium Usage: reduktim me 12%-39%
- ♦ Shporta High Usage: reduktim me 13%-45%.

Sic është theksuar edhe në raportet te mëparshme te AKEP, reduktimi i ndjeshëm i tarifave celulare në vitet e fundit, ka përmirësuar pozicionin e Shqipërisë në krahasim me vendet e BE duke e cuar afersisht në nivelet mesatare të këtyre shpenzimeve (nga nivelet maksimale deri në vitin 2008). Ky pozicion është përmirësuar në vitin 2011, duke pasur tarifa rreth nivelit mesatar të tarifave në vendet e BE, madje edhe më të ulëta.

Figura IV.4: Shpenzimet për shportat OECD



Ndërkohë në figurat e mëposhtëm parqitet krahasimi i dy treguesve të tjerë me vendet e rajonit dhe të BE.

- Cmimi mesatar per minute (Average Price Per Minute-APPM) e matur si raporti i të ardhurave të operatorëve nga shërbimet telefonike zanore me pakicë (përfshirë pagesat fikse) me numrin total të minutave dalëse. Ky tregues për Shqipërinë është dy herë më i ulët se mesatarja e vendeve të BE dhe ndër më të ulëtat në rajon.
- E ardhura mesatare për përdorues (Average Revenue Per User-ARPU), e matur si raporti i të ardhurave totale të operatorëve me numrin mesatar të përdoruesve gjatë një viti. Ky tregues për Shqipërinë në vitin 2010²⁰ ishte 70 Euro dhe sic vihet re nga figura është shumë më i ulët se mesatarja e vendeve të BE në vitin 2009 (244 Euro), si edhe se vendi me ARPU më të ulët në BE (Rumania me 90 Euro).

FIGURA IV.5: CMIMI MESATAR PER MINUTE I THIRRJEVE CELULARE (EURO PER MINUTE PA TVSH)





FIGURA IV.6: E ARDHURA MESATARE PER PERDORUES CELULAR (EURO/VIT PA TVSH)

²⁰ Per vitin 2011 ARPU per Shqiperine ishte 57 Euro.



Burimi: EC Electronic Communications Market Indicators

Nga te dhenat e mesiperme mund te konkludojme se ecuria e tarifave celulare ka qene positive ne drejtim te reduktimit te tyre qe perben tregues te rendesishem te rritjes se konkurrences ne tregun celulare me pakice.

Tarifat celulare ne nivelin e pakices ne periudhen kohore 2010-2011 kane njohur ne evolim te metejshem duke prezantuar tregues te rritjes se konkurrences. Keshtu qe niveli i tarifave celulare ne Shqipëri ne nivelin e pakices eshte i perafert me shumicen e vendeve te rajonit dhe ne disa prej kategorive eshte me mire se shumica e ketyre vendeve. Ndersa krahasuar me nivelin mesatar te vendeve te BE-se (EU-27), rezulton qe tarifat celulare jane shume te peraferta.

IV. Ecuria dhe niveli i normes se fitimit

Tabela e meposhtme paraqet disa tregues financiare per dy operatoret me te medhenj AMC dhe Vodafone Albania, te shpallur me FNT per aksesin dhe origjinimin e thirrjeve ne 2010. Nga te dhenat e tabelës vihet re qarte se treguesit e te ardhurave dhe fitimit kane pesuar rënie te ndjeshme ne vitet 2009-2011 si ne terma absolute dhe ne terma relative te normave te fitimit. Kjo tendence eshte ne drejtim te kundert me tendencen ne rritje te ketyre treguesve deri ne vitin 2008.

TABELA: IV. 4 TREGUES FINANCIARE TE VODAFONE DHE AMC 2008-2011

| | Vodafone Albania | | | | AMC | | | |
|--|------------------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|
| | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 |
| Te ardhura totale (million Lek) | 24,919 | 22,877 | 20,165 | 20,347 | 23,482 | 19,975 | 16,552 | 13,214 |
| Fitimi neto (million Lek) | 11,378 | 9,662 | 5,877 | 4,199 | 11,653 | 12,056 | 6,250 | 4,069 |
| Fitim neto/te ardhura (%) | 46% | 42% | 29% | 21% | 50% | 60% | 38% | 31% |

Burimi: Bilancet e kompanive

V. Perdorimi i sherbimeve nga perdoruesit

Ne vijim eshte dhene nje tabele me te dhena per perdorimin mesatar mujor per perdorues celulare. Perdorimi mesatar mujor per perdorues eshte llogaritur sipas thirrjeve dalese (thirrje qe gjenerohen nga nje perdorues) dhe thirrjeve hyrese (thirrjet e marra nga nje perdorues), te matura ne minuta. Ne vitin 2011 ka vazhduar tendenca e rritjes se perdorimit mesatar te thirrjeve telefonike qe ka filluar ne vitin 2009, megjithate kjo rritje ka qene shume me e vogel se rritja e ndjeshme ne 2009 dhe 2010. Konsumi mesatar i thirrjeve ne 2011 është rritur me 4-5%, ndërsa përdorimi i SMS-ve është rritur ndjeshëm me 21%. Ndersa krahasuar me vitin 2009 konsumi mesatar i thirrjeve ne vitin 2011 ka shenuar rritje te ndjeshme me 65%-84%. Ne vitin 2011, nje perdorues celular ka kryer mesatarisht 83 minuta thirrje dalese dhe ka marre 94 minuta thirrje hyrese, duke rezultuar ne 177 minuta komunikim ne muaj dhe ka derguar rreth 12 SMS ne muaj.

TABELA IV.5.PËRDORIMI MESATAR I SHËRBIMEVE CELULARE 2009-2011

| | 2009 | 2010 | 2011 | Ndryshimi 2011/2009 |
|--|------|------|------|------------------------|
| Thirrje dalese ne muaj | 45 | 80 | 83 | 84% |
| Thirrje te marra (hyrëse) ne muaj | 57 | 90 | 94 | 65% |
| MOU²¹ | 102 | 170 | 177 | 74% |
| SMS (dalëse) ne muaj | 12 | 10 | 12 | 0% |

²¹Minutes Of Use: Minuta perdorimi të matura me shumën e thirrjeve dalëse dhe hyrëse.

Rritje më të mëdha të përdorimit të shërbimeve dhe konsum më të madh kanë pajtimtarët e Vodafone, të cilët gjatë vitit 2011 kanë kryer mesatarisht 118 minuta telefonata dalëse në muaj, 257 minuta komunikim telefonik (thirrje dalëse dhe të marra) në muaj dhe 25 SMS të dërguara në muaj, vlera të cilat janë ndjeshëm më të larta se mesatarja e tregut.

Vlerat e raportuara në tabelat e mësipërme janë përlllogaritur mbi bazën e numrit total të pajtimtarëve të matura më kartat SIM aktive. Në vijim të komentit të bërë në hyrje të këtij kapitulli, për diferencën e madhe midis kartave SIM aktive dhe numrit të përdoruesve aktivë celularë, AKEP gjykon se minutat reale të përdorimit mesatar janë më të mëdha²² pasi një numër i konsiderueshëm pajtimtarësh janë vetëm përdorues sezonalë apo sporadikë (emigrantë, vizitorët që përdorin karka SIM të operatorëve celularë Shqiptarë gjatë qëndrimit të përkohëshëm apo vizitave në Shqipëri).

VI. Kostot dhe pengesat për te nderruar operatorët: portabiliteti i numrit

Ne lidhje me percaktimet e bera ne analizat pararendese per mungesen e portabilitetit te numrit si nje tregues negativ per mundesine zgjdhjes dhe perfitimet e perdoruesve celulare, mund te themi qe ne kete drejtim tregu ka njohur ndryshime pozitive, pasi me date 02.05.2011 u be i mundur implementimi i ketij sherbimi. Rezulton qe ky sherbim eshte aktiv dhe aktualisht ka nje tendence gjithnje e ne rritje te perdorimit te ketij sherbimi nga pajtimtarete e telefonise se levizshme. Portimi i pare u krye me 4.05.2011 dhe deri ne fund te muajit Mars 2012 (rreth 9 muaj) numri total i portimeve te kryera ishte rreth 55 mije.

Nje gje e tille ka bere te mundur qe sherbimet e ofruara ne nivelin e pakices nga operatoret celulare, te behen lehtesisht te zevendesueshme nga ana e pajtimtareve per secilin nga rrjetet qe deshirojne te jene pjese e tij, duke perfituar favoret qe lejon sherbimi i portabilitetit. Per portimin e numrit pajtimtari nuk paguan tarife, pra nuk ka pengese apo ndonje kosto per pajtimtarete per nderrimin e operatorit. Cdo detyrim financiar per kryerjen e sherbimit te portimit te numrit, nuk perben kosto per pajtimtarin qe perfiton kete sherbim, por per operatorin i cili merr kete pajtimtar.

Duke vezhguar levizjet e kryera nga nje rrjet celular ne nje rrjet tjeter ne kete periudhe rreth 9 mujore, rezulton qe te kater rrjetet celulare jane perballur si me shkeputjen e pajtimtareve nga

²² Duke perdorur numrin e pajtimtarëve aktive, vlerat e tabelës së përdorimit mesatar për vitin 2011 do të ishin 56% më të larta dhe me vlerat e mëposhtme:

| | |
|----------------|-----|
| Thirrje dalëse | 130 |
| Thirrje hyrëse | 147 |
| MOU | 277 |
| SMS | 19 |

rrjetet e tyre drejt rrjeteve homologe, por edhe me te kunderten, ardhjen e pajtimtareve ne rrjetet e tyre nga rrjetet homologe. Implementimi me sukses i portimit te numrit celular ka rritur perfitimet e perdoruesve celulare nepermjet rritjes se mundesise se zgjedhjes se paketave tarifore si dhe ka ndikuar ne rritjen e konkurrences ne treg midis operatoreve qe konkurrojne per te marre kliente nga njeri-tjetri si dhe per te ruajtur klientet aktuale te tyre, nepermjet paketave tarifore me te favorshme per perdoruesit.

VII. Sherbime te reja: 3G

Ne periudhen 2010 deri aktualisht ka pasur zhvillime pozitive ne ofrimin e sherbimeve 3G. Gjate nje periudhe me pak se dy vjecare AKEP ka zhvilluar tre procedura konkurimi per dhenie te drejtash per perdorim te frekuncave 1900/2100 MHz te cilat mundesojne ofrimin e shërbimeve të lëvizshme tokësore me brez të gjerë sipas standardit IMT-2000/UMTS. Ne baze te ketyre proceseve:

- Me datë 02.12.2010, Vodafone Albania u pajis me autorizim individual per frekuanca ne brezin 1900/2100 MHz per ofrimin e sherbimeve te standartit 3G pasi doli fituese e procedures se konkurimit per te drejten e pare 3G me 31.4 Milion euro oferte.
- Me datë 28.09.2011, AMC u pajis me autorizimin individual per frekuanca ne brezin 1900/2100 MHz per ofrimin e sherbimeve te standartit 3G, pasi doli fituese e procedures se konkurimit per te drejten e dyte 3G me 15.1 Milion euro oferte.
- AKEP ne fund te vitit 2011 dhe fillimi i vitit 2012 filloi proceduren per te drejten e trete te frekuncave 1900/2100 MHz per ofrimin e sherbimeve 3G, dhe me 24.02.2012 te dy operatoret e tjere (Eagle Mobile dhe Plus Communication) celulare moren pjese ne procedure, por me oferta me te vogla se cmimi me i ulet i pranueshem, duke bere qe procedura te anulohet.

Me datë 10 Janar 2011, Vodafone Albania lancoi për herë të parë këto shërbime ne Shqiperi dhe AMC shume shpejt pasi mori te drejten filloi ofrimin e sherbimeve. Te dy operatoret kane realizuar detyrimet e mbulimit territorial dhe te popullsisë sipas afateve kohore te autorizimeve. Nga te dhenat e tabelës se meposhteme mund te vihet re se numri i pajtimtareve qe perdoin sherbimte 3G ne te dy rrjetet eshte rreth 280 mije.

TABELA IV.6. TREGUESI TE OFRIMIT TE SHERBIMEVE 3G (2011)

| Treguesi | Njesia matese | AMC | VODAFONE | TOTAL |
|---|----------------------|---------------|-----------------|----------------|
| Numri i BTS per UMTS | numer | 151 | 360 | 511 |
| Mbulimi i territorit me rrjet UMTS | % | 71.0 | 65.5 | |
| Mbulimi i popullsisë me rrjet UMTS | % | 94.0 | 78 | |
| Numri pajtimtareve tetelefonise mobile me akses ne Internet broadband UMTS ne total: | numer | 55,000 | 228,249 | 283,249 |
| - nepermjet aparatit te telefonit celular | numer | 46,000 | 202,756 | 248,756 |
| - nepermjet cards/modems/keys (jo aparate celulare) | numer | 9,000 | 25,493 | 34,493 |

Njekohesisht perdoruesit me karta modem/USB 3G qe lejon aksesin ne internet nepermjet PC eshte rreth 34 mije qe perben 25% te pajtimtareve total (fiks dhe 3G) me akses broadband ne Shqiperi. Pra ne nje periudhe kohore me pak se nje vit perdorimi i sherbimeve duket se eshte i kenaqshem. Njekohesisht me hyrjen ne treg te AMC eshte vene re edhe reduktim i tarifave per sherbimet 3G. Konkurenca per keto sherbime te reja per konsumatorët pritet te jete akoma me e larte me hyrjen ne treg te operatoreve te tjere.

VIII. Perfundim per tregun me pakice te sherbimeve celulare

Nga sa u trajtua ne kete seksion rezulton se tregu me pakice i sherbimeve celulare ka shenuar zhvillim pozitiv ne dy vitet e fundit dhe konkurenca midis operatoreve eshte rritur ndjeshem. Nje perfundim i tille eshte bazuar ne tregues te tille si:

- Renia e pjeseve te tregut te AMC dhe Vodafone Albania dhe rritja e pjeseve te tregut per hyresit me te rinj ne treg Eagle Mobile dhe Plus Communication;
- Reduktimi i tarifave celulare te perdoruesve ku tregues te tille si shpenzimet e per shportat OECD kane shenuar reduktime te ndjeshme, e ardhura mesatare per minute eshte nder me te ultat ne rajon dhe dy here me ulet se mesatarje e BE si dhe ARPU eshte me shume se 3 here me ulet se mesatarja e BE dhe e vogel se niveli me i ulet i ARPU ne vendet e BE;
- Pritshmerite per nje konkurrence akoma me te madhe nga reduktimi dhe orientimi ne kostot BULRAIC i tarifave te terminimit ne rrjetet celulare si dhe reduktimet e metejshme ne tarifat e terminimit te SMS-ve;
- Reduktimi i te ardhurave, fitimeve dhe nomrave te fitimit te AMC dhe Vodafone Albania;
- Rritja e ndjeshme e perdorimit mesatar te thirrjeve telefonike ne periudhen 2010-2011 krahasuar me periudhat e meparshme;
- Rritja e perfitimeve te perdoruesve nga implementimi i portabilitetit te numrit celular dhe fillimi i ofrimit te sherbimeve 3G nga dy operatore

AKEP ne vijim te komenteve te paleve te intersuara, gjykon se shqetesimet e EM (te dhena edhe ne komente per pyetje te tjera) dhe operatoreve te tjere per tarifat on-net/off-net mund te adresohen ne nje moment tjetër me nje analize me te detajuar te efekteve pozitive dhe negative ne konkurrencen ne tregun me pakice dhe hipotezat per sjellje te mundshme antikonkurruese te operatoreve te medhenj, mbase edhe ne bashkepunim me Autoritetin e Konkurrences.

IV.3 Aplikimi i testit te tre kritereve per akses/origjinimin

Sic eshte theksuar ne fillim te ketij kapitulli, tregu me shumice i aksesit dhe origjinimit te thirrjeve ne rrjetet e levizshme, eshte pjese e listes se tregjeve te Rekomandimit 2003 te KE-se, por nderkohe eshte hequr nga lista e tregjeve te Rekomandimit te viti 2007 te KE. Megjithese bazuar ne rregulloren e Analizes se tregut, nuk eshte e nevojshme qe te kryhet nje analize e testit te tre kritereve nese ky treg eshte treg perkates i justifikueshem per nderhyrje ex-ante, kur tregu eshte pjese e listes se Rekomandimit 2003 te KE, AKEP bazuar ne zhvillimet e tregut ne keto dy vite gjykon se eshte e nevojshme te behete nje analize e ketyre tre kritereve.

Testi i tre kritereve eshte pershkruar ne Rregullore (pika 4 e nenit 3) dhe eshte i njejte me testin e rekomanduar nga KE dhe sipas ketij testi qe nje treg te percaktohet nese eshte treg i justifikueshem per nderhyrje ex-ante, per kete treg duhet te plotesohen te tre kriteret e meposhteme:

- 1.prezenca e barrierave te larta dhe jo-kalimtare te hyrjes ;*
- 2.nje strukture tregu e cila nuk ka tendence per te shkuar ne drejtimin te nje konkurrence efektive brenda afatit kohor perkates; dhe*
- 3.pamajftueshmeria e ligjit te konkurrences per te adresuar ne menyre te pershtatshme deshtimin e tregut te marre ne shqyrtim*

Direktivat dhe rekomandimet e KE, vecanerisht dokumenti COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT, EXPLANATORY NOTE(Brussels, 13/11/2007 SEC(2007) 1483/2), qe shoqeron Rekomandimin e KE te vitit 2007 per tregjet perkates, e bejne te qarte se qe nje treg te jete i justifikueshem per nderhyrje ex-ante, duhet te realizohen te tre kushtet. Nese edhe njeri prej tyre nuk realizohet atehere tregu nuk mund te kosniderohet si treg i justifikueshem per nderhyrje ex-ante. Ne kete rekomandim Komisioni ka shpjeguar edhe arsyet krejsore per heqjen e tregut te akses origjinimit te thirrjeve celulare nga lista e tregjeve perkates, arsyetime te cilat do te perdoren edhe me poshte si pike reference per aplikimin e ketij testi ne kushtet e tregut ne Shqiperi.

- 1. Prezenca e barrierave te larta dhe jo-kalimtare te hyrjes*

KE citon se ky treg ka akoma pengesa per hyrje, pasi sipermarresit qe nuk iu eshte caktuar spekter mund te hyjne ne treg vetem ne baze te alokimeve te ardhshme te spektrit dhe/ose tregtimt sekondar te tij. Kjo pengese mund te mos jete pengese absolute nese operatoret ne menyre vullnetare bien dakord per te perdorur ne menyre te perbashket spektrin. Gjithashtu nje faktor qe ndikon ne reduktimin e barrierave eshte ndryshimi teknologjik dhe mundesite per te ndare (perdorur ne menyre te perbashket) elemente te rrjetit, duke i bere pengesat jo te mundshme per te persistuar ne periudhe afat-mesme deri afatgjate.

Ne Shqiperi pengesat ne lidhje me spektrin vazhdojne te jene prezente dhe nuk pritet qe ne nje periudhe afat-mesme keto pengesa te reduktohen. Megjithate ne kete kontekst vlen te theksohet se gjate periudhes se marre ne shqyrtim operatori i katert celulare Plus Communication hyri ne treg ne Nentor 2010 dhe ka arritur te perfitoje pjese tregu prej 8% per perdorues deri ne fund te vitit 2011. Nje faktor tjeter i rendesishem per tu marre ne konsiderate eshte fakti se per nje periudhe 2 vjecare nga vendosja e statusit me FNT per kete treg dhe e detyrimeve per AMC dhe Vodafone Albania per dhenie akses per MVNO, te dy operatoret nuk kane pasur kerkesa nga MVNO. Pra megjithate detyrimet rregullatore te vendosura, duket se interesi per te ofruar sherbime ne nivelin e pakices pa qene nevoja e ndertimit te nje rrjeti te mirefillte celular akoma nuk eshte shfaqur. Mungesa e ketij treguesi, nder te tjera, tregon mungese interesi per ofrimin e ketyre sherbimeve te formave te ndryshme ne te cilat mund te konsiderohet nje MVNO.

Faktoret e marre ne konsiderate per kete kriter rezultojne jo determinues pasi ka argumenta pro dhe kunder. Megjithate AKEP gjykon se argumentat pro prezences se pengesave jane me te forte dhe per kete arsye gjykon se ky kriter realizohet.

Per sa me sipër, AKEP gjykon se ***Kriteri 1 i testit permbushet***

2. Nje strukture tregu e cila nuk ka tendence per te shkuar ne drejtimin te nje konkurrence efektive brenda afatit kohor perkate.

KE ne metodologjine e perkufizimit te tregjeve perkates per nderhyrje ex-ante dhe ne analizimin e ketij tregu per te mos qene pjese e listes, thekson se niveli i konkurrences ne tregun e lidhur me pakice (ne kete rast tregu me pakice i sherbimeve celulare) eshte tregues qe nderhyrja rregullatore ex-nate ne nivel me shumice mund te mos jete e nevojshme. KE citon gjithashtu se tregjet me konkurrese kane MVNO dhe se jane dy interpretime (jo perjashtuese) per kete: se pari hyrja e MVNO i ben tregjet me pakice me konkurrese dhe se dyti tregjet konkurrese ofrojne akses per MVNO vullnetarisht. Nderkohe nga analizat e kryera ne vendet e BE per kete treg qe ka qene pjese e listes se vitit 2003 rezulton se shume pak vende kane konkluduar se ne kete treg ka FNT.

Analiza e kryer ne seksionin pararendes konkludoi se konkurenca ne nivelin me pakice celulare eshte intensifikuar ndjeshem ne dy vitet e fundit si dhe prishmerit jane qe kjo konkurrence te rritete akoma me shume ne te ardhmen. Nje problem i evidentuar ne Analize 2010 ka qene problem i tarifave te larta per thirrjet jashte rrjetit dhe tarifave shume te ulta per thirrjet brenda grupeve te mbyllura brenda rrjetit. Kjo tendence ka cuar ne rezultatin qe thirrjet brenda rrjetit

zene nje perqindje shume te larte te totalit te thirrjeve dalese te perdoruesve celulare. Megjithate ky problem duhet te vije ne reduktim me reduktimin e metejshem te tarifave te terminimit dhe orientimin ne koston BULRAIC te ketyre tarifave qe per dy operatoret e shpallur me FNT per akses/origjinimit ne 2010 do te realizohet ne shtator 2013. Keto reduktime pritet te reduktojne stimujt per tarifa shume te ulta brenda rrjetit dhe njekohesisht te rrisin aftesine konkuruese te dy operatoreve me te vegjel. Nga analiza e tregut me pakice rezultoi gjithahstu se pjeset e tregut te dy operatoreve AMC dhe Vodafone kane filluar te kene ndryshime te ndjeshme me njeri tjetrin, ne te kundert te pjeseve te tregut te ngjashme ne vitet e meparshme.

Per sa me siper, AKEP gjykon se ***Kriteri 2 i testit nuk permbushet***

3. Pamjaftueshmeria e ligjit te konkurences per te adresuar ne menyre te pershtatshme deshtimin e tregut te marre ne shqyrtim

KE citon se ne disa raste mund te ndodhe qe kompanite te kene nje stimul per sjellje te koordinuar te nenkuptuar per te zvogeluar dinamiken normale konkurruese. Ne kete sektor, megjithese individualisht operatoret celulare mund te kene stimul per te lejuar akses ne rrjetet e tyre per MVNO, operatoret mund te jene me mire nese kolektivisht nuk ofrojne akses ne rrjet per MVN. Normalisht probleme te tilla qe mund te shfaqen ne tregje me pakice dhe me shumice mund te adresohen nga ligji i konkurences. Megjithate KE citon se nga evidencat ky treg tenton drejt konkurences efektive pavaresisht se mund te ekzistojne barriera per hyrje dhe prandaj ky treg nuk eshte me ne listen e tregjeve perkates per nderhyrje ex-ante.

Situata ne Shqiperi ku ne treg tashme jane kater operatore dhe pjeset e tregut te dy operatoreve te medhenj jane reduktuar dhe nuk jane me te ngjashme, mundesite per sjellje te koordinuar te nenkuptuar (kolektive) te dy operatoreve jane reduktuar ndjeshem dhe sidomos mundesite e sjelljes se koordinuar te nenkuptuar nga kater operatore jane shume here me te vogla. Sic edhe citon KE ky problem mund te zgjidhet nepermjet ligjit te konkurences.

Per sa me siper, AKEP gjykon se ***Kriteri 3 i testit nuk permbushet***

Megqenese nga tre kriteret plotesohet vetem njeri prej tyre dhe te tjeret nuk plotesohen, ne perputhje me rregulloren e analizet se tregut dhe rekomandimet e KE, tregu me shumice i aksesit dhe origjinimit te thirrjeve ne rrjetet celulare nuk ploteson testin e tre kriterëve dhe nuk konsiderohet si treg i justifikueshem per nderhyrje ex-ante.

IV.4 Perfundim mbi tregun me shumice te aksesit dhe origjinimit te thirrjeve ne rrjetet celulare

Ne perputhje me nenin 3, pika 5 e Rregullores se Analizes se Tregut (miratuar me VKD nr. 747, date 17.07.2009) tregu me shumice i aksesit dhe origjinimit te thirrjeve ne rrjetet celulare, tregu nr.16 ne Rregulloren e Analizes se Tregut, do te hiqet nga lista e tregjeve perkates, te nevojshem per nderhyrje ex-ante dhe nuk ka nevojë per analize per FNT te ketij tregu.

Duke u bazuar ne perfundimin se tregu me shumice i aksesit dhe origjinimit te thirrjeve ne rrjetet celulare nuk ka nevojte per nderhyrje ex-ante, si dhe ne baze te nenit 34, pika 3 te ligjit 9918, AKEP, propozon se heqja e detyrimeve per FNT te AMC dhe Vodafone Albania te percaktuara me VKD nr.1210, date 30.03.2010 dhe VKD nr.1211, date 30.03.2010, te behet efektiv 6 muaj pas marrjes se vendimit nga AKEP per FNT ne tregjet celulare, sipas dokumentit te analizes finale qe do te publikohet pas konsultimit publik. Pra deri ne fund te periudhes 6 mujore detyrimet do te jene ende ne fuqi dhe efektive. Nese, pas kesaj periudhe te heqjes se detyrimeve ne treg do te shfaqet ndonje kerkese per ofrim te sherbimeve te cdo lloj forme te MVNO-s, ne mungese te arritjes se marreveshjeve me operatoret celulare ne treg mbi baza komerciale per ofrimin e sherbimeve te kerkuara, atehere AKEP nderhyn duke e zgjidhur si nje mosmarreveshje me kompetencat qe ligji 9918 (neni 120) percakton.

Heqja e detyrimeve per AMC dhe Vodafone perfshin dhe detyrimet per dhenie aksesit per operatoret e kartave me parapagim dhe me tarifa origjinimi sipas vlerave te skedarit kohor te percaktuar ne Shkurt 2011 per orientimin ne kostot BULRAIC. Meqenese keto sherbime kane nje ndikim pozitiv ne tregun me pakice dhe ne Shqiperi jane te zhvilluara dhe per shkak te numrit shume te larte te perdoruesve celulare, mund te konsiderohet e arsyeshme qe ky detyrim te vazhdoje te ekzistojte per te dy operatoret. Megjithate lenia e ketyre detyrimeve vetem per keta dy operatore nuk mund te kryhet sipas statusit me FNT, pasi nese nje operator nuk ka status me FNT nuk mund ti vendosen detyrime te referuara neneve 39, 40, 41, 42 e 45 te ligjit 9918. Detyrime te tilla (jashte FNT) mund te vendosen per te kater operatoret celulare ne rast se gjykohet e arsyeshme sipas neni 51 te ligjit 9918.

Per mundesite e aplikimit te nenit 51 per 4 operatoret celulare per dhenie aksesit per operatoret e kartave me parapagim dhe me tarifa origjinimi sipas vlerave te skedarit kohor te percaktuar ne Shkurt 2011 per orientimin ne kostot BULRAIC, AKEP kerkoi komente nga palet e interesuara gjate konsultimit publik

Ne perfundim te konsultimit publik dhe komenteve, AKEP konsideron sherbimin e kartave te parapaguara si nje nder sherbimet qe ka ndikuar ne zhvillimin e konkurrences ne tarifat e thirrjeve telefonike, si nje mundesi shtese per konsumatoret e thirrjeve, ndaj ne vijimesi do te tregojte nje vemendje rregullatore te kujdesshme ne respekt te percaktimeve ligjore dhe akteve rregullatore ne fuqi. AKEP gjykon se aplikimi i nenit 51 do te ishte me i pershtatshem, nese kjo justifikohet si mase e nevojshme per rritjen e mundesive dhe perfitimeve maksimale te perdoruesve te sherbimeve ne tregun e komunikimeve elektronike celulare.

Gjithsesi duke qene se implementimi i detyrimeve sipas nenit 51 do te behej per here te pare nga AKEP, kjo kerkon nje analize te detajuar e cila mund te ndermerret ne nje faze te mevonshme kur te konsiderohet e arsyeshme nga AKEP. Gjithsesi, AKEP siguron operatoret se cdo hap i ri qe mund te ndermerret ne kete drejtim do jete ne nje bashkerendim veprimesh me operatoret dhe transparent sipas praktikave me te mira te ndjekura edhe nga rregullatore te tjere ne kete drejtim.

ANEKS 1. KOMENTET NE KONSULTIM PUBLIK DHE QENDRIMI I AKEP

Ne dokumentin per konsultim publik, AKEP kishte hartuar disa pyetje rreth te cilave kerkonte komente nga palet e interesuara, duke mos u kufizuar te drejten per t'u shprehur edhe jashte ketyre pyetjeve.

Ne perfundim te fazes se konsultimit ne aAKEP jane depozituar komente nga operatoret: Albanian Mobile Communication, Vodafone Albania, Eagle Mobile, Plus Communications, Albtelecom, Neofone dhe Alban Tirana Nascendo. AKEP, falenderon operatoret e cituar me siper per perfshirjen me komentet e tyre ne dokumentin e konsultuar.

Sjellim ne vemendje se pothuajse nga te gjithë operatorët e perfshire me komentet e tyre është ruajtur struktura e pergjigjeve sipas renditjes te pyetjeve te bera nga AKEP, duke i reflektuar ne komentet e tyre. Duke qene se komentet jane voluminoze, pasi jane paraqitur edhe ne formen e nje sinteze te pergjithshme, por ne te njejten kohe e njejta pergjigje gjendet edhe ne version te reduktuar tek lista e pyetjeve te shtruara nga AKEP, pjesen e arsytetimeve te perseritura nga dokumenti i konsultuar, ose zgjerimin “analize mbi dokumentin e analizes”, gjykohet e arsyeshme te reduktohet, por duke ruajtur thelbin e komentit si ne rastin e dakortesise me qendrimet dhe konkluzionet e AKEP edhe ne rastin e kundestimeve apo argumenteve ilustruese qe mbeshtesin kundershtimet sipas rastit.

Ndaj per orientim te lexuesit, ne vijim do te gjeni nje renditje te tille:

- pyetjen e hartuar nga AKEP ne konsultim publik;
- komentet/pergjigjet e secilit operator mbi kete pyetje, si dhe
- qendrimin e mbajtur nga AKEP per komentet perkatese

1. A mendoni se terminimi i thirrjeve ne rrjetin celular te Plus Communication perben nje treg perkatese?

Pergjigje e AMC:

Operatori Plus Communications është tashme aktiv prej me shume se 1 viti e gjysem qe operon ne tregun shqiptar te komunikimeve elektronike, dhe ka njohur nje rritje te konsiderueshme te kuotave si ne numer perdoruesish, ne terma te te ardhurave, apo dhe te thirrjeve hyrese dhe dalese.

Prandaj, tregu i terminimit per operatorin Plus Communications i ploteson te gjitha kushtet per te qene nje treg me vete, dhe si i tille, i ka te gjitha karakteristikat e tregjeve te tjera te terminimit te thirrjeve zanore per tre operatorët celulare, per shpalljen e Plus me FNT ne kete treg si dhe vendosjen e masave dhe detyrimeve rregullatore.

Ne mendojme qe analiza ne perkufizimin e ketij tregu duhej te ishte ndermarre me pare nga AKEP, pasi tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin e levizshem te ketij operatori ka perbere nje treg perkates qe ne momentin qe operatori Plus Communications ka filluar te jete aktiv ne tregun e komunikimeve elektronike.

Per sa i perket perkufizimit te ketij tregu si nje treg perkates me vete, dhe faktoreve qe cojne ne nje perfundim te tille (zevendesueshmeria nga ana e kerkeses/ofertes; praktika CPP; mungesa e alternativave te produkteve te tjera; etj), mendojme qe jemi shprehur dhe ne analizen e meparshme Mars 2010, dhe te njejtat konsiderata qe lidhen me perkufizimin e tregjeve te terminimit per operatoret e tjere me FNT ne tregjet perkates te terminimit, vlejne dhe per perkufizimin dhe identifikimin e tregut te terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin e Plus si nje treg me vete.

Tregu i terminimit te thirrjeve ne rrjetin e Plus eshte nje treg tipik monopolist, pasi i ploteson te gjitha kriteret e nevojshme sic jane: kuota e kontrollit ne treg nga ana e operatorit Plus (100% e kuotes ose market share), testi i monopolistit hipotetik ne perkufizimin e nje tregu monopolistik, zevendesueshmeria nga ana e kerkesese dhe ofertes, territori gjeografik.

Asnje operator tjetër nuk mund kete akses ne rrjetin e ketij operatori ne terminimin e thirrjeve perkatese ne kete rrjet, duke bere qe Plus te kete 100% te ketij tregu, duke tejkualuar pragun e 25% te kuotes sic parashikohet dhe ne direktivat perkatese per te percaktuar nivelin se kur nje treg ploteson kushtet per te qene ne nje shtuate monopolistike.

Pergjigje e Vodafone :

1. Vodafone Albania thekson se terminimi i thirrjeve ne rrjetin e Plus Communication absolutisht perben nje treg perkates. Ky eshte nje qendrim i pandryshueshem i Vodafone Albania, shprehur qe ne komentet tona pararendese pergjate analizes se tregut te telefonise celulare ne vitin 2010. Megjithate, AKEP deri ne daljen e kesaj Analize nuk ka ndermarre asnje hap konkret per te vendosur ne vend kete deformim tregu i cili demton te gjitha palet pjesemarrrese ne proces, perfshire konsumatorin fundor. Ky qendrim jo-aktiv ka rezultuar ne konflikte te vazhdueshme mes operatoreve celulare ne lidhje me statusin e Plus, si dhe ka legjitimuar indiferencen dhe neglizhencen e ketij operatori per te zbatuar vendimet rregullatore te AKEP, sic eshte dhe rasti me VKD nr. 1505 date 10.02.2011 dhe analizen e kostove BULRAIC.
2. AKEP e ka ngritur kete ceshtjeqe ne analizen e vitit 2007 duke u shprehur se “nje operator ka status prej monopolisti ne tregun me shumice te terminimit ne rrjetin e tij perkates”. Kjo eshte shprehur qarte dhe ne Analizen pararendese te Tregut Celular (shpallur ne VKD 1211 date 31.03.2011), ku AKEP ka pohuar se te gjitha operatoret e rrjeteve celulare qe jane aktive ne treg jane percaktuar si operatore FNT per terminimin e thirrjeve (Faqe 46 e Aneksit 1 te VKD Nr.1211). Po ne faqen 59 te kesaj analize, AKEP ka deklaruar se ai “*siguron lojtaret e tregut se AKEP do te monitoroje situaten pas hyrjes ne treg te Plus nepermjet daljes me vendim te vecante per FNT te*

ketij operatori dhe/ose nderhyrjes per zgjidhje te mosmarreshjeve te interkoneksionit, nese do te kete te tilla". Gjithashtu ne vazhdim te ketij dokumenti: [...] Kjo nuk perjashton mundesine e nderhyrjes se AKEP, me vendim te vecante per terminimin ne rrjetin Mobile 4AI, pas hyrjes ne treg te ketij operatori (Analiza e tregut celular, Mars 2011, faqja 59).

3. Arsyetimi i AKEP, i mbetur ne leter deri tani, gjen mbeshtetje te plote dhe ne dokumentat rregullatore te BE-se. Po ti referohemi specifikisht dokumentit ERG (07) 83 final 080312 te ERG (European regulators Group) *ERG's Common Position on symmetry of fixed call termination rates and symmetry of mobile call termination rates*, (faqe 66) aty saktësohet se: [...] rezulton se te gjithë operatorët e rrjeteve celulare aktive ne treg jane percaktuar si operatore me FNT per terminimin e thirrjeve. Detyrimisht numri i operatoreve celulare me FNT eshte i njejte me numrin e operatoreve celulare te licensuar [...]
4. Ne vazhdim, ne dokumentin shpjegues te KE per Rekomandimin e Tregjeve Perkates ne vitin 2007, (*EC 2007 1483/2, Commission Staff Working Document Explanatory Note*) thuhet se [...] percaktimi i tregut te terminimit per secilin rrjet celular nenkupton se cdo operator celular eshte furnizuesi i vetem i ketij sherbimi ne ate treg [...]
5. Per sa me lart, AKEP gjendet ne kushtet e nenit 34/2 te Ligjit 9918 ku qartazi percaktohet se [...] Nëse AKEP-i përcakton se një ose disa sipërmarrës kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës, pra nuk ka konkurrencë efektive, atëherë ajo vendos ndaj tyre një, disa ose të gjitha detyrimet e veçanta të nevojshme, të cilësuar në nenet 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 e 56 të këtij ligji [...] dhe ne kushtet e nenit 37 [...] kur AKEP gjykon se faktet qe justifikuan perfundimet e arritura ne percaktimin dhe analizen e tregjeve kane ndryshuar, dhe nuk pasqyrojne situaten aktuale ne treg, atehere rishikon perfundimet dhe vendimet perkatese [...].

KONKLUZIONE:

Vodafone Albania konsideron se ne baze te Ligjit 9918, nenet 33, 34 dhe 37 dhe VKD nr. 1173 date 19.02.2010 (per hyrjen e Plus ne treg); dhe

Mbeshtetur ne: ERG (07) 83 final 080312 te ERG (European regulators Group) *ERG's Common Position on symmetry of fixed call termination rates and symmetry of mobile call termination rates*, dokumentin shpjegues te KE per Rekomandimin e Tregjeve Perkates ne vitin 2007, (*EC 2007 1483/2, Commission Staff Working Document Explanatory Note*, VKD Nr.1211 – Analiza e tregut celular ne Mars 2010, por edhe ketij dokumenti per Keshillim Publik,

- AKEP duhet te marre menjehere nje vendim formal per ti dhene status OFNT operatorit Plus.
- AKEP, paralelisht, duhet te procedoje menjehere me njohjen formale te tarifave te terminimit si detyruese per kete operator sipas modelit te kostove te miratuar BULRAIC (sic edhe ka ndodhur me 3 operatorët e tjere celulare). Cdo tarife tjeter terminimi e aplikuar pertej analizes se kostos, sipas Ligjit 9918, nenet 45 dhe 53, eshte abuzive, shperdoruese dhe antikonkurrenuese dhe si e tille demton konsumatorët dhe tregun.

Pergjigje e Eagle Mobile:

Sipas përkufizimit të tregjeve përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, çdo operator celular është monopolist në ofrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve në rrjetin e vet, për rrjedhojë, terminimi i thirrjeve në rrjetin Plus Communication përbën një treg përkatës. Operatori Plus plotëson kriteret e sipërmarrësit me FNT në këtë treg pasi zotëron 100% të tregut të terminimit të thirrjeve në rrjetin e tij dhe është aktiv që prej muajit Nëntor 2010. Gjithashtu, ruajtja e tarifës së lartë të terminimit në rrjetin e vet për një periudhë të gjatë kohore dhe pamundësia e operatorëve të tjerë për të ofruar terminim në këtë rrjet, dëshmon se Plus plotëson kriteret për FNT në tregun e vet të terminimit të thirrjeve.

Pergjigje e Plus Communicatios:

Tregu i terminimit në PLUS mund të përcaktohet treg përkatës sipas kushteve dhe përkufizimeve të parashtruara nga AKEP, duke evidentuar se PLUS mbetet monopolist në origjinimin e thirrjeve dhe në terminimin e thirrjeve në rrjetin PLUS.

Por a ka zëvendësues për këtë shërbim? Indirekt po, janë portimi i numrit në operatorë të tjerë dhe impakti që ka pesha e vogël që zënë në treg përdoruesit e PLUS.

Megjithë vlerësimin për statusin monopolist, terminimi varet nga pala thirrëse (calling party), ku fuqia blerëse është vendimarrëse sidomos për shkak të penetrimit të lartë në treg (185%) dhe cdo konsumator ka me shumë se një kartë SIM, prandaj klienti mund të marrë shërbimin që do, duke përdorur karta SIM zëvendësuese. Në këtë situatë, PLUS humbet në treg, dhe koncepti i tregut përkatës kthehet në irrelevant.

Pergjigje e NEOFONE:

Po, terminimi i thirrjeve në rrjetin celular të Plus Communication përben një treg përkatës, pasi në rrjetin e tij cilido operator është FNT.

Qendrimi AKEP:

Vlereson komentet e ardhura në përgjigje të pyetjes së parë për dakortësinë në lidhje me perfundimet e AKEP në dokumentin e konsultuar, komente të cilat mbështesin konkluzionet e AKEP, pavarësisht pretendimit dhe arsyetimeve që sjellin AMC dhe Vodafone sipas të cileve statusi me FNT për Plus duhej dhënë që në momentin e hyrjes në treg.

AKEP sjell në vëmendje se ka respektuar të njëjtin parim edhe për operatorin Plus si për operatorët e tjerë në fazën e hyrjes së tyre në treg, duke lejuar berjen e tyre aktiv dhe me pas kryerjen e analizës së tregut.

2. A mendoni se të katër operatorët celularë aktiv në treg, përfshirë Plus Communication, përmbushin kriteret për FNT në terminim?

Pergjigje e AMC:

Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetet celulare eshte nje treg tipik monopolist, ku verehet nje ndikim i konsiderueshem i operatoreve per te percaktuar tarifat e terminimit, dhe eshte e nevojshme per kete arsye nje nderhyrje rregullatore.

Te njejtat konsiderata vlejne dhe per tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin e operatorit Plus, si nje treg tipik monopolist, i cili, pra, i ploteson te gjitha kriteret qe cojne ne nje situatë monopolistike: testi i monopolistit hipotetik, kuotat ne treg ne 100%, zevendesueshmeria nga ana e kerkeses/ofertes. Ne nje treg te tille operatori Plus ka nje ndikim te konsiderueshem ne percaktimin e tarifave perkatese te terminimit, duke shfrytezuar pozitat dominante ne treg qe ai zoteron. Operatori Plus i permbush kushtet per statusin me FNT per shkak te pozites dominante.

Ne jemi dakort me konkluzionin e AKEP ne kete dokument-analize qe te kater operatoret i permbushin kriteret per te pasur FNT ne tregun e terminimit.

AMC me pas ka dhene komente te ngjashme per shpalljen me FNT te Plus si ne pyetjen e pare.

Ne perfundim, mendojme qe statusi FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve zanore permbushet nga te 4 operatoret celulare, duke rregulluar dhe qartesuar mosmarreshjet e krijuara deri tani, ndaj dhe pse me vonese, ne e mbeshtesim kete konkluzion te AKEP.

Pergjigje e Vodafone :

Vodafone Albania shprehet dakord me perfundimin e arritur nga AKEP; Tregu i terminimit te thirrjeve ne rrjetin telefonik te levizshem eshte treg ku duhet te vendoset rregullimi ex-ante per te kater operatoret celulare pa perjashtim, pasi ky treg eshte edhe ne listen e tregjeve te rekomanduara per rregullim nga Rekomandimi i KE i vitit 2007, (tregu nr. 7 - voice call termination on individual mobile networks).

KONKLUZIONE:

- Vodafone Albania riperserit qendrimin e saj se Tregu i terminimit te thirrjeve ne rrjetin telefonik te levizshem eshte treg ku duhet te vendoset rregullimi ex-ante per te kater operatoret celulare pa perjashtim.
- Terminimi i thirrjeve ne rrjetin e Plus Communication perben nje treg perkates ne menyre te njejte dhe jo diskriminative si te gjithe operatoret e tjere celulare qe veprojne ne treg. Ndaj AKEP duhet te marre menjehere nje vendim formal per ti dhene status OFNT operatorit Plusdhe te procedoje menjehere duke detyruar kete operator te zbatoje tarifat sipas modelit te kostove te miratuar BULRAIC (sic edhe ka ndodhur me 3 operatoret e tjere celulare)

Pergjigje e Eagle Mobile:

Eagle Mobile gjykon se të katër operatorët celularë aktivë në treg përfshirë Plus përmbushin kriteret për FNT në terminim, por nëse shohim pjesët e tregut për vitin 2011, vëmë re se të gjithë treguesit dëshmojnë se tregu nuk është në një konkurrencë efektive dhe se masat rregullatore në zbatim të ligjit Nr.9918, nuk janë proporcionalisht të vendosura nga AKEP . Konkretisht, vihet re rënie të të ardhurave të Eagle Mobile nga viti 2010 ne vitin 2011 dhe rritje akoma më shumë të të ardhurave të operatorit Vodafone, duke dominuar tregun me 52% të të ardhurave totale në treg.

Gjithashtu vihet re dominancë e Vodafone dhe AMC edhe në të gjithë treguesit e tjerë të pjesëve të tregut. Edhe sipas ERG²³, përcaktimi i asimetrisë së MTR lidhet direkt me pjesët e tregut të secilit operator dhe kohën e hyrjes së tyre në treg. Pavarësisht se Eagle Mobile ka pasur më pak se 10 % pjesë tregu në vitin 2008 dhe 2009, asimetria me operatorët e konsoliduar në treg ka qenë vetëm 11,4% duke i shkaktuar Eagle Mobile humbje të mëdha nga të ardhurat e interkoneksionit dhe të ardhurave në total. Për më tepër, ndërkohë që pjesët e tregut të Eagle Mobile janë drejt reduktimit, prej 01.09.2012 pozita e EM vështirësohet edhe më, për shkak të aplikimit të një asimetrie vetëm prej 0.6% me operatorët e mëdhenj, duke rrezikuar dominimin e tregut vetëm nga operatorët e mëdhenj, daljen e operatorëve të vegjël dhe si rrjedhojë dëmtimin e abonentëve në një treg pa konkurrencë efektive.

Gjithashtu, koha e hyrjes në treg e Eagle Mobile dhe PLUS është vetëm me 2 vjet diferencë nga njëri tjetri, fakt ky që përballë operatorëve të tjerë i vendos në pozita shumë të përafërta.

Sipas dokumentit të ERG²⁴, mesatarisht operatorët që kanë hyrë 3-5 vjet më vonë në treg kanë një MTR 17% më të lartë se MTR-ja më e ulët në vend, dhe operatorët që kanë hyrë në treg 6-11 vjet më vonë, kanë një MTR 35% më të lartë se MTR-ja më e ulët në vend. Pra, dy operatorët e rinj të cilët kanë hyrë në treg 6-11 vjet më vonë se operatorët e mëdhenj (përkatësisht EM 7 -8 vjet më vonë dhe PLUS 9 - 10 vjet më vonë) duhet të kenë të njëjtat masa rregullatore dhe asimetri prej 35% me MTR më të ulët në vend.

AKEP në përcaktimin e MTR të operatorëve të ndryshëm ka trajtuar në mënyrë të njëjtë Eagle Mobile me operatorët e mëdhenj pavarësisht kohës së hyrjes në treg, pjesëve të tregut në të gjithë treguesit, ndërkohë janë marrë masa rregullatore të ndryshme për hyrësin e ri pavarësisht se masat rregullatore në zbatim të ligjit dhe kuadrit rregullator europian duhet të jenë proporcionale.

Asimetria në nivelin e duhur del si domosdoshmëri edhe nëse i referohemi mosbalancimit të trafikut të interkoneksionit mes Eagle Mobile dhe AMC/VFAL respektivisht, ku sipas të dhënave të interkoneksionit shohim se trafiku është i pabalancuar duke pasur mesatarisht një asimetri trafiku prej 53% me Vodafone dhe 20% me AMC.

Gjithashtu në treg shohim një fenomen antikonkurrues që lidhet me diferencimin e theksuar të tarifave të thirrjeve brënda rrjetit dhe atyre jashtë rrjetit nga operatorët celularë të konsoliduar në treg, pavarësisht se kostoja për thirrjet brenda rrjetit është e përafërt me koston për thirrjet jashtë rrjetit. Dukuria është e evidentuar edhe në Analizën e vitit 2010 dhe Analizën e vitit 2012 të AKEP, dhe megjithë masat rregullatore, efektet e diferencimit të tarifave janë akoma më të ndjeshme aktualisht.

Ky fenomen kushtëzon sjelljen e konsumatorit shqiptar, shkakton impakt negativ për konkurrencën e lirë në treg dhe kufizimin e saj për shkaqe që rrjedhin nga diskriminimi në aplikimin e thirrjeve brënda rrjetit dhe të atyre jashtë rrjetit duke shkaktuar të ashtëquajturat

²³ERG (07) 83 final 080312

²⁴ERG (07) 83 final 080312

“efekte të rrjetit” (network effect) që cojnë në dekurajimin e konsumatorëve për të zgjedhur rrjetet e vogla (për numër pajtimtarësh) apo për të përfituar nga ofertat e reja dhe tarifat konkurruese të një operatori të ri në treg.

Pra, diferencimi i tarifave brenda rrjetit me ato jashtë rrjetit, përdorur nga operatorët e mëdhenj, i vendos hyrësit e rinj në kushte të pafavorshme të një tregu ku mungon konkurrenca e lirë dhe efektive.

Është e rëndësishme të theksohet fakti se, diferencimi i tarifave on-net/off-net nga operatorët e mëdhenj do të vazhdojë edhe nëse tarifat e terminimit do të jenë simetrike. Kjo vjen nga fakti se aplikimi i tarifave diferenciale prej këtyre operatorëve vjen si rezultat i strategjive të tyre për të rritur pjesët e tregut dhe jo si rezultat i aplikimit të MTR asimetrike.

Sipas ERG nëse janë marrë gjithë masat e tjera rregullatore dhe problemet në treg vazhdojnë në dëm të vazhdueshëm të konkurrencës, është i justifikueshëm dhe i domosdoshëm aplikimi i asimetrisë në nivelet e duhura dhe të nevojshme në përputhje me kushtet konkrete të tregut.

Si konkluzion, Eagle Mobile kërkon aplikimin e masave proporcionale rregullatore për operatorët e konsoliduar në treg dhe hyrësit e rinj, me qëllim rregullimin e konkurrencës në treg në funksion të dhënies së një shërbimi cilësor për konsumatorët, në një treg konkurrent.

Pergjigje e Plus Communicatios:

Nga vetë analiza e dhënë nga AKEP për përcaktimin e një operatori FNT në bazë të tregut përkatës, AKEP mendon se për secilin operator **mund** të konkludohet se secili prej tyre ka fuqi të ndjeshme në treg (FNT). Përsa i përket shpjegimit të dhënë më sipër për testin e zëvendësueshmërisë të tregut përkatës, PLUS nuk mund të përcaktohet FNT.

Kjo, duke konsideruar gjithashtu dhe faktorë të tjerë që kanë aftësi ndikuese në këtë përcaktim.

- Konkurrenca e mundshme në tregun e terminimit të thirrjeve

Është e vërtetë që asnjë operator nuk mund të hyjë në rrjetin e një operatori tjetër, apo të kontrollojë kartat SIM të përdoruesve të këtij operatori për thirrjet dalëse dhe hyrëse, por në fakt konkurrenca vjen si rezultat i ndërveprimit midis palës dalëse (kërkesa) dhe asaj hyrëse (oferta). Në tregun aktual kontrolli i tregut kryhet nga pala dalëse e trafikut, ku kërkesa është më e lartë, dhe barrierat që mund të vendosin operatorët nga del thirrja, prandaj rezulton se konkurrencë në tregun e terminimit ka.

- Fuqia kundërvepruese e blerësve të shërbimit

Duke konsideruar faktin se “Fuqia e lartë negociuese është rezultat, kryesisht, i sasisë së madhe të shërbimit të kërkuar nga pala blerëse dhe interesit të shitësit për të mos humbur këtë klient”, Plus nuk ka fuqi negociuese për shkak të sasisë së madhe të shërbimit të origjinuar nga pala shitëse (Plus).

Kërkesa është e lartë jo nga pala blerëse (operatorët me FNT), por pala e origjinës (klientët e PLUS që kanë nevojë për kryerjen e thirrjeve drejt operatorëve të tjerë).

- Tarifimi i shërbimit

Plus ka aplikuar deri më tani tarifa të vendoura sipas vendimeve të AKEP, pas zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që Plus ka patur me operatorët e tjerë me FNT. PLUS ka arritur të imponoje

këto tarifa, jo në sajë të fuqisë së vet imponuese apo monopolistike, por prej ndërhyrjes dhe vendimeve të autoritetit rregullator AKEP.

Plus zotëron teknikiisht tregun hyrës të thirrjeve në rrjetin e vet, por janë faktorë të tjerë që e zbalancojnë këtë pozitë teknikiisht monopolistike, sic janë fuqia kundërvepruese e operatorëve të tjerë, tregu, dhe pamundësia për imponim i tarifave në mënyrë të pavarur.

Një tregues i tregut është pesha e tregut që zë secili operator. Në terma të të ardhurave, PLUS zë vetëm 2% të tregut, dhe 7.58% në numër pajtimtarësh.

Sipas përcaktimit të dhënë nga Ligji nr. 9918, neni 33, Operator me Fuqi të Ndjeshme quhet *“Një sipërmarrës vlerësohet me fuqi të ndjeshme në treg nëse, i vetëm, apo së bashku me të tjerë, zotëron një pozitë të tillë ekonomike, që i mundëson një zgjerim të ndjeshëm, pavarësisht nga konkurrentët, klientët apo përdoruesit fundorë”*.

Një ndër kriteret për vlerësimin e sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg, ku AKEP bazohet, ndërmjet të tjerave, është dhe madhësia e sipërmarrësit në të ardhura dhe fuqia që ka në treg. Duke konsideruar se PLUS zë vetëm 2% të tregut të ardhurave, kjo nuk mund të konsiderohet si një pushtet i një sipërmarrësi me fuqi të ndjeshme në treg.

PLUS synon dhe pritet të rritet në numër klientësh dhe të ardhurash, por për momentin nuk e ka këtë pushtet.

Pesha e ulët e të ardhurave të depozituara nga PLUS, sikundër del edhe nga pasqyrat e dhëna nga AKEP, është një reflektim ndër të tjera edhe i balancës së kostove dhe të ardhurave të PLUS për shërbimet e thirrjeve me shumicë.

Kërcënimi i hyrjes në tregjet e terminimit mund të përcaktohet nga kushtet e tregut, dhe ky kërcënim egziston nëpërmjet alternativave zëvendësuese që ofron tregu për klientin për të njëjtin shërbim (thirje, apo sms). Që nga dita e parë që PLUS operon në treg, ka lejuar terminimin në rrjetin e vet, prandaj dhënia e statusit FNT për shkak të terminimit në rrjetin e vet, nuk është një kriter diferencues pse ky status të jepet tani, dhe jo në fillim të lëshimit të shërbimit.

Fuqia ndërvepruese midis fiks dhe mobile është e ulët, por kjo fuqi ndërvepruese është e lartë kur bëhet fjalë për marrëdhënien mobile – mobile.

Sipas zhvillimeve të fundit, ka rezultuar se operatorë me FNT kane qenë në gjende të imponojnë tarifa të larta në treg, madje duke bllokuar dhe shërbimin, por kjo nuk funksionon për operatorët e vegjël të cilët nuk kanë alternativa të shumta zgjedhjeje për të njëjtin shërbim. Prandaj imponim i tarifave pa ndihmën rregullatore nuk do të funksiononte për një hyrës i ri, ose operator të vogël.

Në bazë të kritereve të argumentuara me sipër, PLUS nuk mund të përmbushë kriteret për të qenë operator me FNT.

Një status FNT për një operator të ri, dhe masat rregullatore që paraqet, mund të përbëjnë një barrë të rëndë për këtë operator, sic mund të jenë, detyrimet për akses, apo kontrolli i tarifave dhe sistemi i mbajtjes së llogarive.

Pergjigje e NEOFONE:

Po, te kater operoret celulare aktiv ne treg, perfshire Plus Communication, permbushin kriteret per FNT ne terminim.

Qendrimi AKEP:

Vlereson komentet e ardhura ne pergjigje te pyetjes se dyte per dakortesine ne lidhje me perfundimet e AKEP ne dokumentin e konsultuar. Pavaresisht dakortesise me perfundimin e AKEP, veme re se Eagle Mobile ne pergjigjen e tij ndalon kryesisht ne nivelin e asimetrise duke sjelle ne vemendje se “tregu i terminimit nuk eshte ne konkurrence efektive”, konkluzion ky aspak i ri per AKEP, per pasoje eshte identifikuar se ne kete treg ka FNT duke identifikuar aktoret si dhe problemet kryesore. Parashtrimet e Eagle Mobile ne kete pjese gjejne me shume vend ne komentet qe i perkasin ne “pyetjen 3”, duke qene se AKEP ka kerkuar opinion ne lidhje me masat rregullatore ne rrjetet celulare pikerisht ne kete pyetje.

Ne lidhje me komentet e Plus Communication, sipas te cilave nuk mund te percaktohet si operator me FNT, edhe pse gjate pershkrimit te argumenteve vihet re qe argumentet e perdorura nga AKEP jane te pakundershtueshme (pohohen si te tilla edhe nga vete komentuesi) mbi vleresimin e situates monopol ne sherbimin e terminimit ne rrjetin e Plus.

AKEP ne trajtimin e sherbimit te terminimit dhe analizes se kryer per kete sherbim eshte treguar parimor, duke bere vleresimin juridik, ekonomik dhe teknik per kete sherbim.

3. Cfare mendoni per masat rregullatore per terminimin ne rrjetet celulare dhe asimetrine (nivelin e tarifave dhe kohezgjatjen) e propozuar nga AKEP per tarifate terminimit te Plus Communication ndaj operatoreve te tjere?

Pergjigje e AMC:

a- Masat rregullatore per terminimin ne rrjetet celulare

AMC mendon qe AKEP ka qene shume i pergjithshem ne vendosjen e masave rregullatore, duke cituar nenet perkatese te ligjit Nr.9918, pa hyre ne detaje ne lidhje me implementimin e ketyre masave dhe pa shpjeguar qarte menyren sesi vendosja e ketyre masave realizon objektivat rregullatore te AKEP, dhe mbi te gjitha garantimin e nje konkurrence efektive.

Ne jemi dakort me qendrimin e AKEP, qe te njejtat masa rregullatore qe jane aplikuar deri me sot ndaj tre operatoreve celulare, te shtrihen dhe per operatorin e 4-t Plus Communications, masa keto qe duhej te ishin aplikuar qe me pare ne kohen e hyrjes se ketij operatori ne treg, pasi plotesonte kushtet per FNT, sic dhe u shprehem me siper.

Dinamika e zhvillimeve te ketij dy-vjecari qe ka sjelle implementimin e metodologjise BULRAIC per percaktimin e tarifave te terminimit sipas koston eficente, ka bere qe keto tarifa te jene tashme te njohura per te gjitha.

Me ane te metodologjise se rregullimit BULRAIC, tarifate terminimit jane te percaktuara per nje periudhe kohore disa vjecare deri ne 2015, dhe AKEP duhej ta konsideronte kete fakt ne

vendosjen e masave rregullatore per tregjet e terminimit te thirrjeve ne rrjetet mobile per operatoret perkates, pasi nje konsiderim jo i plote i te gjithe faktoreve gjate analizes se tregut con ne masa rregullatore me renduese qe rezultojne ne barra renduese per operatoret.

Duke pasur parasysh ate qe thame me lart, AMC mendon qe detyrimi per ndarjen e llogarive sipas nenit 45 te ligjit 9918 per Komunikimet Elektronike, duhet te jete proporcional duke marre ne konsiderate implementimin e metodologjise se rregullimit te tarifave te terminimit dhe percaktimit te tyre, pasi nuk eshte e nevojshme psh. publikimi i atyre elementeve te kostos te nevojshme per percaktimin e tarifave te terminimit, meqenese ato jane tashme te percaktuara, nese i referohemi dhe paragrafit 1/a te nenit 13 te Direktives 2002/21/EC (Framework Directive):

“(a) keep separate accounts for the activities associated with the provision of electronic communications networks or services, to the extent that would be required if these activities were carried out by legally independent companies, so as to identify all elements of cost and revenue, with the basis of their calculation and the detailed attribution methods used, related to their activities associated with the provision of electronic communications networks or services including an itemised breakdown of fixed asset and structural costs”

Lenia ne fuqi e detyrimit per ndarjen e llogarive sipas nenit 45 te Ligjit Nr.9918, ne menyre qe te mos jete nje barre me e rende gjate aplikimit te saj, nuk duhet te perfshije publikimin e atyre elementeve qe perfshihen ne percaktimin e tarifave te terminimit pasi tashme kostot per kalkulimin e tarifave te terminimit jane tashme te llogaritura me metodologjine BULRAIC, duke vendosur ne menyre proporcionale kete mase rregullatore. AKEP duhej te ishte me i qarte ne specifikimin dhe detajimin e masave rregullatore.

Ne lidhje me detyrimin per akses dhe interkoneksion dhe perdorimin e perbashket te faciliteteve te rrjetit (Neni 42 i Ligjit Nr.9918), mendojme, qe lenia ne fuqi e te gjitha pikave te ligjit eshte e gabuar nga AKEP, pasi jo te gjitha pikat ne kete nen lidhen me interkonektimin ndermjet rrjeteve per terminimin e thirrjeve. Pikat (d), (dh), (e) dhe (ë) nuk jane detyrime te imponueshme dhe nuk duhej te ishin lene ne fuqi si te imponueshme dhe AKEP duhej ta kishte permendur kete fakt dhe te ishte i qarte kur percakton lenien ne fuqi te detyrimeve te meparshme rregullatore.

Nese i referohemi dhe paragrafit me poshte te faqjes 46 te draft-analizes se tregut:

“Per pikat d, dh, e, ë, AKEP gjykon se eshte e nevojshme te sqarohet se detyrimi per akses i referohet vetem per mundesimin e terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare, dhe duhet te jene te zbatueshme sipas mundesive/aftesive teknike dhe ekonomike te operatorit celular me FNT per terminim si edhe me tarifa te cilat mbajne parasysh investimet e kryera dhe nje norme te arsyeshme fitimi.”

Keto pika nuk perbejne pra detyrime te imponueshme direkt per operatoret, pasi lihen ne diskrecionin e tyre sipas aftesive teknike dhe atyre ekonomike, dhe nje gje e tille e ben te pajustificueshme konkluzionin e AKEP per te lene ne fuqi si te detyrueshme masat qe permbahen ne keto pika.

b- Niveli i tarifave te Plus Communications dhe kohezqatja e tyre;

Ne radhe te pare duam te pershendesim vendimin e AKEP per shpalljen e statusit me FNT te operatorit Plus Communications ne tregun e terminimit te thirrjeve.

Niveli i tarifave qe AKEP ka percaktuar per kete operator ne kete draft-analize ndryshon nga niveli i tarifave rekomanduese me ane te VKD. Nr.1505, date 10.02.2011. (AMC ka dhene tabelat e tarifave te percaktuara ne dokumentet e cituara)

Sic shihet dhe ne dy tabelat e mesiperme, nuk e kuptojme se perse AKEP ka ndermarre nje konkluzion te tille ne ndryshimin e tarifave ne lidhje me nivelin e tarifave rekomanduese te meparshme (te percaktuara me ane te VKD 1505, dt.10.02.2011), pasi tarifat e vendosura jane me te larta se ato te rekomanduara ne shkurt 2011, duke rritur akoma me tej dhe nivelin e asimetrise se tarifave te terminimit midis Plus-it dhe operatoreve te tjere, gje e cila con ne perfitime ekonomike te ketij operatori ne kurriz te operatoreve te tjere, duke rritur me shume kostot dhe duke demtuar na demtuar ekonomikisht. Po ti referohemi tarifave te reja te terminimit nga 1.09.2012 midis AMC/Vodafone dhe Plus, shohim se niveli i asimetrise rritet nga 45% (duke iu referuar niveli te tarifave rekomanduese te Plus) ne rreth 112% (me tarifen e re prej 12.92 lek/min), e cila eshte shume me e larte dhe nga mesatarja prej rreth 35% midis tarifes se terminimit te operatorit qe ka hyre ne treg 6-11vjet me von dhe tarifes se terminimit me te ulet te operatoreve me te hershem ne treg, sic citohet dhe ne faqjen 86 te dokumentit ***ERG (07) 83 final 080312 ERG's Common position on symmetry of fixed call termination rates and symmetry of mobile call termination rates:***

“In average, MTRs of operators having between 3 and 5 years of entry delay are 17% higher than the lowest MTR in their country, and MTRs of operators having between 6 and 11 years of entry delay are 35% higher than the lowest MTR in their country.”

AMC duke ilustruara me tabela nivelin e asimetrise citon se niveli i asimetrise midis tarifave te terminimit te Plus Communications dhe dy operatoreve kryesore AMC/Vodafone rritet se tepermi nga rreth 45% me nivelin e tarifave te rekomanduara me Shkurt 2011 ne 112% me nivelin e ri te tarifave qe ka percaktuar AKEP ne kete draft-analize. Nje nivel i tille asimetrie prej 112% eshte shume me i larte se mesatarja e nivelit te asimetrise prej rreth 35% ne vendet e BE-se, sic e permendem ne paragrafin me siper

Ne gjykojme qe tarifat e reja jane percaktuar ne menyre arbitrare, te pajustificuara dhe te paargumentuara, te cilat favorizojne qarte operatorin Plus ne kurriz te operatoreve te tjere, gje e cila nuk ndihmon ne arritjen e nje konkurrence efektive qe eshte dhe objektivi kryesor i nje enti rregullator, por perkundrazi e demton me tej konkurrencen. Tarifat me te larta te terminimit ndikojne negativisht dhe ne nivelin retail ne percaktimin e tarifave me pakice, dhe si rrjedhim sjellin nje kosto me te madhe dhe per perdoruesin fundor, pasi tarifat e terminimit jane pjese e koston ne percaktimin e tarifave me pakice. Duke sjelle nje kosto me te larte per operatorin e tjere, detyrimisht kjo barre do te shkarkohet direkt mbi konsumatorin, ul stimujt per futjen e ofertave ne tregun me pakice nga ana e operatoreve.

Gjithashtu, AKEP nuk shpjegon arsyet se perse ka ndryshuar nivelin e tarifave te terminimit per Plus krahasuar me glide path-in e rekomanduar ne Vendimin 1505 Shkurt 2011, dhe nuk ka argumentuar se ku eshte bazuar ne nxjerrjen e ketyre rezultateve. Nje konkluzion i tille eshte i

pajustificuar dhe arbitrar, teper I paqarte, shtremberon konkurrencen ne treg, dhe nuk gjen asnje reference ne praktikate rregullatore te vendeve te tjera te BE-se. po t'i referohemi dhe nje dokumenti te ERG: **BoR (12) 56 TR benchmark snapshot (January 2012)**, pervec Irlandes dhe Norvegjise, qe rezultojne me nivele me te larta te asimetrise me 243% dhe 133%, edhe ne ato pak vende qe kane nivele te larta asimetrie, nuk kalojne me teper se 90% gjate janar 2012.

Ne perfundim te komenteve tona mbi kete argument, ne nuk jemi aspak dakort me nivelin e ri te tarifave te terminimit, dhe per rrjedhoje me nivelin teper te larte te asimetrise qe krijohet nga aplikimi I ketyre tarifave, pasi demton qarte te gjithë operatorët e tjere, duke favorizuar Plus-in dhe duke shtremberuar e penguar konkurrencen midis operatoreve.

Sugjerojme qe AKEP te lere ne fuqi nivelin e tarifave qe ka rekomanduar me ane te VKD nr.1505, date 10.02.2012, sipas skedulimit kohor te percaktuar ne ate vendim, pasi dhe niveli i asimetrise midis tarifave te terminimit ne kete nivel tarifash eshte me i arsyeshem dhe sjell me pak kosto per ne si operatore ne tregun e terminimit te thirrjeve, duke qene dhe me afer mesatares prej 35% te vendeve te BE-se.

Pergjigje e Vodafone :

Glide path i propozuar per operatorin Plus eshte ne kundërshti te modelit te analizes se koston miratuar nga AKEP

6. Vodafone Albania shprehet kunder propozimit te AKEP ne Analize persa i takon glidepath te propozuar per Plus. Glide-path i ri eshte ne shkelje te dokumentit final te orientimit ne kosto te tarifave celulare (sipas modelit BULRAIC) miratuar nga AKEP nepermjet VKD 1505 date 10.02.2011. Glide path-i i propozuar nga AKEP i mundeson Plus Communication nje afat dhe marzh asimetrie pertej percaktimeve te analizes se koston BULRAIC dhe pertej percaktimeve orientuese te akteve rregullatore te Bashkimit Europian.
7. Modeli BULRAIC eshte nje dokument qe eshte diskutuar ne menyre te detajuar me palet, sipas nje procedure te hapur konsultimi publik dhe rezultati i tij ka ardhur si pasoje e analizash te shumta dhe komplekse ekonomike nepermjet ekspertizes se huaj dhe vendase. Ndaj dhe cdo sugjerim i AKEP per te vepruar ne kundërshti me te, duhet te shoqerohet dhe te mbeshtetet nga nje analize shume e mire dhe te detajuar ekonomike qe do te justifikonte cdo marzh ndryshimi sado te vogel nga dokumenti origjinal.
8. Sipas modifikimit te propozuar tanime nga AKEP Plus Communication do te kete ne dispozicion nje afat 5 vjecar per te ushtruar asimetri tarifash terminimi ndaj operatoreve te tjere celulare ne tregun e komunikimeve elektronike - nga viti 2010 deri ne vitin 2015 (analiza e kostose ka parashikuar deri ne vitin 2014). Kjo vjen ne shkelje me Rekomandimin e Komisioni Europian te vitit 2009 (Comission Recommendation of 07.05.2009 on the regulatory treatment of fixed and mobile termination rates in the EU) ku ne paragrafin 10 shprehet qarte se: "ne rast se do mund te vertetohet se nje operator i ri celular ne treg qe vepron nen minimumin e shkalles se eficiences, peson kosto inkriminale per njesi, me te larta se operatori i modeluar, pasi te kete percaktuar se ka pengesa ne tregun e pakices per te hyre e per tu zgjeruar, Autoriteti rregullator mund te lejoje qe keto kosto te rikuperohen per nje periudhe tranzitore nepermjet tarifave te rregulluara te terminimit. Kjo periudhe nuk duhet te kaloje 4 vjet pas hyrjes ne treg te operatorit."
9. Vete AKEP pranon qe tarifa e Plus gezon nje asimetri rreth 150% me lart e mesatarja e BE (Analiza, faqet 34 dhe 35). Asimetria e Plus shkon pertej parashikimeve te Ligjit 9918, Rekomandimeve te BE, benchmark-eve te rajonit dhe BE dhe plotesisht jo neperputhje me perfundimet e analizes se

kostos BULRAIC. Eshte plotesisht e papranueshme qe AKEP te vazhdoje te propozoje devijime pertej analizes se koston, duke favorizuar keshtu ne menyre arbitrare nje operator celular kundrejt tre te tjereve. Ne keto kushte, AKEP ndodhet ne shkelje te nje prej parimeve thelbesore qe udheheqin kete institucion, sic eshte 'mosdiskriminimi' i percaktuar ne nenin 7 te Ligjit 9918:[...] per te siguruar mosdiskriminimin dhe barazinë në trajtimin e ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike [...]. AKEP duhet te mbaje ne vemendje se cdo diskriminim qe favorizon Plus kundrejt operatoreve te tjere celulare, ne menyre indirekte eshte nje mase diskriminuese kunder investimeve te huaja ne Shqiperi, pasi te gjithë operatorët e tjere jane investues te huaj, perfshire ketu Vodafone Albania. Diskriminimi negative ndaj ketyre operatoreve, pervecse bie ne kundershti me parimet e levizjes se lire, Marreveshjes se Stabilizim Asociimit dhe Ligjin per Investimet e Huaja, eshte nje sinjal negativ per investuesit e tjere te huaj dhe investimet e tyre te metejshme ne Shqiperi.

Aplikimi i asimetrise eshte rast perjashtimor dhe si i tille duhet kufizuar maksimalisht nga AKEP

10. Qendrimi i Vodafone Albania kaheerazi ka qene per aplikim simetrie te plote ne lidhje me MTR (tarifave te terminimit ne rrjetin celular) per te gjithë operatorët. Simetria afat-gjate mundeson konkurrence me te madhe ne treg, duke nxitur investime dhe novacion, siguri rregullatore dhe mireqenie te pergjithshme per perdoruesit. Aplikimi i simetrise se plote garanton pritshmerite e lojtareve te tjere te tregut mbi tendencen ne treg per tarifat e terminimit.
11. Asimetria ka rene ne menyre te vazhdueshme ne tregjet e BE (qe prej vitit 2004 deri me sot) dhe pritet te vazhdoje keshtu deri sa te arrihet simetri totale. Ky eshte nje qellim rregullator i deklaruar nga Komisioni Europian dhe ERG, si dhe Autoritetet Rregullatore Kombetare te secilit vend anetar. Komisioni Europian ne Rekomandimin e tij te vitit 2009 (Comission Recommendation of 07.05.2009 on the regulatory treatment of fixed and mobile termination rates in the EU) paragrafi 1 shprehet qarte se brenda vitit 2012: “autoritetet rregullatore duhet te vendosin tarifa terminimi bazuar ne koston qe peson nje operator eficient. Kjo do te thote se ato duhet te jene simetrike.” Gjithashtu ERG ne dokumentin (ERG 07-83 ERG Common Position on symmetry of fixed termination rates and symmetry of mobile termination rates, faqe 82) shprehet se “simetria duhet promovuar - ne parim tarifat e terminimit duhet te jene simetrike, kurse asimetria duhet te aplikohet vetem ne raste te vecanta dhe me nje baze justifikuese”. Madje edhe AKEP ka pranuar ne analizen e tregut te vitit 2010 se asimetria mund te shkaktojë probleme per konkurrencen, duke e shtremberuar ate, sepse mundeson aplikimin e tarifave me te larta per rrjetin e operatorit me te vogel (fq.76). Njekohesisht lejimi i tarifave asimetrike te terminimit per nje kohe te gjate mund te shkaktojë mungese efikasiteti dhe te demtojë konkurrencen dhe mireqenien e konsumatorit, si p.sh. duke shkaktuar nxitje te kufizuar te minimizimit te koston.
12. Vodafone Albania eshte dakord me pohimin e Rekomandimit te ERG se asimetria e tarifave celulare te terminimit ende ekziston ne Evrope. Sidoqofte, nje mase tille nuk perben metoden e perzgjedhur te Autoriteteve Rregullatore Kombetare ne Evrope. Ligji 9918 neni 57/2/a,b,c (metoda e rregullimit te tarifave) percakton se AKEP gjate rregullimit te tarifave, perfshire ketu rastin e aplikimit te asimetrise, duhet te vleresoje praktiken me te mire te vendeve te BE; tarifat mesatare te BE dhe tarifat e vendeve te rajonit me zhvillim te ngjashem. Kjo nuk eshte zbatuar aspak nga AKEP pasi niveli i asimetrise i operatorit Plus prej 150% eshte absolutisht i pakrahasueshme me asnje vend tjetër te BE apo rajonit.

13. Po ti referohemi dokumentit te BEREC (MTR Benchmark Snapshot January 2011), vende si Irlanda, Norvegjia dhe Islanda aplikojne asimetrie ekstremeqe luhetet ne vlerat 73-94% (fq.7). Edhe dokumenta te tjere si analizat periodike te Cullen International (*Cross country analysis for Western Europe and Central and Eastern Europe*, Analizat krahasimore per Evropen Perendimore dhe Evropen Qendrore dhe Lindore, perkatesisht faqe 96-102 dhe faqe 73-77) tregojne se asimetrit e aplikuar jane ne nivele mesatare deri 50%. Ndaj dhe asimetria e mbajtur nga AKEP eshte pertej cdo niveli te ligjshem e te arsyeshem financiar.
14. Vodafone kerkon te sjelle ne vemendje te AKEP qendrimin e pergjithshem te ERG mbi simetrine e tarifave te terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular (*ERG Common Position mbi simetrine e tarifave te terminimit*²⁵), dokument rregulator i publikuar nga Grupi Rregulator European ne seksionin 3.4, ku citohen praktikat e rasteve perjashtimore te simetrise per nje periudhe tranzitore, per lojtaret e hyre vecanerisht vone ne treg.
- [...] Mesatarisht, MTR te operatoreve qe kane hyre ne treg nga nje periudhe 3 deri ne 5 vjet me vonese, jane rreth 17% me te larta sesa MTR me i ulet ne ate vend, ndersa MTR e operatoreve qe kane hyre me nje vonese prej 6-11 vjet ne treg, jane 35% me te larta sesa MTR me i ulet ne ate vend [...] (3.4.1 paragrafi 4, cituar fq 86).
 - [...] Sipas rezultateve krahasimore te ERG qe prej vitit 2007, operatoret me nje pjese tregu nen 10%, kane mesatarisht nje tarife terminimi prej 47% me te larte se tarifa me e ulet ne vendin e tyre[...] (3.4.1 paragrafi 6, cituar fq 87).
 - [...] Ndermjet 98 operatoreve te analizuar nga ERG ne metoden krahasimore, qe prej vitit 2007, vetem 7 prej tyre kane nje asimetri mbi 50%.[...] (3.4.2- Asimetria per nje lojtar te hyre specifikisht vone ne treg, cituar fq 93).

Masat rregulluese duhet te aplikohen ne menyre te njejte dhe jo-diskriminative mbi te gjitha operatoret pa perjashtim, perfshire Plus Communication

15. Vodafone Albania shprehet kunder propozimit te AKEP persa i takon masave rregulluese te propozuara ndaj Plus si OFNT. Vodafone Albania kerkon me force qe te gjitha masat rregullatore duhet te qendrojne mbi Plus ashtu sic edhe mbi operatoret e tjere celulare; ne te kundert detyrimet ne fjale duhet tu hiqen te gjithëve ne menyre jo-diskriminuese. Ky standart i dyfishte duhet te shmanget nga AKEP, pasi perben nje sjellje arbitrare dhe favorizon padrejtesisht operatorin Plus. Vodafone Albania thekson se do te kundërshtojë cdo trajtim diskriminativ te cilitdo operatori nepermjet hapësirave qe i njej Ligji 9918.Cdo trajtim i pabarabarte dhe diskriminativ cenon konkurrencen e ndershme ne treg dhe i hap rruge sjelljeve arbitrare ne dem te tregu dhe konsumatoreve.

KONKLUZIONE:

Per gjitha sa me lart, Vodafone Albania permbledhurazi i kerkon AKEP:

- Te aplikohet simetri e plote ne lidhje me tarifat e terminimit ne rrjetin celular per te gjitha operatoret pa perjashtim. Ky eshte dhe qendrimi i Komisioni European ne Rekomandimin e tij te

²⁵ ERG Common Position, Simetria e tarifave te terminimit ne rrjetin fiks dhe te levizshem, ERG (07)83 Final 080312

vitit 2009 ku thuhet qarte se brenda vitit 2012: “autoritetet rregullatore duhet te vendosin tarifa terminimi bazuar ne kostot qe peson nje operator eficient. Kjo do te thote se ato duhet te jene simetrike.”

- Ne mungese te zbatimit te simetrise se plote AKEP duhet te ndjeke rekomandimet e ERG dhe dokumentave rregullatore apo praktikat e vendeveanetare persa i takon nivelit te asimetrise. Asimetria e hasur ne BE dhe qe duhet te zbatohet, referuar nenit 57 te Ligjit 9918 per percaktimin e tarifave, duhet te jete maksimalisht ne nivelin 47%.
- Te aplikojte glide-path qe eshte miratuar nepermjet modelit BULRAIC per te gjithë operatorët celulare, pa perjashtim. Ai eshte rezultat i nje konsultimi publik dhe analizash ekonomike nga eksperte te huaj dhe vendas. Cdo sugjerim i AKEP per te vepruar ne kundërshti me te duhet te mbeshtetet nga nje analize shume e mire dhe e detajuar ekonomike qe te justifikojte cdo marzh ndryshimi sado te vogel nga dokumenti origjinal. Ne mungese te ketij justifikimi, cdo shëmbëngje nga dokumenti i miratuar i analizes se koston dhe tarifave te terminimit per operatorët, eshte ne shkelje te Ligjit 9918 dhe diskriminon ne menyre te pandershme nje operator ne treg ndaj te tjeveve. Cdo diskriminim qe favorizon Plus kundërshtojte operatorëve te tjeve celulare, ne menyre indirekte eshte nje mase diskriminuese dhe kunder investimeve te huaja ne Shqiperi prandaj bie ne kundërshti me parimet e levizjes se lire, Marreveshjes se Stabilizim Asociimit dhe Ligjin per Investimet e Huaja.

Pergjigje e Eagle Mobile:

Eagle Mobile gjykon se në situatën konkrete të tregut të telefonisë celulare në Shqipëri duhet të trajtohen dhe të rishikohen edhe tarifat e terminimit të operatorëve të tjerë celularë. Pavarësisht vendosjes së masave rregulluese nga AKEP në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve (Analiza e tregut celular 2010), tregut të komunikimeve elektronike në Shqipëri, i mungon konkurrenca e lirë dhe efektive dhe në këto kushte është i pamundur zhvillimi i operatorëve të vegjël.

Siç u theksua edhe më lart, në kushtet aktuale, ku vihen re fenomene të tilla disavantazhuese për operatorët e vegjël si kyçja e pajtimtarëve nga ana e operatorëve të mëdhenj, maturim tregu, diferencim i tarifave on-net/off-net nga ana e operatorëve të mëdhenj, të cilat çojnë në rritjen e pjesëve të tregut të operatorëve të mëdhenj dhe daljen nga tregu të hyrësve të rinj, si edhe në kushtet e ekzistencës së një tregu që tenton gjithmonë e më shumë drejt deformimit të konkurrencës për shkak të ekonomive të rrjeteve, Eagle Mobile konsideron se AKEP duhet të marrë në konsideratë rishqyrtimin për analizimin në këndvështrimin e paraqitur më sipër në lidhje me tarifat e terminimit të operatorëve celularë.

Në një situatë të tillë dhe meqënëse edhe në të ardhmen afatmesme nuk pritët të ndodhin ndryshime, Eagle Mobile i kërkon AKEP të ndërmarrë masa të reja rregullatore, për të rikuperuar situatën në treg dhe rritur efektivisht konkurrencën në tregun celular me pakicë.

Eagle Mobile mbështet reduktimin e tarifave të terminimit për operatorët celularë në mënyrë proporcionale dhe gjykojmë se është i nevojshëm reduktimi i mëtejshëm i tarifave për operatorët e mëdhenj dhe orientimi i tyre drejt koston në një periudhë më të shkurtër se propozimi i AKEP

dhe gjithashtu duhet te rivlerësohet edhe niveli i tarifës së synuar ne përfundim te glide path i cili duhet te perputhet me kostot sipas LRIC të pastër. Në të njëjtën kohë kërkojmë marrjen e masave rregullatore të njëjta dhe aplikimin e tarifave të terminimit simetrike për operatorët Eagle Mobile dhe Plus.

Pergjigje e Plus Communicatios:

Ndërhyrja e AKEP është e nevojshme për të vendosur masa rregullatore për terminimin në rrjetet celulare. Dhe koncepti i asimetrisë është i pranueshëm, kjo duke iu referuar pjesës së tregut që zë PLUS, trafikut të pa balancuar hyrës dhe dalës. Plus është dakort për një asimetri të reduktuar poshtë niveleve aktuale, por kjo duhet të jetë proporcionalisht në rënie, në mënyrë që të evitohet krijimin e ndonjë impakti negativ mbi mbajtjen e llogarive të Plus.

Me poshtë Plus parqet me ane të grafikëve gjendjen aktuale te trafikut hyrës dhe dalës për PLUS me operatorët e tjere celulae dhe Albtelecom.

Në bazë të analizës të mësipërme vërehet se ka ende asimetri në trafik, fakt i cili bën të nevojshëm ndërhyrjen rregullatore për të aplikuar ende një asimetri në tarifë, derisa tregu të tregojë nivel të një konkurrence efektive ndërmjet operatorëve të rinj (me një numër të vogël përdoruesish) dhe operatorëve të stabilizuar në treg (me numër të lartë përdoruesish). Aktualisht nuk mund të flasim për një konkurrencë efektive për sa kohë palët nuk janë në pozita të njëjta. Pozicionimi i PLUS në treg është i ndryshëm nga operatorët e tjerë me FNT. Vetë prania e një operatori të ri është një faktor konkurrence, ndërkohë që tarifat, diferencimi në statusin FNT, tarifa asimetrike, janë faktorë që ndikojnë më tepër për krijimin e kushteve të një konkurrence efektive.

Në rastin e Plus, megjithëse asimetria është në nivelin e lartë 150%, përseri ka asimetri të lartë në trafik: tregu i thirrjeve dalëse të PLUS është më i lartë se ai i thirrjeve hyrëse. Dhe pesha që zë PLUS në treg, është shumë e vogël, e cila përkthehet “**e pandjeshme**” përse i përket konkurrencës me operatorët e tjerë. Kjo mund të shihet nga ofertat që lidhen me destinacionin PLUS dhe me pasqyrat e trafikut hyrës dhe dalës të PLUS.

Duke mbështetur qendrimin e AKEP se “ERG trajton çështjen e asimetrisë, duke rekomanduar aplikimin e asimetrisë midis operatorëve të rinj në treg dhe operatorëve të mëparshëm, por me objektivin që asimetria të jetë e lejuar për një periudhë kohore të kufizuar në vite”, PLUS është dakort që kjo asimetri të jetë për një periudhë kohore derisa kushte e tregut të përcaktojnë se asimetria nuk është e nevojshme. Sigurisht që tendenca është për drejtim të asimetrisë së tarifës së terminimit në nivelin zero, duke u balancuar me operatorët e tjerë, por kjo duhet të jetë graduale, që mos të ketë efekt të menjëhershëm negativ mbi operatorët.

PLUS, duke ritheksuar vlerësimet e bëra me sipër, në vençanti madhësinë e një operatori në treg, konkurrencën ndërmjet operatorëve, asimetrinë midis trafikut hyrës dhe dalës dhe tendencën që do të ketë ajo për periudhat në vazhdim, vlerëson se tarifa e terminimit për thirrjet hyrëse në PLUS duhet të ulët në nivelet **15.00 leke per minutë**.

Vetëm në këtë mënyrë PLUS do të ketë mundësinë për të kontribuar në rritjen e konkurrencës në tregun e shërbimeve të operatorëve të lëvizshëm.

Pergjigje e NEOFONE:

Masat rregullatore per terminimin ne rrjetet celulare dhe asimetrine (nivele e tarifave dhe kohezgjatjen) e propozuar nga AKEP per tarifat e terminimit te Plus Communication ndaj operatoreve te tjere jane jo ne favor te abonenteve pasi bejne te larta kostot per telefonat off-net. AKEP duhet te nderhyje per uljen e tarifave me shpejt ne te gjitha rrjetet mobile si dhe ate te Plus.

Qendrimi AKEP:

Komentet e ardhura nga AMC dhe Vodafone Albania ne lidhje me masat rregullatore kryesisht jane te fokusuara tek niveli i asimetrise te larte te Plus, duke sjelle krahasime ndermjet glide-path-it te propozuar ne analize dhe glide path-it te dhene sipas VKD nr.1505, date 10.02.2012. Reduktimi i tarifave te terminimit eshte mbeshtetur nga tere operatoret, por kryesisht ne komentet e Eagle Mobile vihet nje mbeshtetje per reduktimin e tarifave te terminimit ndoshta duke reduktuar si kohen e reduktimit te tyre por edhe te vleres se tarifes se terminimit dhe per kete sjell ne vemendje edhe mundesine e rivleresimit te nivelit te tarifës ne perputhje me kostot sipas LRIC të pastër.

AKEP konsideron ne menyre te vecante situaten dhe panoramen e tregut per te kater operatoret, kushtet favorizuese dhe disfavoret per operatoret e rinj ne treg, duke e monitoruar ne vijimesi tregun (ne menyre periodike), mban parasysh praktikat rregullatore qofte edhe ne raste te vecanta (shembuj te sjelle nga AMC dhe Vodafone) edhe per vende te tjera qe aplikojne nivele asimetrie te larta pertej references se sjelle nga rekomandimet e ERG.

Gjithesesi AKEP sjell ne vemendje te operatoreve dhe te gjitha paleve te interesuara se ne glide-path-in e propozuar per tarifen e terminimit te Plus, eshte ruajtur afati kohor (viti 2015), pavaresisht mos-perputhjes se vlerave te tarifes se asimetrise, duke marre ne konsiderate nje sere faktoresh te gjykuar si te drejte per zhvillimin e nje konkurrence me efektive ne kete treg.

AKEP synon arrijten e simetrise se plote ndermjet rrejteve celulare ne tarifimin e sherbimit te terminimit , por duke mos perjashtuar edhe mundesi te reja nderhyrje te referuara edhe ne propozimin e operatorit Eagle Mobile.

Ne lidhje me komentin e AMC per nje rivleresim te masave rregullatore te propozuara dhe detajim me te plote te tyre, AKEP sjell ne vemendje se asnje nga masat rregullatore te propozuara nuk perben barre te rende per operatoret dhe jane gjykuar ne proporcion te drejte me problemet e identifikuar.

AKEP nuk e gjykon te arsyeshme ne qendrimin e tij te perserise argumentet e dhena ne analizen e konsultuar, apo e thene ndryshe “analize mbi komentet” e operatoreve per faktet apo argumentet e trajtuara ne menyre te perseritura ne dokumentet e analizes se konsultuar apo te vendimarrjeve te meparshme.

Ne perfundim AKEP i qendron propozimit te bere ne dokumentin e konsultuar ne lidhje me implementimin e masave rregullatore, me qellimin e vetem rritjen e mundesive per nje konkurrence gjithnje e me efektive ne kete treg.

4. Terminimi i thirrjeve hyrese nderkombetare duhet te perfshihet apo te mos perfshihet ne tregun perkates te terminimit te thirrjeve ne nje rrjet celular?

Pergjigje e AMC:

Terminimi i thirrjeve hyrese nderkombetare eshte nje treg shume me kompleks per t'u trajtuar, pasi ndikimi direkt qe ai ka eshte tregu i huaj, pra jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Ai ka te beje me thirrjet qe origjinohen nga vende te tjera dhe qe terminojne ne rrjetet telefonike te operatoreve vendas. Pra, terminimi i thirrjeve hyrese nderkombetare eshte nje treg qe i kalon kufijte e nje vendi dhe karakterizohet nga nje marredhenie direkte ose indirekte (nepermjet tranzitimit) midis nje operatori vendas dhe nje operatori te huaj mobile ose fiks.

Pra, per te realizuar nje thirrje hyrese nderkombetare eshte e nevojshme qe nje operator vendas te lidhe nje marreveshje interkoneksioni me nje operator te huaj ne rastin e nje interkonektimi direkt te rrjeteve ose nepermjet disa operatoreve te cilet jane lidhur kaskade dhe secili me vete marrin tarifate e tranzitimit te cilet jane jashte nje juridiksionit te rregullimit ne nje vend perkates.

Percaktimi i ketij tregu duhet pare nga ana e zevendesueshmerise se kerkeses dhe te ofertes. Nga ana e kerkeses, nen skemen CPP (calling paying party), nje tarife e larte apo e ulet terminimi per thirrjet hyrese nderkombetare nuk ndikon tek rrjeti i thirrur i perdoruesit fundor, pra tek konsumatori shqiptar.

Keshtu aplikimi rregullimit te tarifave te thirrjeve hyrese nderkombetare edhe pse mund te aplikohet tek kompania fundore asnjehere nuk prodhon efektin e deshiruar per shkak te mosrregullimit te carrierave dhe operatoreve te huaj te cilet veprojne ne shtete te ndryshme. Ata aplikojne tarifa te ndryshme tranzitimi dhe rregullimi ne nje rrjet mobil perkates i terminimit te thirrjeve hyrese nderkombetare nuk transferohet tek origjina e thirrjeve.

Por ky aspekt, ne kendveshtrimin e tregut retail vendas nuk eshte i rendesishem per shkak se nuk ndikon konsumatorin vendas qe merr nje thirrje te origjinuar nga nje vend tjeter.

Tregu i terminimit te thirrjeve nderkombetare ne vitet e fundit eshte mjaft dinamik qe evidenton nje konkurrence te larte dhe efektive ne ofrimin e sherbimeve te terminimit nderkombetar dhe te tranzitimit.

Numri i madh i carriers nderkombetare te cilet ofrojne keto sherbime me tarifa te negociuara mbi baza komerciale ndermjet operatoreve tregon nje rritje te konkurrences pasoje e se ciles operatoret duhet te negociojne marreveshje bilaterale per trafikun nderkombetar si per ate te thirrjeve hyrese ashtu edhe per ate te thirrjeve dalese.

Gjithashtu, ne disa vende te Europes ky treg eshte i de-regulluar plotesisht per shkak te konkurrences efektive ne keto vende. Dhe ne nje dokument te konsultimit publik per tregjet e sherbimeve nderkombetare te thirrjeve me shumice te zhvilluar ne Angli ne 2006, operatoret e interesuar (psh. British Telecoms BT) jane shprehur per nje derregullim te plote te ketij sektori, per shkak te rritjes se konkurrences duke e pare kete sektor dhe ne nje optike me globale.

Duke marre ne konsiderate aspektet qe permendem me siper, dhe per me teper aspektin dimensional gjeografik si dhe tregun me pakice te lidhur direkt me te, dy faktore te rendesishem keta ne perkufizimin e nje tregu me shumice, mendojme qe terminimi i thirrjeve hyrese nderkombetare te jete nje treg i specifikuar me vete, i derregulluar plotesisht sic kerkohet ne pyetjen perkatese me poshte me opsionin c.

Pergjigje e Vodafone :

16. Vodafone Albania eshte e mendimit se terminimi i thirrjeve hyrese nderkombetare nuk duhet te perfshihet ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjeti celular. Kjo per shkak se ky treg gezon karakteristika te vecanta nga tregu i terminimit te thirrjeve te origjinuara nga brenda vendit dhe madhesia e ketij tregu ne realitetin shqiptar, e ben te ndryshem nga vende te tjera.
17. Kjo eshte nje eksperience e njohur edhe ne Bashkimin European ne vende qe kane karakteristika zhvillimi demografik deri diku te ngjashme me vendin tone, sic eshte dhe rasti i Kroacise dhe Bullgarise. Pikerisht ne rastin e Kroacise, autoriteti rregullator perkates HAKOM me ane te nje vendimit te muajit mars 2010 ka vendosur qe te heqe nga rregullimi i MTR (mobile termination rates, tarifat e terminimit celular) dhe glide path-in perkates tarifen e terminimit te thirrjeve qe origjinojne nderkombetarisht. Te gjitha operatoret celulare ne Kroaci aplikojne nje tarife te ndyshme (rreth 3 here me te larte) per thirrjet e origjinuara nderkombetarisht qe terminojne ne rrjetin etyre, krahasuar me thirrjet e origjinuara brenda vendit (12.41 €cents/minute perkundrejt MTR te rregulluar qe jane 4.4 €cents/minute, *burimi: Cullen International cross country analysis March 2012*).
18. Vodafone sugjeron qe terminimi i thirrjeve nderkombetare te mos perfshihet ne tregun e terminimit. Terminimi i thirrjeve nderkombetare negociohet nga Vodafone Albania drejtperdrejt me shoqerite nderkombetare (international carriers), si Belgacom ICS, British Telecom, Cable & Wireless, Telekom Italia, etj. Ne kontratat dypaleshe qe nenshkruhen operatoret e huaj i ofrojne Vodafone Albania mundesine e terminimit te trafikut ne rrjetet fikse dhe celulare ne bote duke percaktuar cmimin perkates, nderkohe qe Vodafone Albania ofron terminimin ne rrjetin e vet me cmimin e saj. Ne rast nderhyrje nga AKEP, ai do mund te rregulloje vetem njerin pale (terminimin e thirrjes nderkombetare ne Vodafone), nderkohe qe nuk mundet te rregulloje palen tjeter ne kete marredhenie kontraktore - shoqerite nderkombetare. Ky lloj rregullimi i njeanshem i AKEP, shkakton pabarazi kontraktuale mes operateve celulare shqiptare ne raport me shoqerite nderkombetare (international carriers) dhe demton rende interesat ekonomike te operateve celulare shqiptare ne raport me shoqerite nderkombetare.
19. Nga ana tjeter, perfshirja e thirrjeve nderkombetare ne tregun e terminimit ka shkaktuar deme ne financat e shtetit shqiptar per shkak te uljes se te ardhurave te operateve celulare shqiptare nga terminimi i thirrjeve nderkombetare. Kjo e fundit ka sjelle si pasoje dhe uljen e tatimit te pagueshem mbi te ardhurat e kompanise (duke filluar nga fillimi i periudhes se rregullimit ne vitin 2008 dhe deri ne Shkurt 2012). Vodafone Albania nepermjet letrave te kahershme ka dhene te

gjitha provat ne lidhje me impaktin negativ financiar te rregullimit te terminimit te thirrjeve nderkombetare. Edhe AKEP vete e ka pranuar ne statistikat e tij te pervitshme, madje dhe ne kete Analize (faqet 59 dhe 69 te saj) uljen ete ardhurave nga sektori i komunikimeve elektronike, e per rrjedhoje uljen e vleres se taksas se mbledhur te operatoret celulare te cilet mbajne barren kryesore ne kete fushe.

20. Perfshirja e thirrjeve hyrese nderkombetare ne tregun e terminimit, ka ulur ndjeshem cilesine e sherbimit qe i ofrohet perdoruesit fundor. Operatoret alternativee kane perdorur interkoneksionin kryesisht per te terminuar trafik nderkombetar, dhe jo per trafikun e abonenteve te tyre, gje qe ka shkaktuar mbingopje te kapaciteteve te interkoneksionit dhe renie te cilesise se sherbimit per abonentet shqiptare. Nga anan tjeter, trafiku nderkombetar i tranzituar nga operatoret alternative ka qene ne shumicen e rasteve pa CLI, ose me CLI te modifikuar, duke shkelur keshtu percaktimet e Ligjit 9918, Rregullores per Aksesin dhe interkoneksionin, Rregullores per Autorizimin e Pergjithshem dhe detyrimet e marreveshjeve te interkoneksionit. Renia e theksuar e cilesise se sherbimit eshte ndjere dhe te abonentet e Vodafone Albania kur keta jane ne roaming. Prej vitesh, abonentet e Vodafone Albania jane mesuar me standarte te larta sherbimi nga Vodafone Albania dhe me shfaqjen e numrit thirres ne telefonin e tyre (CLI), nderkohe qe per shkak te rregullimit te mesiperm, tashme nje pjese e konsiderueshme e trafikut nderkombetar po terminohet tek abonentet pa CLI.
21. AKEP ne menyre te drejte e ka trajtuar kete ceshtje ne VKD 1347 date 23.07.2010 ku eshte shprehur se [...] Rregullimi i terminimit per thirrjet hyrese nderkombetare dhe imponimi i ofrimit te terminimit ne rrjetet e operatoreve me FNT per operatoret tranzitues per thirrjet hyrese nderkombetare, ka sjelle probleme me CLI dhe cilesine e trafikut hyres nderkombetar, duke ndikuar indirekt edhe ne trafikun kombetar dhe thirrjet e abonenteve ne Shqiperi [...].
22. Persa i takon argumentit te kostove - Vodafone thekson se kosto e terminimit eshte me e larte ne rastin e thirrjeve nderkombetare, kur pika e marrjes se trafikut eshte ne kufi (per shkak se Vodafone ka investuar ne ndertimin e kapaciteteve per lidhjen me operatoret nderkombetare), sesa ne rastin e telefonatave kombetare ku pika e interkoneksionit eshte ne MTX 1 ne Tirane. Kjo kosto e shtuar natyrshem sjell nje tarife te ndryshme terminimi per thirrjet nderkombetare, megjithate tarifa me e larte garanton padyshim te ardhura te shtuara ne dobi te ekonomise shqiptare dhe taksane vlere me te madhe qe derdhen ne buxhetin e shtetit.

KONKLUZIONE:

Per gjithë sa me sipër, Vodafone Albania:

- Mbeshtet plotesisht qendrimin e AKEP per te rishikuar perkufizimin e tregut te terminimit te thirrjeve ne tregun celular.
- Sugjeron qe thirrjet nderkombetare te mosperفشihen ne rregullim dhe te perjashtohen nga tregu i terminimit te thirrjeve ne rrjetet e operatoreve celulare .
- Propozon qe terminimi i thirrjeve nderkombetare, ne rast se do te percillet nga operatoret vendas, duhet te trajtohet njelloj si per operatoret e huaj: me ane te marreveshjeve plotesisht komerciale mes paleve.

Pergjigje e Eagle Mobile:

Eagle Mobile gjykon që terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në Eagle Mobile nuk duhet të përfshihet në tregun përkatës të terminimit në këtë rrjet celular pasi ky shërbim ka efekt për

operatorët në dhe tregjet me pakicë në vendet e huaja dhe jo për operatorët dhe tregun me pakicë në Shqipëri.

Pergjigje e Plus Communicatios:

Nga tipologjia e shërbimit, thirrjet ndërkombëtare janë të ngjashme me thirrjet kombëtare, por konsideruar palën origjinuese dhe palën terminuese, ky “treg” karakterizohet nga tipare dalluese të veçanta. Ndryshe nga përkufizimi i dhënë nga AKEP për tregun përkatës, që bazohet tek koncepti i palës terminuese, tregu me shumicë i thirrjeve ndërkombetare përcaktohet sipas origjinës së thirrjes. Ky është një treg i hapur, i diversifikuar, shumë kompetitiv, nuk mund të aplikohen detyrime rregullatore, dhe në shumicën e rasteve s'mund të lidhet marreveshje direkte me secilin operator. Megjithë interesimin e madh që ka operatori pritës i thirrjeve ndërkombëtare, tregu me shumicë për thirrjet ndërkombetare varet nga tregu me pakicë në vendin e origjinës, i cili nuk është i njëjtë me tregun terminues, pra çdo masë rregullatore në tregun terminues, nuk do të sillte asnjë efekt direkt apo indirekt në tregun me shumicë të thirrjeve ndërkombëtare.

Për këtë, PLUS mendon që thirrjet hyrëse ndërkombëtare të mos përfshihen në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve në një rrjet celular. Secili operator duhet të ketë të drejtën të japë akses sipas kriterëve të veta dhe analizës vetiake për terminimin e thirrjeve në një rrjet celular. Për më tepër që operatorët celularë janë të autorizuar për të dhënë shërbimin e tyre brenda territorit të Shqipërisë dhe si të tillë nuk mund të vendosen rregulla për terminimin e shërbimeve të cilat origjinojnë jashtë territorit Shqiptar.

Pergjigje e NEOFONE:

Po, terminimi i thirrjeve hyrëse nderkombetare duhet te perfshihet ne tregun perkates te terminimit te thirrjeve ne nje rrjet celular. Ne praktikate nderkombetare nuk shfaqet asnje rast qe ky sherbim te mos te jete i perfshire ne tregun perkates te nje operatori FNT. Heqja e detyrimit sjell vetem mbyllje te tregut, gjithashtu ne rekomandimet e KE nuk ka asnje ndarje te tille. Bashkangjitur do te gjeni komentet e bera nga zyra e BEREC ne lidhje me kete ceshtje. BEREC shprehet se eshte ne kundeshitim me rekomandimin e KE “EU (C(2009) 3359)” qe trafiku me origjine kombetare te ndahet nga ai me origjine nderkombetare ne terminimin ne rrjetet mobile dhe fikse. Sic edhe AKEP eshte shprehur BE vertet ka ndare detyrimet per vendet e BE dhe JO BE por praktika e vendeve te BE eshte e tille qe te mos kete dallim midis trafikut kombetar dhe Nderkombetar. Ligji 9918 shprehet se duhet te perdoren praktikate me te mira te vendeve te BE dhe jo e kunderta. Kjo praktike nqs do te ishte e mire, konkruese dhe e bazuar ne rekomandimet e KE do te ishte praktikuar edhe ne vendet e BE. Ky arsye sjell vetevetiu argumentin qe kjo ndarje nuk i sherben rritjes se konkurrences dhe uljes se tarifave per abonetet shqiptare. As ne keto 5 muaj qe kjo praktike eshte ne fuqi ne Shqiperi nuk eshte vrejtur asnje permiresim ne tregun mobil duke ulur tarifate per abonetet fundor por ka sherbyer vetem ne prishjen e konkurrences midis operatoreve.

Qendrimi AKEP:

AKEP vlereson komentet e kater operatoreve celulare te cilat jane ne te njejten linje ne lidhje me trajtimin e terminimit te trafikut nderkombetar hyres, perfshirjen ose jo ne te njejtin treg me

terminimin kombetar, dhe nuk gjykon te paraqese argumente te tjere ne lidhje me kete ceshtje. Bazuar edhe ne komentet e operatoreve si dhe ne informacionin nga vendet e rajonit ne raportin e Mars 2012 te Cullen International,²⁶ ku ne te gjitha vendet e rajonit tarifat e terminimit te thirrjeve nderkombetare percaktohen ne marrveshje konfidenciale dhe jane jashte rregulimit, AKEP gjykon qe terminimi i thirrjeve hyrese nderkombetare te mos jete me pjese e tregut perkates te terminimit te thirrjeve ne rrjet celular, pra qe ky sherbim (ku secili operator ka FNT) te perfshije vetem thirrjet me origjine kombetare.

5. Detyrimet e operatoreve me FNT per terminimin e thirrjeve hyrese nderkombetare duhet:

- a. Te rregullohen si edhe terminimi i thirrjeve kombetare (trajtimi Shtator 2008-Shkurt 2012): dhenie aksesit dhe tarife rregulluar dhe ne kosto?**
- b. Te qendrojne sic jane aktualisht: detyrim per dhenie aksesit por me tarife komerciale?**
- c. Te de-rregullohet plotesisht: operatoret celulare te mos kene detyrim te japin akses, pra dhenia e aksesit dhe tarifa te jene komerciale kur kane interes te dy paleve?**

Pergjigje e AMC:

Edhe pse terminimi i thirrjeve nderkombetare hyrese eshte nje treg ne te cilin operatoret kane pozita monopoliste ne rrjetet e tyre perkates, ka disa aspekte te ndryshme ne lidhje me terminimin e thirrjeve kombetare per shkak te dimensionit gjeografik dhe ndikimit ne tregun celular me pakice.

Tregu i terminimit te thirrjeve nderkombetare eshte nje treg qe prek marredheniet midis operatoreve te dy vendeve te ndryshme, te cilet i nenshtrohen regjimeve rregullatore te ndryshme midis tyre, qe prek dhe natyren se si jane percaktuar keto tarifa ne vendet perkatese.

Praktika e ndjekur deri tani ne percaktimin e tarifave te terminimit nga AKEP dhe qe vazhdon te jete ende ne fuqi eshte negociimi komercial midis operatoreve ne marrveshjet e interkoneksionit midis tyre, sic eshte peraktuar me ane te VKD-ve perkatese nr.1739, 1740, 1741 dhe 1742, date 20.12.2011 per AMC, VDF Albania, Eagle mobile dhe Albtelekom, per de-rregullimin e tarifave te terminimit te thirrjeve hyrese nderkombetare.

Ne kete pike ne jemi dakort me opsionin (c) per nje de-rregullim te plote te tregut te thirrjeve hyrese nderkombetare: qe operatoret te mos jene te detyruar te japin akses dhe tarifat e terminimit te vazhdojne te jene mbi baza komerciale midis paleve te interesuara.

²⁶ As for calls originated from abroad, termination rates are not regulated in most countries (Croatia, Montenegro, Albania, Macedonia, Turkey Serbia and Kosovo), and are defined by commercial agreement (confidential).

Tregu i thirrjeve dalese nderkombetare per te cilat AMC si dhe operatoret e tjere mobile kane kostot perkatese funksionon ne kete menyre te derregulluar te plote. Duke kaluar ne derregullimin e plote te tarifave te terminimit te thirrjeve hyrese nderkombetare AMC dhe operatoret e tjere do te jene jo me ne nje pozite diskriminuese per kete lloj tregu por ne nje pozite te barabarte me operatoret e huaj nderkombetare dhe negocimi/bashkepunimi do te jete duke u nisur nga pozicione te njejta dhe ne interes te paleve.

Per me teper duhet te permendim se derregullimi i plote i tregut te thirrjeve hyrese nderkombetare do te kete nje efekt pozitiv per kompanite te cilat do te kene mundesi investimit te metejshme per produkte dhe sherbime te reja ne dobi te konsumatorit shqiptar, me tej nje efekt edhe me pozitiv ne buxhetin e shtetit.

Per me teper ne sugjerojme qe operatoret qe deshirojne te operojne ne tregun e tranzitimit te thirrjeve nderkombetare duhet te plotesojne kushtet e percaktuara nga AKEP per operimin ne nje sherbim te tille si dhe periudha tranzitore per keta operatore per perfitimin e ofrimit te nje sherbimit te tille te jete jo me pak se 2 vjet

Pergjigje e Vodafone :

1. Vodafone Albania shpreh qendrimin e saj plotesisht mbeshtetes per propozimin ne piken C - terminimi i thirrjeve nderkombetare ne rrjetet celulare duhet te jete nje treg plotesisht i lire, jo i rregulluar dhe operatoret celulare nuk duhet te mbartin asnje mase detyruese per te dhene akses ne kete drejtim; palet duhet te ofrojne kete lloj sherbimi vetem ne baza komerciale mes tyre.
2. Vodafone ka shprehur qarte pikeveshtimin e saj mbi kete ceshtje dhe ne pergjigjen e pyetjes me lart; se pari tregu per shkak te karakteristikave te tij nuk duhet te jete pjese e rregullimit. Se dyti cdo rregullim i pjesshem i tij perfshire detyrimi per akses (sic po ndodh dhe sot), sjell prishje ekuilibrash komerciale duke cenuar veprimtarine natyrale te faktoreve motorrike te tregut konkurrues: oferte-kerkese. Ne keto kushte AKEP duhet medoemos te garantoje liri te plote komerciale ne kete lloj sherbimi, ku pale te bejne zgjedhje te lira tregtare per partneret me te cilet duan te bashkepunojne. Cdo forme tjeter rregullimi pjesor ka rezultuar e pasuksesshme ne eksperincen e deritanishme te tregut shqiptar, duke sjelle mosmarreshje mes operateve, perkeqesim te cilesise se trafikut dhe tendences ne rritje per manipulim parametrash cilesie dhe fraud-i ekonomik.
3. Vodafone Albania nga ana e saj deshiron te ruaje standartet e cilesise qe aplikon prej vitesh me bashkepunoret e saj nderkombetare, cka i garantojne dhe emrin prestigjioz kompanise nder vite. Megjithate ne kushtet e nje rregullimi te pjesshem kjo eshte e pamundur. Pamundesia e perzgjedhjes se partnereve ne baza komerciale, passjell rezultate negative dhe per konsumatorin fundor. Aplikimi i nje ekonomie te lire tregu do te filtroje me se miri operatoret konkurrues dhe eficente, duke garantuar treg te shendetshem dhe benefite per konsumatorin fundor.

KONKLUZIONE:

Vodafone Albania mbeshtet AKEP per propozimin se terminimi i thirrjeve nderkombetare ne rrjetet celulare duhet te jete nje treg plotesisht i lire dhe jo i rregulluar.

Vodafone Albania sugjeronqe operatoret celulare nuk duhet te mbartin asnje mase detyruese per te dhene akses ne lidhje me trafikun nderkombetar; palet duhet ta ofrojne kete lloj sherbimi ne baza plotesisht komerciale dhe jo te rregulluara mes tyre.

Pergjigje e Eagle Mobile:

Eagle Mobile ka mirëpritur rregulloren e re të AKEP për rregjimin e Autorizimit të Përgjithshëm dhe konsideron se kushtet e përcaktuara në këtë rregullore duhet të aplikohen për të gjithë operatorët që synojnë të sjellin trafik ndërkombëtar në Shqipëri. Me qëllim sigurimin se operatorët plotësojnë kërkesat e cilësisë dhe me qëllim testimin e aftësisë së tyre për të plotësuar gjithë kërkesat ligjore, Eagle Mobile propozon amendimin e rregullores së Autorizimit të Përgjithshëm dhe futjen e një kategorizimi të ri në mënyrë të tillë që çdo operator që kërkon të aplikojë për tranzitimin e trafikut ndërkombëtar, pas plotësimit të kriterëve aktuale të rregullores së Autorizimit, duhet ti jepet fillimisht autorizimi për terminimin e trafikut ndërkombëtar në rrjetin e tyre për të paktën dy vjet.

Eagle Mobile gjykon se duhen konsideruar dhe nxjerrë konkluzione nga eksperiencat e mëparshme ku situata të pakontrolluara janë lejuar. Eagle Mobile gjykon se operatori i vetëm që ka infrastrukturën e nevojshme, lidhjet, eksperiencën dhe kredibilitetin për të ofruar shërbimin e tranzitimit të trafikut ndërkombëtar është Albtelecom sh.a dhe si i tillë, vetëm ky operator ka të drejtën e aksesit të pakufizuar për shërbimin e terminimit të trafikut ndërkombëtar në operatorët celularë.

Pergjigje e Albtelecom sh.a:

Ne reference të **Pyetje 5**, *Detyrimet e operatoreve me FNT për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare*, Albtelecom falenderon AKEP për masat e marra në adresimin e problemeve të regjimit të terminimit të trafikut ndërkombëtar. Megjithatë, në mënyrë që të sigurohet cilësia e shërbimit për konsumatorët shqiptarë dhe që të mbikqyret zbatimin e paanshem të detyrimit ligjor, Albtelecom konsideron se e drejta e tranzitimit të trafikut ndërkombëtar duhet t'i jepet vetëm operatorëve që kanë rrjete dhe investime mbarëkombëtare, duke mbrojtur në këtë mënyrë edhe mjedisin konkurrues. Albtelecom konsideron se AKEP mund të përfshijë në rregullat për autorizimin e përgjithshëm të drejtën e operatorëve alternativë për të sjellë trafik ndërkombëtar në rrjetet e tyre dhe parashikimin në këto rregulla që të testohet aftësia e tyre për të plotësuar të gjitha kërkesat e rregullave në fuqi në këtë drejtim për të paktën një periudhë dy vjeçare përpara se ndonjërit prej tyre t'i jepet e drejta për tranzitim ndërkombëtar.

Mbetet thelbësore që AKEP të imponojë kushtet plotësisht dhe në mënyrë të paanshme operatorëve që do të konsiderohen për t'u autorizuar për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacioneve dhe veçanërisht ato për të tranzituar trafik ndërkombëtar dhe të monitorojë zbatimin e vendimeve të tij.

Akesi i pakufizuar i Albtelecom në shërbimin e terminimit të trafikut ndërkombëtar me të njëjtën tarifë të terminimit të trafikut kombëtar në rrjetet e operatorëve celularë me Fuqi të Ndjeshme në

Treg është një e drejtë ligjore e Albtelcom dhe si e tillë duhet të respektohet në çdo kohë nga të gjitha palët e përfshira!

Në lidhje me kërkesat e reja për akses nga operatorë hyrës të rinj të cilët kërkojnë të përftojë autorizimin përkatës, Albtelcom konsideron se terminimi i trafikut ndërkombëtar duhet të derregullohet plotësisht dhe të mos aplikohet asnjë detyrim për dhënie aksesi, të paktën për atë kohë sa këta operatorë të kenë dëshmuar se janë në gjendje që në mënyrë konsistente të sigurojnë shërbimin për pajtimtarët e tyre sipas të gjithave kërkesave ligjore e rregullatore të anashkaluara prej tyre për një kohë shumë të gjatë.

Në referencë tëçeshteve të tjera të trajtuara nga dokumenti i analizës, duke vlerësuar dokumenti i analizën, statistikën dhe përfundimet e AKEP, Albtelcom konsideron se është koha që AKEP të konsiderojë disa probleme themelore të lidhura me konkurrencën efektive në tregjet me shumice dhe ato me pakicë dhe njëkohësisht të përcaktojë ndërhyrjet propocionale për shqetësimet dhe tu japin fund sjelljeve arrogante dhe të pamonitoruara të operatorëve të cilët për një kohë të gjatë kanë nxjerrë përfitime të pamërituara për shkak të situatave monopolistike të toleruara në terma afatgjatë.

Më specifikisht, Albtelcom konsideron se ecuria e përshkallzimit të tarifave të terminimit në rrjetet celulare drejt tarifa të orientuara në kosto për operatorët celularë është shumë e shtrirë në kohë dhe përshkallëzimi nuk ështëproporcional dhe në të njëjtën kohë nuk justifikohet as nga rrethanat e tregut. Konkurenca sa vjen e bëhet edhe më ineficente, në rradhë të parë përmes abuzimit me efektet e klubeve të kombinuara këto me nivelin e tarifave të terminimit celulare. Legjislacioni shqiptar, por edhe kuadri rregullator europian thekson nevojën e aplikimit të tarifave të interkoneksionit në rrjetet celulare të orinetuara në kosto me qëllim përfitimin maksimal të konsumatorit. Ky parim, plotësisht i mbështetur edhe nga Ligji për Komunikimet Elektronike i hyrë në fuqi që në vitin 2008 duhet të mbështetet në mënyrë me adekuate nga “glide-path” i vendosur nga AKEP i cili shtrihet deri në vitin 2015. Albtelcom konsideron se duhet rishikuar ky glidepath si përsa i takon nivelit të përfundimit të tij, i cili duhet të jete conformant me LRICtë pastër ashtu edhe sa i takon kohës së implementimit të tij, kohe kjo e dëshmuar si mjaft e gjatë dhe e dëmshme për tregunë komunikimeve elektronike në përgjithësi, operatorët më të vegjël në vëcantë dhe përbën rrethanë avantazhuese për operatorët e mëdhenj për tu adaptuar dhe për të maksimizuar të ardhurat në kushtet e një kostoje më të ulët në ofrimin e shërbimeve.

Albtelcom sjell në vëmendje se e tashmja dhe ardhmja e shërbimeve të komunikimeve elektronike është konvergjenca dhe si e tillë prirja globale është për uljen e tarifave të terminimit të operatorëve celularë varësisht fuqisë së tyre në treg dhe stabiliteti i tarifave të operatorëve të telefonisë fikse. Ndërkohë që në tregun shqiptar po ndodh e kundërta, operatorët celularë më të mëdhenj në treg po konkurojnë Albtelcom në të gjitha tregjet dhe veçanërisht në tregjet e pakicës. Një pajtimtar i Albtelcom komunikon mesatarisht 100 minuta në muaj, ndërkohë që minutazhi mesatar i përdorimit të një aboneti celular të AMC dhe Vodafone është 170 minuta në muaj. Kjo vjen pasi pajtimtarët e tyre komunikojnë me tarifa ekstremisht të ulta mes njëri tjetrit, tarifa të cilat janë disa herë më të ulëta se ato të terminimit në rrjetet e tyre, Në këtë mënyrë,

përdorimi i shërbimi të telefonisë fikse po dekurajohet kështu nga vetë kuadri rregullator në përputhje me të cilin operon Albtelecom. Atëherë, në kushtet kur operatorët e mëdhenj celularë konkurojnë tregjet e pakicës me Albtelecom, çeshtja shtrohet përse të jetë i legjitimuar operatori celular që në terma afatgjatë, me një pjesë tregu shumë herë më të madhe se Albtelecom në tregun ekomunikimeve elektronike, të ofrojë shërbimin e terminimit në rrjetin e tij me tarifa deri në 5 herë më të larta se tarifat e terminimit në rrjetin fix të Albtelecom? Dhe e gjitha kjo në rrethanat kur Albtelecom ka perballuar i vetem deficitin e aksesit dhe po ashtu detyrimet e vendosura për shërbimin universal.

Ndërkohë konsiderojmë se është e nevojshme të vazhdohet të njihet nga AKEP nevoja për të rivendosur dhe mbajtur në një balance kompensuese në raport me operatorët e mëdhenj celularë nivelin e tarifave të terminimit në rrjetet fikse, e lidhur kjo edhe me nevojën për një kontribut në deficitin e aksesit.

Pergjigje e Plus Communicatios:

Përsa i përket këtyre detyrimeve PLUS mendon:

5.a. Kjo masë nuk do të sillte asnjë të mirë për tregun, konsideruar se AKEP mund të vendosë masa shtrënguese rregullatore vetëm për atë pjesë të tregut të thirrjeve ndërkombëtare ku operojnë operatorët kombëtarë, ndërkohë që pjesa tjetër e tregut i mbetet operatorit ku përfundon thirrja dhe marrëdhëniet që ka ai me blerës dhe shitës jashtë këtij territori. Pra, kjo do të sillte një standard të dyfishtë për të njëjtin shërbim.

Ndërkohë që për operatorët kombëtarë që kanë statusin e tranzituesit, duke patur mbështetjen e rregullimit të detyruar të shërbimit nuk arrijnë të sigurojnë një shërbim cilësor sic mund të ofrohej në kushtet e një tregu të hapur konkurrues.

Ndërsa imponimi i tarifave të rregulluara për tregun e thirrjeve ndërkombëtare do të çorientonte tregun ndërkombëtar dhe do të ndikonte negativisht në marrëdhënien direkte të operatorit terminues me tranzituesit ndërkombëtar.

5.b. Me pretekstin e detyrimit për ofrim aksesi, operatorë tranzitues lidhen dhe ofrojnë trafik ndërkombëtar me parametra jo cilësore, prandaj ky kusht do të ishte i vlefshëm vetëm në rastet kur operatorët tranzitues dhe terminues do të kishin mundësi për të kontrolluar cilësinë e trafikut, duke rritur parametrat e SLA, dhe duke vendosur masa parandaluese për raste abuzive.

5.c. Një de-rregullim do t'i ofronte tregut një konkurrencë me të madhe, rrjedhimisht një shërbim më cilësor dhe operatorët tranzitues kombëtarë do të ofronin një shërbim të nivelit sipas parametrave të tranzituesve ndërkombëtarë. Në këto kushte, operatori terminues gjen aktualisht mundësi për të operuar me tranzitues ndërkombëtarë, vendar apo të huaj, duke patur me shumë oferta për të njëjtin shërbim.

Detyrimi i dhënies së aksesit me tarifë komerciale lë vend edhe për zgjatje të procesit si pasojë e ankesave të njerës palë dhe vendimarrjes së autoriteteve. Prandaj de-rregullimi i plotë do të ishte më mirë në mënyrë që të mos ketë asnjë detyrim për dhënien e aksesit dhe tarifës komerciale nëse nuk është në interes të të dy palëve.

Pergjigje e NEOFONE:

Detyrimet e operatoreve me FNT per terminimin e thirrjeve hyrese nderkombetare duhet te rregullohen si edhe terminimi i thirrjeve kombetare (trajtimi Shator 2008-Shkurt 2012): dhenie aksesi dhe tarife e rregulluar dhe ne kosto. Kjo eshte edhe fryma e ligjit 9918 per te orientuar tarifat ne kosto si dhe vendosja e detyrime:

- a. mosdiskriminimi,
- b. detyrimi i transparences
- c. detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit
- d. orientuar tarifat ne kosto
- e. t'u ofrojë palëve të treta akses dhe interkoneksion në rrjet dhe elementet e tij;
- f. te ofrojë terminim te thirrjeve hyrese derkombetare ne nivel shumice, per t'u rishitur nga operoret e autorizuar nga AKEP;
- g. të mos anulojë aksesin në facilitetet, kur e ka dhënë atë
- h. të negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses
- i. të interkonektojë rrjetet ose facilitetet e rrjetit.

AKEP duhet te aplikojë sa me gjere rekomandimet e KE ku tek te cilat nuk ka nje dallim midis sherbimit te terminimit te thirrjeve me origjine Kombetare nga ato me origjine Nderkombetare.

Qendrimi AKEP:

Te gjitha komentet e dhena per pyetjen e shtruar nga AKEP, kane ne thelb te tyre argumentet e perdorura edhe me pare ne analizat pararendese ne lidhje me trajtimin e trafikut nderkombetar si dhe llojet e detyrimeve rregullatore qe mund te vendosen apo per rastin e nje de-rregullimi te plote. Pothuajse te gjithë operoret orientojne komentet e tyre ne mundesine e zgjedhjes se opsionit 'c', te parashtruar ne pyetjen e shtruar nga AKEP. Nderkohe operoret alternative duket se jane per opsionin'a'.

Zgjedhja e alternatives ne pyetjen 5, eshte e lidhur me perfundimin e arritur ne pytjen 4. Bazuar ne perfundimine arritur ne piken 4, qe terminimi I thirrjeve hyrese nderkombetare te mos jete pjese e tregut perkates te terminimit te thirrjeve hyrese ne nje rrjet celular, pra qe sherbimi ku operatori eshte me FNT te perfshije vetem terminimin e thirrjeve kombetare, gjykon se alternative e duhur eshte alternative 'c': dhenia e aksesit dhe tarifa e terminimit te thirrjeve hyrese nderkombetare ne nje rrjet celular eshte objekt i negociatave komerciale midis paleve. Sic eshte theksuar edhe ne qendrimin e AKEP per pyetjen 4, kjo zgjidhje eshte ne linje edhe me praktiken ne vendet e rajonit.

Duke gene se ky derregullim perben nje heqje detyrimi per FNT te operatoreve celulare AMC, Vodafone dhe EM, AKEP gjykon se efektet e tij te fillojne nga 1.09.2012 duke dhen kohen e duhur lojatrve te tregut per pershtatje ne vijim edhe te derregullimit te tarifes se ketyre thirrjeve qe hyri ne fuqi me 1.02.2012.

6. A mendoni se AKEP duhet te marre ne konsiderate rekomandimin e vitit 2009 te KE (2009/396/EC) per modelim te paster BULRAIC per terminimine thirrjeve celulare duke rishikuar modelin BULRAIC te vitit 2010 apo duke kryer neq model te ri?

Pergjigje e AMC:

Modeli BULRAIC per terminimin e thirrjeve ka filluar implementimin ne vitin 2010 ne Shqiperi dhe ne baze te ketij modeli jane percaktuar dhe tarifat e terminimit per rrjetet celulare nga AKEP me ane te vendimet perkatese te Shkurt 2011 per operatoret mobile.

AMC rekomandon vazhdimin e modelit BULRIAC meqenese operatoret tani jane familjare dhe e njohin modelin dhe se si ai funksionon.*

Ky model ka prodhuar nje gladpath te tarifave te terminimit te cilat jane dale me nje vendim te AKEP dhe iu jane prezantuar operatoreve celulare.

Operatoret celulare mbi bazen e tyre kane bere planet afatgjata te biznesit.

Pergjigje e Vodafone :

23. Vodafone Albania shprehet se AKEP ka miratuar nje metodologji per llogaritjen ekostove te terminimit ne rrjetet celulare perkates para vetem 1 viti(VKD 1505 date 10.02.2011). Pergjate konsultimit publik perkates te modelimit te kosos ne kemi shprehur tona, duke filluar qe nga forma e realizimit te procesit (nga ana procedurale) por padyshim dhe ne permbajtjen e materialit dhe perllogaritjes se kostove te operatoreve ne modelim. Megjithate, pergatitja e modelit perfundimtar kerkoi shume kohe dhe perpjekje mes paleve te interesuara, organit rregullator dhe pales konsultuese qe mori persiper draftimin e modelit. Prandaj cdo tentative e re, per rishikimin e modelit te kosos ka nevoje per kohe parapake njoftimi, shqyrtimi, negociatash, mbledhje informacioni, kryerje analizash e debatesh te hapura.

24. Vodafone Albania shprehet dakord me sugjerimin e AKEP qe procesi i rishikimit te kosos nuk duhet te jete jo vetem pjese e ketij konsultimi, por as ne planin afat mesem te AKEP.Dokumenti final i orientimit ne kosto te tarifave celulare (sipas modelit BULRAIC) eshte miratuar nga AKEP nepermjet VKD 1505 date 10.02.2011dhe ai duhet te mbetet i pandryshuar per te siguruar konsistence ne shendetin financiar dhe planet e biznesit. Ndryshimi i metodologjive te kosos brenda periudhash kohore kaq te shkurtra, shkaktojne pasiguri te biznesi ne ndertimin e planeve te tij, dhe demtojne rende incentiven per investim, ndaj Vodafone shprehet kundra nje inisative te tille per ndryshim brenda nje kohe kaq te shkurter nga miratimi i metodologjise se pare. Per Vodafone Albania kjo eshte edhe me e veshtire, pasi po perpiqet ende te rikuperoje kosot e spektrit 3G.

25. Nga ana tjeter kujtojme AKEP qe kjo metodologji nuk po aplikohet ende nga njeri prej operatoreve celulare, Plus Communication, ndaj eshte e pajustificuar cdo perpjekje drejt nje modeli te ndryshem kostoje ne kete moment.

26. Rekomandimi Europian per trajtimin rregullator te tarifave te terminimit (2009/396/EC) kerkon qe autoritetet rregullatore te implementojne nje metodologji drejt kostove eficente brenda Dhjetorit 2012 - AKEP e ka bere kete nepermjet metodologjise se miratuar nga VKD 1505 qe nga muaji Shkurt 2011.Nga ana tjetere i kujtojme AKEP se po ne kete Rekomandim parashikohet dhe nevoja per simetri te plote mes tarifave te terminimit mes operatoreve ne treg brenda Dhjetorit te vitit 2012, por AKEP per asnje cast nuk e permend kete standart, pavaresisht perpjekjeve te vazhdueshme te Vodafone Albania mbi ceshtjen ne fjale.
27. Modeli kosos 'LRIC te paster' jo detyrimisht eshte modeli i sakte dhe i duhur - ky model ka argumentat e tij pro dhe kunder per menyren e trajtimit te kostove, sidoqofte kjo do te jete objekt diskutimi ne nje moment te mevonshem te rishikimit te kostove. Ajo cka eshte me e rendesishme per te gjithë procesin eshte qe²⁷:
- Tarifat te jene te orientuara drejt kosos; kjo eshte kryefjala qofte e Direktives dhe qofte e Ligjit 9918; persa i takon metodologjise se zgjedhur, recitali 20 i Direktives 2002/19/EC parashikon se "metoda e rikuperimit te kostove duhet ti pershtatet rrethanave".AKEP e ka bere kete tashme.
 - Rregullim mund te vije ne forma te ndryshme - orientim ne kosto, benchmark, etj por e rendesishme eshte qe perfundimi te jete ne favor te konkurrences dhe konsumatorit;AKEP e ka bere tashme kete.
 - Konsultimi eshte element thelbesor i procesit - nuk ka nje pergjigje korrekte per metodologjine e duhur pasi ajo eshte ne varesi te kushteve dhe rrethanave perkates te tregut. Modele te sukseshme,ne varesi te rrethanave ku aplikohen, mund te jene gjithsecili prej: modeli hibrid, zhvleresimit ekonomik, forward-looking model duke perfshire te dhena historike, alokimi i kostove ndermjet sherbimeve ne varesi te rutimit, prezumimit te rrjeteve eficiente ne tregje konkurruese, teknologjia ne perdorim 2G apo 3G, apo rasti qe uljet ne MTR ti pasohen perdoruesit fundor nese passjellin pritshmerite e deshiruara.
 - Ndryshimi kerkon kohe - periudha tranzitore e kalimit nga nje rregullim ne tjetrin ka impakt te madh per sherbimet e telefonise celulare. Ndodh shpesh qe ne vendet ne zhvillim e siper, autoritetet rregullatore nxitojne te vendosin kosto te orientuara, nderkohe qe e kunderta ka ndodhur ne ne Europe kur operatoreve u eshte lene kohe mjaftueshem te vete-rregullojne tarifat perpara se orientimi ne kosto te aplikohet. Dukembajtur parasysh kostot e larta te operatoreve per shtrirje ne zona rurale, apo investime ne rrjetin 3G si ne rastin e Vodafone Albania, rekomandohet qe autoritetet rregullatore te tregojne kujdes me implementimin e MTR dhe periudhat kohore perkatese.

KONKLUZIONE:

Per gjithë sa me lart, Vodafone Albania:

²⁷Argumentat me poshte listuar jane cituar nga dokumenti analizues i publikuar nga organizata GSMA 'The setting of mobile termination rates; best practice in cost modelling' pergatitur nga PWC

Mbeshtet propozimine AKEP per te mos ndryshuar metodologjine e kosos pergjate kesaj analize tregu, pasi eshtee papershtatshme dhe e panevojshme. AKEP duhet te aplikojte glide-path qe eshte miratuar nepermjet modelit BULRAIC per te gjithë operatorët celulare, pa perjashtim. AKEP ka miratuar një metodologji per llogaritjen e kostove te terminimit ne rrjetet celulare perkates para vetem 1 viti (VKD 1505 date 10.02.2011. Cdo perpjekje per rishikimin e modelit te kosos ka nevoje per kohe parapake njoftimi, konsultimi, kryerje analizash dhe debatesh. Ndryshimi i metodologjive te kosos brenda nje kohe te shkurter eshte jo – i rekomandueshem pasi shkakton pasiguri te biznesi ne ndertimin e planeve dhe demton rende incentiven per investim.

Pergjigje e Eagle Mobile:

Mendojmë se AKEP duhet të marrë në konsideratë rekomandimin e vitit 2009 të KE (2009/396/EC) për modelim të pastër LRIC për terminimin e thirrjeve celulare. Modeli i llogaritjes së kosos LRIC përcakton tarifat e terminimit bazuar në kostot e ofrimit nga një operator eficient dhe lejon vetëm rikuperimin e kostove të shkaktuara direkt nga terminimi. Në këtë mënyrë duke mos përfshirë kosto të tjera, të cilat prezumohen se do jenë shlyer më parë, tarifat e terminimit ulen ndjeshëm për të gjithë operatorët. Ulja e MTR shoqërohet me tarifa më të ulëta për pajtimtarin për thirrjet jashtë rrjetit dhe reduktim të efekteve negative për konkurrencën në treg që vijnë si rezultat i kombinimit të tarifave të larta të terminimit me diferencimit të tarifave on-net me ato off-net.

Pergjigje e Plus Communicatios:

Konsultimi i mëparshëm tregoi se BULRAIC kishte mospërputhje me kërkesat dhe perceptimin e operatorëve për këtë metodologji. Metodologjia bazuar në kosto është e ndryshme për cikle të ndryshme të jetegjatësisë së një rrjeti, për më tepër kur kjo ndërthuret dhe me teknologji të ndryshme, dhe kosto të ndryshme. Një metodologji e tillë bazuar në kosto e ul konkurrencën midis operatorëve dhe mban të favorizuar operatorët më të konsoliduar në treg. AKEP ka ulur tarifat bazuar në këto metodologji, por një mënyrë e tillë ka komplikuar procesin e vlerësimit të ndarjes së kostove.

Pergjigje e NEOFONE:

Jo, Akep duhet te ndermarre kete ndyshim ne nje moment tjeter kur efektet e modelit BULRAIC te aplikur deri tani te kene mbaruar dhe te jene orientuar plotesisht drejt tarifes 4.6 Lek/min sic jane kostot reale dhe nje norme fitimi e arsyeshme. Nje proces i devijuar do te deformonte pritshmerite e procesit. Neofone mendon se trajtimet e nisura me modelin BLURAIC duhet te cohen deri ne fund dhe pastaj te nisin procese te reja, pasi zevendesimi i nje projekti i cili nuk ka perfunduar tregon mungese strategjie dhe nuk jep produktet e kerkuara.

Qendrimi AKEP:

Komentet e sjella per kete pyetje kryesisht jane te orientuara drejt idese se perfundimit te glide path-it aktual i ndertuar sipas modelit BU-LRAIC, por gjithashtu ka edhe sugjerime mbi mundesite e rishikimit te kostove referuar LRIC +.

Qendrimi AKEP per kete rast eshte se do te monitoroje me vemendje te posacme zhvillimet e adhsme ne treg, duke mos perjashtuar asnje opsion te mundshem qe favorizon konkurrencen apo sherben si nje shtyese per nivele te reja te konkurrences ne treg.

AKEP gjykon qe aktualisht te vazhdoje me implementimin e fazave te reduktimit te pershkallezuar (glide path) te percaktuara ne Shkurt 2011, qe pritet te perfundoje ne aplikimin e fazes se fundit duke filluar nga Shtator 2013 per tre operatoret me te medhenj. Per periudhen pas 2013 AKEP gjykon se aplikimi i modelit BULRAIC i paster dhe rekomandimit te KE do te ishte menyra me e mire per rregullimin e tarifave te terminimit ne rrjetet celulare. Per te realizuar kete AKEP, do te ndertoje nje model te ri te paster BULRAIC ose do te perdore nivelin benchmark te vendeve qe e kane ndertuar keto modele per percaktimin e tarifave te terminimit ne rrjetet celulare (sipas rekomandimit te KE).

Gjithesesi AKEP siguron operatoret se cdo hap i ri qe mund te ndermerret ne kete drejtim do jete ne nje bashkerendim veprimesh me operatoret dhe transparent sipas praktikave me te mira te ndjekura edhe nga rregullatore te tjere ne kete drejtim.

7. Si ka ndikuar hyrja e Eagle Mobile dhe Plus Communication ne tregun celular me pakice ne aspektin e tarifave dhe cilesise se sherbimeve?

Pergjigje e AMC:

Futja ne treg e dy operatoreve te tjere Eagle Mobile dhe Plus Communications ka ndikuar pozitivisht ne rritjen e konkurrences ne tregun celular me pakice, ne terma tarifore dhe te cilesise se sherbimeve. Krahas faktoreve te tjere sic jane Portabiliteti I Numrit dhe futja e sherbimeve 3G ne treg, aktiviteti i dy operatoreve Eagle Mobile dhe Plus Communication ka bere qe te rriten ofertat per perdoruesin fundor, te rritet mundesia e zgjedhjes qe kane abonentet, si dhe kjo ka shtuar dhe perpjekjet e te 4 operatoreve per te rritur me tej cilesine e sherbimeve te ofruara drejt klienteve.

Gjate periudhes 2010- 2011, vihet re nje dinamizem me i madh ne treg, nese i referohemi dhe te dhenave statistikore te publikuara nga AKEP per 2011, nje rritje e konsiderueshme e konkurrences dhe nje evidence e qarte per kete eshte dhe renia e te ardhurave ose nje rritje me e vogel e tyre ne krahasim me vitet e meparshme e dy operatoreve me te medhenj AMC dhe Vodafone dhe rritja e kuotave ne tregun me pakice te Eagle Mobile dhe Plus Communications, ne terma abonentesh dhe te ardhurash.

Struktura e tregut eshte teper konkurruese dhe kjo tendence eshte gjithmone dhe ne rritje dhe per te ardhmen, nese shohim dhe ecurine e tarifave retail te cdo operatori, qe sa vijne e behen me te uleta dhe kjo reflektohet ne nivelin e te ardhurave retail ne kete treg. Faktor kyc ne kete tendence

ka qene dhe futja e portabilitetit te numrit, sidomos ne aspektin e cilesise se sherbimit, duke shtuar me shume perpjekjet e cdo operatori jo vetem per te ruajtur abonentet ekzistues, por te mundohet qe me politika tarifore sa me konkurruese te thithi dhe abonente te tjere ne rrjetin e tij.

Tendenca drejt nje konkurrence me efektive qe ishte vene re qe ne analizen e meparshme te tregut Mars 2010 eshte realizuar dukshem, sic shihet dhe nga te dhenat e mesiperme, dhe nga te dhenat statistikore te publikuara per vitin 2011 nga AKEP, si ne term ate ardhurash, ne numer abonentesh (me nje rritje te konsiderueshme te normes se penetrimin), dhe ne terma tarifash sipas paketave tarifore qe kane ofruar te kater operatoret.

Nese shohim dhe nje lidhje integrale me tregun me shumice te akses origjinimit, kjo analize perforcon me tej panevojshmerine per te ndermarre nje analize te tregut me shumice te akses origjinimit te thirrjeve per te analizuar mbi mungesen e nje konkurrence efektive.

Rritja e konkurrences ndikon dukshem edhe ne rritjen e cilesise se sherbimeve qe i ofrohen konsumatorit final, sidomos ne kontekst dhe te dy faktoreve te tjere: portabiliteti i numrit dhe ofrimi i sherbimeve 3G. Sherbimet 3G ofrojne cilesi dhe shpejtesi me te larte per konsumatorin, duke ndikuar me tej dhe ne reduktimin e tarifave.

Operatoret kane qene teper aktiv ne procesin e bartjes se numrit gjate periudhes 2010-2011 (ku vihet re nje numer i larte portimesh qe e kalojne 70.000 portime qe nga periudha qe ka filluar ky proces), ku dy operatorete rinj Eagle Mobile dhe Plus Communication kane zbatuar politika teper agresive ne drejtim te rritjes se numrit te abonenteve ne rrjetet perkates, dhe kjo ka bere qe dy operatoret me te medhenj te reagojne nepermjet uljes se tarifave retail per konsumatorin.

Pergjigje e Vodafone :

1. Vodafone Albania shprehet dakord me perfundimet e arritura nga AKEP persa i takon rritjes se konkurrences ne tregun e pakices. Kjo eshte rrjedhoje e uljeve te vazhdueshme qe ka aplikuar Vodafone Albania ne tarifat thirrjeve zanore, SMS dhe data, cka e ka bere tregun me konkurrues. Ne keto kushte Vodafone Albania eshte e mendimit, sic edhe AKEP shprehet ne analize, qe ky treg nuk ka nevojte per nderhyrje te tjera pasi tregun shenja maturimi te plote, zhvillon nje konkurrence efektive dhe garanton perfitime te konsiderueshme per konsumatorin fundor.

Pergjigje e Eagle Mobile:

Hyrja e Eagle Mobile ne treg eshte shoqeruar me ofrimin prej ketij operatori te tarifave me te uleta dhe mundesis se zgjedhjes se planeve tarifore te ndryshme. Megjithate, efektet e hyrjes ne treg te operatorëve te vegjel kanë patur ndikim te kufizuar ne tregun celular me pakice per shkak te operatorëve te medhenj dhe strategjise se perdorur prej tyre, per ruajtjen dhe zmadhimin e pjesëve te tyre te tregut dhe moslejimin e rritjes te hyresve te rinj.

Pergjigje e Plus Communicatios:

Nga vetë analiza e AKEP, hyrja e operatorëve të rinj në treg ka ndikuar në konkurrencë dhe kjo duket, ndër të tjera, dhe në vlerat e dhëna nga indeksi HHI për vitin 2011 krahasuar me vitin 2006 ku tregu, sipas këtij indeksi, tregon një treg duopolist në nivel përdoruesish dhe të ardhurash. Por pjesa e tregut që kanë aktualisht (2011) dy operatorët më të mëdhenj

evidentojnë se ka ende vendosje monopolistike dhe operatorët e rinj kanë ende për të bërë për të arritur një konkurrencë efektive.

Si rrjedhojë e ndërhyrjes rregullatore, ndikimi është i dukshëm dhe në tregun celular me pakicë, në cilësinë e shërbimit (rregullorja për cilësinë e shërbimit), përditësim të RIO.

Hyrja e operatorëve të rinj ka ndikuar në ndryshimin e ndarjes së tregut, gjë që ka ndryshuar statusin e përqendruar të tregut nga dy operatorë sipas të dhënave të vitit 2006.

Duke vijuar me tej, në një treg të vogël si Shqipëria ofrim i shërbimit të telefonisë celulare nga 4 operatorë, ndikon patjetër në konkurrencë, kufizimet dhe cilësia e shërbimeve janë faktorët kryesorë. Ndikimi në uljen e tarifave me pakicë, njëkohësisht ka krijuar një ambjent potencial për rritjen e cilësisë së shërbimeve. Përveç aspektit të tarifave i cili është ndjerë në mënyrë pozitive nga abonentët e shërbimit të telefonisë celulare, rritja e cilësisë së shërbimeve ka filluar të ketë një efekt në rritje për zgjedhjen e ofertave dhe produkteve të të gjithë operatorëve në treg.

Pergjigje e NEOFONE:

Relativisht mire. Tarifat per thirrjet Off-net nuk kane ndryshuar gati aspak ne kundesthim me tarifat on-net te cilat jane ulur shume.

Qendrimi AKEP:

AKEP vlereson komentet e bera nga operatoret, duke shpreh dakortesine me opinionet e tyre dhe faktet e servitura mbi rritjen e nivelit te konkurrences ne tregun celular. Vleresimi i bere se hyresit e rinj ne kete treg, Eagle Mobile dhe Plus Communications kane nje kontribut te drejteperderjte ne rritjen e nivelit te konkurrences, duket edhe nga fakti qe tregu aktualisht ka shume tregues te rritjes se nivelit te konkurrences.

Por duke synuar objektivin e rritjes se nivelit te konkurrences efektive, AKEP gjykon te nevojshme monitorimin ne vijimesi te ketij tregu si dhe implementimin e cdo mase te nevojshme rregullatore qe favorizon zhvillimin efektiv te konkurrences ne kete treg.

8. Cfare mendoni per konkluzionin e AKEP per rritjen e konkurrences ne tregun me pakice celulare dhe treguesit e marre ne konsiderate per kete perfundim si ndryshimi i pjeseve te tregut, rritja e ndjeshme e perdorimit mesatar te thirrjeve, renia e te ardhurave dhe normave te fitimit te dy operatoreve me te medhenj, rritjen e perfitimeve te perdoreve celulare nga portabilitetit dhe sherbimet 3G?

Pergjigje e AMC:

Tregu me pakice i sherbimeve celulare eshte bere gjithmone e me shume konkurrues gjate dy viteve te fundit per shkak dhe te disa faktoreve te rinj qe kane mundesuar rritjen e konkurrences ne treg midis operatoreve: futja e operatorit te 4-t ne treg, portabiliteti i numrit, hedhja ne treg e

sherbimeve te reja 3G, orientimi i tarifave me shumice sipas modelit BULRAIC, reduktimi i tarifave te terminimit te SMS-ve me impakt ne tregun retail te SMS-ve, etj.

Struktura e tregut retail celular ka pesuar ndryshime te ndjeshme per sa i perket perqendrimin te operatoreve, normes se te ardhurave qe kane shenuar renie gjate 2010 dhe 2011 ne te gjithë sektorin mobile, ku dallohet nje humbje e kuotave ne treg te dy operatoreve kryesore AMC dhe Vodafone, dhe nje rritje te ndjeshme te kuotes ne treg per operatorin e ri Plus si ne nivel te ardhurash dhe ne nivel perdoruesish.

Operatoret kane rritur ndjeshem sherbimet dhe ofertat per perdoruesit, duke bere qe te ulen ndjeshem tarifat me pakice, si pasoje dhe e futjes se portabilitetit te numrit per telefonine e levizshme, me nje levizje te konsiderueshme te abonentëve midis operatoreve (rreth 70.000 per nje periudhe 12 mujore).

Hedhja e sherbimeve te reja 3G ka ndikuar me tej ne kete tendence duke rritur me shume perfitimet e konsumatoreve.

Ulja e tarifave me pakice si brenda dhe jashte rrjetit (on dhe off net), ka ndikuar ne rritjen e perdorimit te thirrjeve, te SMS-ve, dhe ne nje renie te te ardhurave ne nivel te pergjithshem ne sektorin celular.

Sic vihet re dhe ne grafiket ne pyetjen e meparshme, nga raporti Cullen IV Nentor 2011, vihet re nje renie e ndjeshme e tarifave retail, e te ardhurave ne sektorin celular retail, dhe nje afrim rreth mesatares se vendeve te BE-se.

Treguesit e ekspozuar nga AKEP ne dokumentin e Statistikes se tregut per vitin 2011, tregojne per nje tendence ne renie dhe ne te ardhmen, duke evidentuar nje konkurrence efektive ne rritje ne te ardhmen, me perfitime me te medha per konsumatoret.

Ne pergjithesi jemi dakort me konkluzionet e AKEP ne lidhje me treguesit e mesiperm, te renditur ne kete analize tregu.

Tendenca ne rritje e konkurrences ne te ardhmen do te forcohet akoma me tej dhe me pajisjen e dy operatoreve te tjere me licensen 3G, me permeresimin e metejshem te procesit te portabilitetit te numrit dhe numrit me te madh te levizjes se abonentëve ne te ardhmen.

Pergjigje e Vodafone :

28. Vodafone Albania shprehet dakord me perfundimet e arritura nga AKEP persa i takon rritjes se konkurrences ne tregun e pakices. Kjo eshte rrjedhoje edhe e uljeve te vazhdueshme qe ka aplikuar Vodafone Albania ne tarifat thirrjeve zanore, SMS dhe data (ndryshim nominal te cmimeve ose nepermjet ofertash bundle), cka e ka bere tregun me konkurrues. Ne keto kushte Vodafone Albania eshte e mendimit, sic edhe AKEP shprehet ne analize, qe ky treg nuk ka nevojë per nderhyrje te tjera pasi tregon shenja maturimi te plote, zhvillon nje konkurrence efektive dhe garanton perfitime te konsiderueshme per konsumatorin fundor.

29. AKEP, me te drejte ne dokumentin e analizes se tregut (faqet 67-70) paraqet se cmimi mesatar per minute i thirrjeve celulare (APPM) ne Shqiperi eshte dy here me i ulet se mesatarje e vendeve te BE dhe nder me te uletat ne rajon (0.1 krahasuar me 0.05 Euro per minute pa TVSH). Ne vazhdim,

treguesit e te ardhurave te fitimit per dy operatoret me te hershem ne treg, Vodafone Albania dhe AMC, (njekohesisht mbajtes te autorizimeve 3G), kane pesuar renie te ndjeshme ne vitet 2009-2011 si ne terma absolute dhe ne terma relative te normave te fitimit. Kjo tendence eshte ne drejtim te kundert me tendencen ne rritje te ketyre treguesve deri ne vitin 2008 (Analiza e tregut te telefonise celulare 2012, fq 68-69).

KONKLUZIONE:

- Vodafone Albania shprehet dakord me perfundimin e AKEP dhe rezultatet statistikore se te gjithë masat regullatore dhe uljet e vazhdueshme te tarifave nga Vodafone Albania per thirrje zanore, SMS dhe data, kane dhene efekte drejt synimeve qe ka pasur AKEP, ndaj cdo mase tjeter eshte e panevojshme dhe e pajustificuar.
- Portabiliteti i numrit, shtrirja e rjetit 3G per Vodafone dhe dhenia e autorizimit te 2te per keto frekuenca, penetrimi ne ngritje i aparateve smartphone dhe ulja e vazhdueshme e cmimeve qe ka aplikuar Vodafone ne nivel pakice po garantojne cdo dite e me shume cilesite shtuar dhe cmime ne ulje per konsumatorët shqiptare.

Pergjigje e Eagle Mobile:

Eagle Mobile gjykon se rritja e konkurrencës në tregjet me pakicë është e kufizuar. Edhe nga treguesit e marrë në konsideratë nga AKEP vihet re shumë qartë se Eagle Mobile nuk ka rritje të të ardhurave nga viti 2010 në vitin 2011, nga ana tjetër operatori Vodafone Albania ka rritje të konsiderueshme të të ardhurave duke arritur masën 52% dhe dominuar tregun. Pra, nuk kemi rënie të të ardhurave dhe normave të fitimit të dy operatorëve të mëdhenj, por përkundrazi rënia shihet te operatorët e vegjël. Dhe për më tepër kjo ndodh në kushtet kur tarifatat e pakicës të shërbimeve të Eagle Mobile janë më të ulëta se ato të operatorëve të mëdhenj.

Ne mbështesim AKEP dhe iniciativat për implementimin e portabilitetit të numrit dhe shërbimeve 3G në Shqipëri, të cilat janë në radhë të parë shërbime nga të cilat përfiton pajtimtari, të cilit i ofrohet një shërbim cilësor dhe mundësi zgjedhjeje. Megjithatë, në lidhje me implementimin e këtyre shërbimeve në Shqipëri, do të donim të theksonim sa më poshtë:

Për sa i përket portabilitetit të numrit, megjithëse është një proces që shoqërohet me përthithjen e abonentëve të operatorëve të mëdhenj nga operatorët e vegjël, kjo nuk ka ndodhur në Shqipëri, për shkak të mungesës së masave rregullatore proporcionale dhe diferencimit të madh të tarifave on-net/off-net nga operatorët e mëdhenj, diferencim i cili çon në kufizimin e tregut dhe rrezikun e përjashtimit nga tregu të operatorëve të vegjël.

Ndërkohë, edhe ofrimi i shërbimeve 3G nga AMC dhe Vodafone është avantazh për këta dy operatorë në konkurrencën në retail. Duke pasur parasysh situatën aktuale të tregut të komunikimeve elektronike dhe pozitën e hyrësve të rinj, Eagle Mobile konsideron të justifikueshme dhe në favor të zhvillimit të konkurrencës, dhënien e sëtë drejtës të përdorimit për shërbimet 3G pa pagesë për Eagle Mobile

Pergjigje e Plus Communicatios:

Analizat dhe rezultatet janë rrjedhojë e kushteve të tregut pas hyrësve të rinj, kushtet ekonomike dhe risitë teknologjike dhe shërbimet e reja.

Konkluzioni i AKEP në lidhje me rritjen e konkurrencës dhe treguesit e marrë në konsideratë megjithëse përfshin disa elemente të rëndësishëm si rritja e MOU dhe ulja e fitimit për operatorët e mëdhenj nuk merr në konsideratë që rënia e këtyre fitimeve dhe rritja e MOU nuk vjen si pasoje e hyrjes në treg të operatorëve të rinj Eagle Mobile dhe PLUS, por si pasoje e uljes së komunikimit jashtë rrjetit duke rritur komunikimin brenda rrjetit. Kjo ka sjellë edhe rritjen e ofertave të cilat krijojnë një ndarje fraksionale të tregut.

Gjithashtu një faktor shumë i rëndësishëm i cili nuk reflektohet është edhe krijimi i një avantazhi në treg për dy operatorët e mëdhenj të cilët kanë përfituar licensat e 3G duke krijuar një konkurrencë jo të drejtë si pasojë e vonësës së vendimarrjes për licensat 3G për operatorët Eagle Mobile dhe PLUS.

Pergjigje e NEOFONE:

Ky konkluzion nuk është plotësisht i sakte. Përdoruesit nuk kanë patur përfitim të drejtë përdrejt nga nderhyrja e AKEP në tarifën e tregjeve me shumicë, pasi tarifën e thirrjeve Off-net nuk janë ulur nga operatorët mobile duke detyruar përdoruesit të kenë me shumë se 2 numra mobile dhe dy aparate mobile për të realizuar thirrjet on-net. Këto kosto janë të konsiderueshme kur marrim parasysh uljen e tarifave të shumicës dhe mosreflektim të këtyre uljeve për abonentët fundorë. Nisur nga ky arsye tregu nuk është në konkurrencë të pastër por në konkurrencë të dakortësuar oligopolistike.

Qendrimi AKEP:

AKEP shpreh dakortësinë e tij në përgjithësi me komentet e bëra nga operatorët si dhe i qendron mendimet se tregu i pakicës ka njohur rritje të nivelit të konkurrencës, është në një dinamikë të vazhdueshme në këtë drejtim, por referuar komenteve të AMC dhe VF, AKEP mban parasysh faktin që tendenca gjithnjë e më rritje e konkurrencës efektive, nuk do të thotë që konkurrenca efektive ka arritur në stacionin e fundit të saj, kështu që misioni i AKEP do të jetë monitorimi i vazhdueshëm i treguesve të konkurrencës në këtë treg, duke mos përjashtuar çdo masë të nevojshme rregullatore në favorizimin e konkurrencës në këtë treg. AKEP gjykon se shqetësimet e EM (të dhëna edhe në komente për pyetje të tjera) dhe operatorëve të tjerë për tarifën on-net/off-net mund të adresohen në një moment tjetër me një analizë më të detajuar të efekteve pozitive dhe negative në konkurrencën në tregun me pakicë dhe hipotezat për sjellje të mundshme antikonkurrese të operatorëve të mëdhenj, mbase edhe në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës.

9. A jeni dakort me perfundimin e AKEP se tregu me shumicë i akses dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare nuk është me treg i justifikueshem për nderhyrje ex-ante? Cfare mendoni për arsyetimin e përdorur, testin e tre kritereve?

Pergjigje e AMC:

Tregu i akses/originimit nuk eshte me pjese e listes se tregjeve te justifikuar per nderhyrje rregullatore ex-ante ne Rekomandimin e BE-se te vitit 2007. Pra, si i tille, duke u bazuar ne kete Rekomandim, nuk eshte e nevojshme qe te ndermerrej nje analize ne lidhje me kete treg per te verifikuar nese mund te kete ose jo operatore me FNT, si pasoje e problematikave qe mund te lindin nga mungesa e konkurrences ne kete treg.

Konkurrenca ne nivelin retail ka qene e larte dhe ne periudhen e analizes se meparshme te tregut, duke u rritur gjithnje e me shume dhe ne periudhen ne vazhdim, sic kemi permendur dhe me siper, dhe keto rrethana provojne qarte faktin qe nje analize e tille rezulton e panevojshme.

Gjithsesi, pavaresisht nismes se AKEP per ndermarrjen e nje analize te tille nepermjet testit te tre kriterave per te verifikuar nese nje treg i tille eshte konkurues ose jo, ne pershendesim perfundimin e AKEP per pranine e konkurrences, dhe jemi dakort me faktin qe ky treg nuk eshte i justifikueshem per nderhyrje ex-ante.

Prania e konkurrences ne treg tashme eshte e qarte dhe shume evidente, si ne terma te numrit te operatoreve qe veprojne ne treg, ne nivelin e ulet te tarifave per konsumatorin, ne barrierat e uleta per hyrjen ne treg, pasi si nga ana legale, si nga ana strukturore, si nga ana komportamentale, nuk vihen re barriera per pengimin e hyrjes ne treg te operatoreve te rinj.

Justifikimi per nderhyrje ex-ante ne kete treg nuk ka ekzistuar as ne analizen e meparshme te tregut, dhe vendosja e detyrimeve rregullatore si pasoje e statusit me FNT ne kete treg, i ka shkaktuar kosto shtese operatoreve perkates ne aplikimin e tyre.

Ne kemi shprehur dhe me pare konsideratat tona ne lidhje me tregun e akses/originimit si nje treg ende jo i zhvilluar ne Shqiperi, pasi edhe ata operatore sic jane MVNO, qe mund te kerkonin akses per originimin e thirrjeve, nuk ekzistojne ne vendin tone, dhe akses i kryesisht kerkohet per sherbimet me vlere te shtuar.

Keshtu qe perdorimi i testit te tre kriterave nuk eshte i bazuar dhe i nevojshem ne nje treg te tille, ne menyre qe te arrihen ne konkluzionet perfundimtare per heqjen e detyrimeve per operatoret me FNT ne kete treg.

Heqja e statusit me FNT dhe e detyrimeve eshte nje mase e drejte qe mendon te ndermarre AKEP, por qe per te arritur ne kete konkluzion nuk ishte i nevojshem aplikimi i testit te tre kriterave per te provuar dicka te tille.

Pergjigje e Vodafone :

30. Vodafone Albania shprehet se tregu i akses originimit eshte nje treg konkurues dhe i perjashtuar nga lista e tregjeve te rekomanduar ne BE per rregullim paraprak, ndaj dhe nuk eshte i justifikuar per rregullim ex-ante nga AKEP.
31. Eksperienca e pothuajse te gjithe vendeve Europiane eshte ne unison per mos -rregullim te ketij tregu; shtetet anetare, ose kane ndjekur Rekomandimin e vitit 2007 duke mos e perfshire asnjehere si pjese e rregullimit paraprak tregun e akses originimin, ose ne ato pak raste qe kane

tentuar ta rregullojne, jane terhequr pas shume shpejt ose vendimet e tyre jane rrezuar ne shkallet me te larta administrative ose gjyqesore.

32. Tregu i akses origjinimit eshte plotesisht konkurrues pasi nuk shfaq asnje shenje dominance apo pengimi konkurrence. Mbi te gjitha ne kete treg ka mungese te kerkeses – nuk jane paraqitur subjekte te interesuar per aktivitet MVNO, pasi tregu eshte i maturuar nga prezenca e 4 operatoreve celulare, si rrallehere per nje popullsi kaq te vogel. Kur tregu eshte konkurrues dhe i nenshtrohet forcave oferte-kerkese, AKEP absolutisht nuk duhet te nderhyrje pasi keshtu cenon te gjitha ekuilibrat e tjere. Praktika e tregut, perfshire periudhen 2 vjecare te rregullimit, tregoi qartesisht qe rregullimi eshte i panevojshem per mungese te kerkeses ne treg. Sot qe flasim, Vodafone Albania ka lidhur marredhenie per ofrim sherbimi te kartes me parapagim vetem me nje operator alternativ, pavaresisht se ka mbi 2 vjet qe mban detyrimin per hapjen ne treg dhe ofrimin e sherbimit ndaj paleve te treta. Nderkohe qe theksojme se gjate gjithes kesaj kohe, perfshire edhe para periudhes se rregullimit (Mars 2010) nuk eshte regjistruar asnje kerkese e vetme per veprimtari MVNO ne rrjetin tone.
33. Per gjithes sa me lart, AKEP duhet qe te zbatoje percaktimet e Ligjit 9918, Rekomandimet e Bashkimit European dhe te ndjeke praktiken e te gjithes shteteve anetare, duke e hequr kete treg nga lista tregjeve per rregullim paraprak, si i pajustificuar ne ligj dhe ne analize ekonomike.
34. Per sa i takon testit te 3 kriterëve, Vodafone Albania mbeshtet perfundimin e AKEP qe tregu me shumice i aksesit dhe origjinimit te thirrjeve ne rrjetet celulare nuk ploteson testin e 3 kriterëve dhe nuk konsiderohet si treg i justifikueshem per nderhyrje ex-ante;

Testi i 3 kriterëve - Mungesa e barrierave te larta dhe jo-kalimtare te hyrjes

35. Pjeset e tregut, kur gjenden 4 operatore celulare (si rast unikal ne rajon duke konsideruar numrin e popullsisë) tregojne pikerisht mungesen e barrierave dhe lehtesine e hyrjes ne treg; operatori Plus Communication gjendet ne treg prej nje kohe te shkurter dhe sipas shifrave te AKEP zoteron rreth 8% te tregut te perdoruesve. Rritje ka pesuar gjithashtu edhe operatori i 3te i hyre ne treg, Eagle Mobile, nderkohe qe pjeset e tregut te dy operatoreve fillestare jane ulur. Nga ana tjetere, Vodafone Albania shprehet se pjeset e tregut te Vodafone dhe AMC ne tregun e shitjes me pakice, si me te medha se dy operoret e tjere, mund te jene informuese per AKEP mbi strukturen e tregut me shumice, por ato nuk mund dhe nuk duhet qe te konsiderohen si thelbesore per gjetje te dominances ne tregun e shitjes me shumice. Ky eshte dhe qendrimi qe ka mbajtur Komisioni European²⁸ ne ceshtjen ndaj Autoritetit Rregullator ne Irlande (ComReg) kur ky i fundit ne nje situate tregu te ngjashme gjeti operoret Vodafone Ireland dhe O2 si FNT ne tregun me shumice te aksesit dhe origjinimit te thirrjeve nepermjet rrjeteve celulare. Ky vendim i ComReg mbi percaktimin e dy operatoreve si FNT ne tregun me shumice te aksesit dhe origjinimit u rrezua nga organi ankimor kombetar.

Testi i 3 kriterëve - Struktura e tregut, Mungesa e ofruesve te tjere te sherbimeve ne nivelin me pakice (ofrues te pavaruar sherbimesh MVNO) dhe cmimet

36. Vodafone Albania shprehet se mungesa e operatoreve virtuale te rrjeteve te levizshme (MVNO) eshte pasojee maturimit te tregut nga prezenca e 4 operatoreve celulare. Ndaj nuk ekzistojne

²⁸Komente te Komisionit European mbi ceshtjen Case IE/2004/0121: Aksesi dhe origjinimi ne rrjetet e telefonise se levizshme publike ne Irlande, Janar 2005

incentiva ekonomike per hyrjen e nje operatori MVNO. Megjithate, eshte cmimi faktori kryesor qe mund te nxise nevojën per rregullim, dhe jo mungesa e MVNO. Parimet baze te konkurrencës orientojne qe masat mund te merren ne rast se niveli i cmimeve te telefonise celulare ne kete treg eshte me i larte se nje nivel mesatar i cmimeve ne BE. Thelbi i konkurrencës eshte mireqenia e konsumatoreve, nepermjet cmimeve me te ulta dhe jo detyrimisht mbrojtja apo perkrahja e lojtareve te vegjel apo shtysa ndaj operatoreve inekzistente. Kjo tregon se mungesa e MVNO nuk vjen si pasoje e sjelljes antikonkurrese te operatoreve ekzistues ne treg, por mungeses se incentives ekonomike ne kete drejtim.

Testi i 3 kriterëve - Ligji i konkurrencës eshte i mjaftueshem, nuk ekziston mundesia per koordinim mes operatoreve

37. Cdo mundesi hipotetike per koordinim, pretendim ky i ngritur me heret nga AKEP ne analizen e vitit 2010 por rrezuar tanime, eshte plotesisht e pamundur. Mbeshtetur ne kuadrin rregullator te BE-se implementuar dhe ne Shqiperi vertetimi i koordinimit kerkon: *1. vertetimin e incentives per te koordinuar, 2. mundesine konkrete per te koordinuar, 3. mundesine per te detektuar mashtrimin dhe 4. ekzistencen konkrete te nje mekanizmi ndeshkimi.*²⁹

- *Incentiva per koordim kerkon qe te kete pak firma ne treg - ne treg tani ndodhen 4 operatore. Ky numer operatoresh eshte mese i mjaftueshem per te promovuar konkurrence reale, bazuar dhe ne eksperiencen europiane. Gjithashtu, vete te dhenat e Analizes flasin per konkurrence reale te ketyre 4 operatoreve celulare.*
- *Mundesia konkrete per te koordinuar - ky faktor duhet analizuar nen dy drejtime: koordinim per cmimin ekzistent netregun me shumice te akses origjinimit si dhe koordinimin per refuzimi per te dhene akses. Persa i perket cmimit ai eshte konkurrues, ndersa ne lidhje me refuzimin per akses dhe ky nuk qendron si argument -nuk ka operatore ekzistente te tille ne treg te cilet te kene kerkuar akses te Vodafone Albania dhe t'u jete refuzuar.*
- *Mundesia per te detektuar mashtrimin dhe ekzistenca enje mekanizmi ndeshkues -ne rastin konkret nuk ekzistojne veprime nga ana e Vodafone Albania per te refuzuar akses apo per te ndeshkuar operoret qe mund t'u jepet akses, pasi nuk ka pasur asnjehere kerkese te tille*

38. Sic edhe AKEP ka konstatuar, apo bazuar edhe ne eksperiencen e vendeve te BE, nje treg me pakice konkurrues eshte pasqyre e ekzistences se konkurrencës ne tregun e akses origjinimit dhe nje arsye thelbesore per te mos e rregulluar tregun e akses origjinimit. Ndaj dhe testi i 3 kriterëve, nuk qendron per asnjerin prej tyre ne rastin e tregut me shumice te akses origjinimit.

KONKLUZIONE:

Per te gjithë keto arsye, Vodafone Albania shprehet se:

- Mbeshtet analizen korrekte te AKEP ne arritjen e perfundimit se ky treg duhet hequr nga lista tregjeve per rregullim paraprak (ex-ante).

²⁹ Keto kriterë jane percaktuar nga Vendimi i Gjykates Europiane te Shkalles se Pare ne gjykimin Airtours v Komisioni European case T-342/99

- Tregu i akses origjinimit është një treg konkurrues dhe i përjashtuar nga lista e tregjeve të rekomanduara në BE për rregullim paraprak, ndaj dhe nuk është i justifikuar për rregullim ex-ante nga AKEP
- Eksperiencia e pothuajse të gjithë vendeve Europiane është në unison për mos –rregullim të këtij tregu;
- Tregu i akses origjinimit është plotësisht konkurrues pasi nuk shfaq asnjë shenjë dominancë apo pengimi konkurrence. Mbi të gjitha në këtë treg ka mundësi të kërkesës – nuk janë paraqitur subjekte të interesuar për aktivitet MVNO.

Pergjigje e Eagle Mobile:

Eagle Mobile e gjykon të parakohshëm përfundimin e AKEP se tregu me shumicë i akses dhe origjinimit nuk është më treg i justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante. Pavarësisht se ky treg është hequr nga lista e tregjeve të Rekomandimit të vitit 2007 të KE, ky treg është pjesë e listës së tregjeve të Rekomandimit 2003 të KE dhe situata aktuale në tregun e telefonisë së lëvizshme në Shqipëri është e tillë që justifikon ndërhyrjet rregullatore edhe për një periudhë tjetër kohore.

Në lidhje me aplikimin e testit të tre kritereve në këtë treg, nuk kemi dakord me përfundimin e AKEP mbi mos plotësimin e dy prej kritereve;

një strukturë tregu e cila nuk ka tendencë për të shkuar në drejtim të një konkurrence efektive brenda afatit kohor përkatës

Në lidhje me konkurrencën në treg, përmendim çështjet e trajtuara më sipër si rritja e pjesëve të tregut të operatorëve të mëdhenj përkundrejt pjesëve të tregut të operatorëve të vegjël, diferencimi i tarifave on-net/off-net të cilat nuk shkaktohen nga niveli i tarifave të terminimit, por vetëm si rezultat i strategjisë së operatorëve të mëdhenj për të rritur pjesët e tyre të tregut dhe nxjerrë nga tregu operatorët e vegjël, duke e çuar kështu tregun në mundësi të konkurrencës efektive. Gjithashtu edhe vetë fakti se të dy operatorët me status FNT në këtë treg nuk kanë pasur kërkesa nga MVNO është tregues se tregu nuk është në konkurrencë efektive

pamjaftueshmëria e ligjit të konkurrencës për të adresuar në mënyrë të përshtatshme dështimin e tregut të marrë në shqyrtim.

Eagle Mobile gjykon se në situatën aktuale në Shqipëri ky faktor përmbushet.

Pergjigje e Plus Comunicatios:

PLUS vlerëson punën e bërë nga AKEP mbi mbledhjen e të dhënave dhe përgatitjen e analizës së tregut. Të dhënat dhe vetë ky studim është i nevojshëm për raportimin e ecurisë së tregut të shërbimeve me shumicë.

Nga analiza del qartë pushteti që kanë në treg Operator me FNT dhe roli e tyre për të drejtuar tregun. Në këtë aspekt, AKEP nuk tregon shumë interes për operatorët e vegjël, të cilët janë duke u përpjekur për mbijetesë në treg, ndërkohë që sikundër del dhe nga analiza operatorët e vegjël i japin këtij tregu një konkurrencë më të mirë në favor të konsumatorit. Pavarësisht prej kësaj, këta operatorë trajtohen po njësoj në detyrime si dhe operatorët e fuqishëm në treg.

Persa i përket testit të tre kriterëve, vlerësimi i AKEP është i drejtë për këtë analizë tregu.

Pergjigje e NEOFONE:

AKEP ka detyrimin që të nderhyjë në të këto treg. Praktika e dy viteve të fundit ka treguar se operatorët mobile edhe me detyrimin e percaktuar nga AKEP kanë vonuar dhenien e shërbimit për akses dhe origjinim. AKEP duhet të vendosi detyrimin për dhenien e shërbimit të akses-origjinimit edhe për operatorët Eagle Mobile dhe Plus Communication. AKEP në muajin qershor 2012 ka dalë me urdher për të detyruar OFNT AMC për të ofruar këtë shërbim pasi për më shumë se 17 muaj nuk lejonte realizimin e ketyre shërbimi nga operatori Neofone. Rekomandimet e KE flasin qartë që çdo operator siç është me fuqi të ndjeshme në treg në tregun e terminimit është edhe tek ai i origjinimit. AKEP duhet gjithashtu të vendosi detyrimin për të ofruar shërbimin për Zgjedhjen dhe Parazgjedhjen e bartesit për operatorët mobil. Ky detyrim është vendosur gati në të gjitha vendet e BE dhe të rajonit. Ky detyrim do të ulte akoma më shumë tarifën për thirrjet off-net dhe nderkombetare të cilat vazhdojnë të jenë nga më të lartat në Europë. AKEP duhet të fillojë një konsultim publik për shërbim MVNO. Në mendim mos pasja e një rregulloreje ka penguar hyrjen e ketyre llojve operatorëve. Në Kosovë operojnë tashmë 2 operatorë MVNO dhe gjithashtu disa operatorë MVNO në vendet e rajonit.

Qendrimi AKEP:

AKEP shpreh konsideratë për komentet e bera dhe mban qëndrimin e prezantuar në fazën e konsultimit në lidhje me tregun e akses-origjinimit në nivelin e shumicës si dhe respektimin heqjes së detyrimeve të propozuara në fazën e konsultimit, sipas afatëve të dhëna.

10. Cilat janë komentet tuaja për propozimin e AKEP, që heqja e detyrimeve për FNT të AMC dhe Vodafone Albania të percaktuara me VKD nr.1210, datë 30.03.2011 dhe VKD nr.1211, datë 30.03.2010, të bëhet efektiv 6 muaj pas marrjes së vendimit nga AKEP për FNT në tregjet celulare, sipas dokumentit të analizës finale që do të publikohet pas konsultimit publik?

Pergjigje e AMC:

Heqja e detyrimeve per FNT, per AMC, te percaktuara me VKD nr.1210, dt.30.03.2010, eshte bere ne nje treg i cili, sic e kemi theksuar ne komentet e bera ne analizen e meparshme, ka qene nje treg ende jo aktiv ne momentin qe detyrimet per FNT jane vendosur nga AKEP.

Ne mendojme qe heqja e detyrimeve per FNT te AMC te percaktuara ne VKD nr.1210, dt.31.03.2010 te behet efektive menjehere pas marrjes se vendimit sipas analizes se bere ne tregun e akses/origjinimit te ketij konsultimi publik.

Normalisht, ashtu sic percaktohet dhe ne direktivat e BE-se (*Direct.2002/21, Art.16 "Market analysis procedure" p.3*), Autoritetet rregullatore duhet te deklarojne nje periudhe kalimtare, pas se ciles behet efektive heqja e detyrimeve per FNT ne perfundim te konsultimit publik. Kjo periudhe eshte e nevojshme per te monitoruar kushtet e tregut deri ne heqjen e detyrimeve perkatese per FNT nga ana e Autoritetit Rregullator per te shmangur ndonje konsekuence te mundshme te padeshirueshme qe mund te lindi si pasoje e heqjes se ketyre detyrimeve.

Ndersa ne rastin ne shqyrtim, tregu i akses/origjinimit nuk ka pasur probleme te mungeses se konkurrences ndermjet operatoreve, dhe per rrjedhoje heqja e detyrimeve per FNT duhet te jete e menjehershme pas marrjes se vendimit te AKEP.

Vendosja e nje periudhe 6 mujore pas marrje se vendimit nga ana e AKEP do te ishte e padrejte pasi: a) kushtet ne treg kane qene dhe jane teper konkurruese; b) berja efektive e heqjes se detyrimeve per FNT pas 6 muajsh nga marrja e vendimit nga AKEP do te na vendoste ne kushte me diskriminuese ne lidhje me dy operatoret e tjere Eagle dhe Plus te cilet nuk kane pasur statusin me FNT ne tregun e akses/origjinimit, pasi do te ishte nje barre e teper.

Nje arsyetim i ngjashem mund te gjendet dhe ne dokumentin "*ERG (09) 40 on Transition from sector-specific regulation to competition law*", ne faqjen 12 te te cilit citohet:

"On the other hand, once the market has been deemed to be effectively competitive, an inappropriate notice period may limit the ability of the (former) SMP operator to operate on an equal footing with its competitors."

Ne te njejtin dokument te referuar ne paragrafin pak me siper (*ERG (09) 40, fq.13*), permenden dhe situate ne te cilat heqja e detyrimeve mund te jete e menjehershme pas perfundimit te konsultimit publik dhe marrjes se vendimit nga autoriteti rregullator perkates:

"...On the other hand, and depending on national law, in some instances the immediate withdrawal of obligations upon publication of the market analysis (thus, without setting a period of notice) may be found to be "reasonable" depending on the factual circumstances. An example of this might be if the existing obligations on the SMP operator had no direct or immediate effects on alternative operators, then consumers should not be adversely affected by the removal of the obligations. Another example might be when the existing obligations are "soft" as the proportional result of competitive market problems..."

Lenia e nje periudhe 6 mujore do te krijonte nje situate te padrejte, ndonese dhe e perkoheshme, qe shtremberon konkurrencen e ndershme pasi favorizon disa operatore dhe rendon me teper operatoret e tjere, mbi te cilet jane vendosur me pare keto detyrime.

Ne perfundim te konsideratave tona ne lidhje me kete ceshtje, ne nuk jemi dakort per nje prozim te tille nga ana e AKEP dhe mendojme qe heqja e detyrimeve per FNT te AMC te percaktuara ne VKD nr.1210, dt.31.03.2010 te behet efektive menjehere pas marrjes se vendimit sipas analizes se bere ne tregun e akses/origjinimit te ketij konsultimi publik.

Pergjigje e Vodafone :

1. Vodafone Albania mbeshtet qendrimin e AKEP dhe sugjeron qe heqja e detyrimeve si pasoje e statusit OFNT ne tregun me shumice te akses origjinimit, te hyje ne fuqi sa me shpejt te jete e mundur, menjehere pas miratimitte Analizes perfundimtare.
2. Tregu me shumice i akses origjinimit nuk eshte pjese e Rekomandimitte vitit 2007 te Bashkimit European dhe nuk aplikohet nga autoritetet rregullatore ne vendet anetare. Ne keto kushte, Vodafone Albania mbeshtet propozimin qe AKEP duhet te heqe tregun e akses origjinimit nga lista e tregjeve te rregulluar dhe per rrjedhoje te heqe dhe cdo detyrim qe vjen si pasoje e ketij rregullimi nga Vodafone Albania, si i pambeshtetur ne akte rregullatore dhe i tepert ne kushtet e nje tregu plotesisht konkurrues.

Pergjigje e Eagle Mobile:

Në vijim të sa më lart, Eagle Mobile e gjykon të parakohshme heqjen e detyrimeve për FNT të AMC dhe Vodafone 6 muaj pas marrjes së vendimit të AKEP sipas dokumentit të analizës finale. Eagle Mobile gjykon se Vodafone dhe AMC duhet të vazhdojnë të jenë dy operatorët me FNT në këtë treg deri në ndryshimin e kushteve aktuale të tregut.

Pergjigje e Plus Communicatios:

AKEP gjykon në fillim të analizës, se sipas përcaktimit të statusit FNT sipas kriterit të tregut përkatës dhe detyrimet që lindin më tej, kjo duhet të jetë e vlefshme për çdo operator. Kushtet e tjera dhe detyrimet e tjera të mbeten standarte.

AKEP duhet të arsyetojë përse shikohet mundësia e heqjes së detyrimeve për FNT vetëm për Vodafone dhe AMC.

Pergjigje e NEOFONE:

Ky propozim i AKEP nuk është i bazuar dhe në kundërshtim me praktikën e BE sic është shpjeguar edhe më lart. Ky detyrim duhet të mbetet në fuqi si dhe të aplikohet edhe për Operatorët Eagle Mobile dhe Plus Communications.

Qendrimi AKEP:

AKEP shpreh konsiderate për komentet e bera dhe mban qëndrimin e prezantuar në fazën e konsultimit në lidhje me tregun e akses-origjinimit në nivelin e shumicës si dhe respektimin heqjes së detyrimeve të propozuara në fazën e konsultimit, sipas afatëve të dhëna, duke lënë në

fuqi detyrimet aktuale ne kete treg per nje periudhe 6 mujore nga momenti i marrjes se vendimit mbi dokumentin perfundimtar te kesaj analize. Per sa i perket komenteve te Plus, AKEP sqaron se per AMC dhe Vodafone po hiqen vetem detyrimet per akses dhe origjinimin, pasi vetem keta dy operatore kane pasur detyrime per kete sherbim.

11.A e gjykoni te arsyeshme aplikimin e nenit 51 per te kater operatoret celulare per dhenie akses per operatoret e kartave me parapagim dhe per thirrjet drejt numrave 0800 dhe me tarifa origjinimi sipas vlerave te skedarit kohor te percaktuar ne Shkurt 2011 per orientimin ne kostot BULRAIC? A duhet zhvilluar nje konsultim publik i vecante per keto ceshtje?

Pergjigje e AMC:

Aplikimi i nenit 51 per dhenie akses per operatoret e kartave me parapagim dhe per thirrjet drejt numrave 0800 gjykojme qe eshte i arsyeshem ne nje treg konkurrues dhe detyrimi per dhenie akses do te ishte i arsyeshem.

Megjithate mund te themi se AKEP nuk ka ndermarre nje studim te detajuar ne lidhje me kostot e origjinimit te thirrjeve drejt numrave 0800, mbi bazen e te cilave percaktohen tarifat perkatese, dhe kemi te bejme me nje treg i cili nuk ben pjese ne listen e tregjeve te justifikuar per nderhyrje rregullatore ex-ante sipas Rekomandimit te BE-se te vitit 2007.

Megjithate nje konsultim publik i vecante per keto ceshtje mund te ndermerret dhe te shikohen kostot e akses origjinimit dhe pas kesaj te imponohen masat rregullatore per akses drejt numrave 0800.

Pergjigje e Vodafone :

39. Vodafone Albania shprehet se AKEP nuk duhet te vendose asnje detyrim rregullator mbi operatoret e telefonise celulare persa i takon ofrimit te sherbimit te akses origjinimit. Tregu i akses origjinimit eshtejashte Rekomandimit te Komisionit European, dhe eshte gjykuar si i panevojshem per tu rregulluar paraprakisht. Per rrjedhoje AKEP nuk duhet te marre asnje mase detyruese mbi operatoret ne treg. Detyrimet mund te vendosen mbi operatoret vetem ne rast te shpalljes se nje tregu jo konkurrues dhe kur operatoret pjesemarres ne te te percaktohensi FNT.

40. Tregu i akses origjinimit eshte plotesisht konkurrues pasi nuk shfaq asnje shenje dominance apo pengimi konkurrence. Mbi te gjitha ne kete treg ka mungese te kerkeses - nuk jane paraqitur subjekte te interesuar per aktivitet MVNO,pasi tregu eshte i maturuar nga prezenca e 4 operatoreve celulare, si rrallehere per nje popullsi kaq te vogel. Prandaj Vodafone Albania thekson se nuk justifikohet per asnje cast vendosjae detyrimeve rregullatore. Kur tregu eshte konkurrues dhe i

nenshtrohet forcave oferte-kerkese, AKEP absolutisht nuk duhet te nderhyrje, qofte edhe ne menyre te pjesshme duke percaktuar 1 ose 2 masa detyruese, pasi keshtu cenon te gjithe ekuilibrat e tjere.

41. Praktika e tregut, perfshire periudhen 2 vjecare te rregullimit, tregoi qartesisht qe rregullimi, eshte i panevojshem per mungese te kerkeses ne treg. Sot qe flasim, Vodafone Albania ka lidhur marredhenie per ofrim sherbimi te kartes me parapagim vetem me nje operator alternativ, pavaresisht se ka mbi 2 vjet qe mban detyrimin per hapjen ne treg dhe ofrimin e sherbimit ndaj paleve te treta. Nderkohe qe theksojme se gjate gjithe kesaj kohe, perfshire edhe para periudhes se rregullimit (Mars 2010) nuk eshte regjistruar asnje kerkese e vetme per veprimtari MVNO ne rjetin tone.
42. Vodafone Albania shprehet dakord qe AKEP mund te investohet rast pas rasti ne qofte se do te kete mosmarreveshje mes operatoreve per ceshtje akses-origjinimi, pa qene absolutisht e nevojshme vendosja e masave rregulluese paraprake.
43. Nga ana tjeter, Vodafone kundershton fuqimisht aplikimin e tarifave sipas analizes BULRAIC, te cilat ne vetvete reflektojne kostot qe operatore hasin per terminimi thirrjesh, dhe jo ne rastin e origjinimit. Per me teper, tarifat e akses origjinimit per asnje cast nuk jane konsultuar me operoret paraprakisht dhe si te tilla nuk duhet te aplikohen. Ulja e tarifave fundore te perdoruesve te Vodafone Albania nepermjet rritjes se konkurrences, si objektivi kryesor i AKEP, nuk arrihet duke rregulluar tregun e shumices per akses origjinimin. . Ndaj dhe Vodafone Albania konsideron se ndermarrja e masave te tjera ne tregun e akses origjinimit eshte plotesisht e papershtatshme, e panevojshme dhe e pajustificuar

KONKLUZIONE:

Per gjithe sa me lart, Vodafone Albania shprehet se:

- Nuk eshte e nevojshme te kryhet nje analize e vecante apo nje keshillim publik per nje treg qe nuk rekomandohet per rregullim ne BE. AKEP duhet te ndjehet e zbatohet keto rekomandime, ashtu sic edhe Ligji 99/18 percakton ne nenen perkatese te tij.
- AKEP nuk duhet te vendose asnje detyrim rregullator mbi operoret e telefonise celulare persa i takon ofrimin te sherbimit te akses origjinimit, pasi ky treg nuk eshte subjekt rregullimi
- Tregu i akses origjinimit eshte plotesisht konkurruar pasi nuk shfaq asnje shenje dominance apo pengimi konkurrence. Mbi te gjitha ne kete treg ka mungese te kerkeses - nuk jane paraqitur subjekte te interesuar per aktivitet MVNO
- AKEP mund te investohet rast pas rasti ne qofte se do te kete mosmarreveshje mes operatoreve per ceshtje akses-origjinimi.

Pergjigje e Eagle Mobile:

Eagle Mobile konsideron se neni 51 nuk duhet te aplikohet per te katër operatorët celularë për dhënie aksesit për operatorët e kartave me parapagim dhe për thirrjet drejt numrave 0800. Siç u përmend edhe më lart, tregu nuk është në konkurrencë efektive dhe dominohet nga dy operatorët e mëdhenj dhe nuk mund të aplikohen detyrime të njëjta për të katër operatorët celularë.

Pergjigje e Plus Comunicatios:

Në lidhje me aplikimin e nenit 51 për të katër operatorët celularë për dhënie e aksesit për operatorët e kartave me parapagim si dhe për thirrjet drejt numrave 0800, PLUS është i

mendimit që të jetë pjesë e një konsultimi publik të vecante, pasi këta operatorë krijojnë një treg në vetvete dhe nuk është e arsyeshme të futen si pjesë e analizës së tregut celular.

Për më tepër dhënia e aksesit për operatorët e kartave me parapagim si dhe drejt numrave 0800 mund të sjellë rrezik në tregun celular për faktin se mund të sjellë re-route të thirrjeve duke sjellë një efekt negativ në përdorimin e shërbimeve nga ana e përdoruesve celularë.

Gjithashtu, duhet parë nëse është teknikisht e mundur që operatorët celularë të ofrojnë një shërbim të tillë. Më tej të përcaktohen kushtet e tjera dhe tarifatat respektive.

Në bazë të nenin 51, arsyet për të dhënë akses nuk mbushin kriteret për të ofruar këtë lloj shërbimi, sipas të cilit, megjithëse një sipërmarrës është i autorizuar nga AKEP për të ofruar këtë shërbim, nuk do të ndikojë, ose nuk është e nevojshme për të siguruar funksionimin normal të rrjeteve, apo nuk ndikon në plotësimin e angazhimeve ndërkombetare. Operatorët celularë kanë kapacitetet e duhura dhe detyrimet sipas autorizimit, për të ofruar këto shërbime.

Pergjigje e NEOFONE:

Po, tarifatat e thirrjeve për origjinimin duhet të jenë të njëjta me ato të terminimit pasi përdoren të njëjtat kapacitete duke ngarkuar të njëjtat kostot për operatorët mobile. KE shprehet qartë tek kjo pikë ku tregu i origjinimit dhe terminimit të thirrjeve duhet të trajtohen njësoj. Nuk ka asnjë praktikë që të diferencojë këto dy shërbime në lidhje me tarifën. Nuk mendojmë se duhet bërë një konsultim publik në lidhje me këto tarifatat pasi kostot e këtij shërbimi janë po të njëjtat si ato të terminimit.

Komente të Alban Tirana Nascendo

Duke qenë se komentet e Operatorit Alban Tirana Nascendo nuk kanë të njëjten strukturë si komentet e sjella nga operatorët e cituar më sipër, sipas pyetjeve të hartuara nga AKEP, por kryesisht janë komente të natyrës së përgjithshme dhe kanë në fokus nderveprimin e kartave me parapagim, atëherë gjykojmë të jenë të shkeputura nga struktura e paraqitur më sipër, duke mbajtur një qendrim për komentet në teresi të Alban Tirana Nascendo dhe konkretisht:

Kompania Alban Tirana Nascendo AI shpk, përgezon për punën voluminoze të bërë si dhe për tendencën që me vendime ligjore të mbështetura në analiza konkrete të detyrojnë kompanitë celulare të ulin tarifatat në të mirë dhe në interes të konsumatorëve.

Por përse u përket kartave të parapaguara me qellim ose pa qellim është lënë evazive pavarësisht se ato janë një realitet dhe ekzistojnë jo vetëm në Shqipëri por në të gjitha tregjet ndërkombetare.

Për ne është e pakuptimte se si në këto kuader rregullator nuk merret parasysh aksioma **shkak-pasoje** pasi nga origjinimi lind terminimi. Terminimi në këto studim është i rregulluar ndërsa segmenti tjetër origjinimit është i parregulluar. Kjo ndoshta edhe padrejtesish ose është bërë për të mos u rënë ndesh disa vendimeve të meparshme të AKEP.

Do ishte mirë që edhe tarifa e origjinimit të ishte objekt i rregullimit për të mos ngjallur asnjë lloj keqkuptimi ose konflikti mes nësh dhe operatorëve celular.

Por edhe nese AKEP nuk e ben ate objekt te rregullimit te pakten duhete te percaktoje regulla te qarta dhe strikte per caktimin e cmimeve per tarifat e origjinimit te thirrjeve me karte te parapaguar, kjo pasi kompania jone ka ndeshur ne veshtiresi te jashtezakonshme ne komunikimet me FNT e reflektuar kjo edhe ne ankimmete e herepashershem ne AKEP.

Duhete te theksojme se operatoret FNT (Mobile) ne Shqiperi nuk kane sjellje aspak miqesore dhe as ligjore me operatoret e vegjel perkundrazi edhe pse marreveshja mund te jete ne interes te dyanshem dhe ne interes te konsumatorit ato i refuzojne ato me indeferentizem. Mjafton te permendim ne sa raste AKEP ka detyruar kompanite mobile te lidhin marreveshje Interkoneksioni me operatoret e tjere, kjo jo se ka ardhur si mungese dokumentacioni apo teknike nga ana e operatorëve, por si nje refuzim i paster dhe i vetedijshem nga ana e kompanive mobile (fakte te mbledhura duke lexuar vendimet e KD referuar faqes web te AKEP)

Eshte e vertete qe ne KE referuar (Explanatory Note to Recommendation 2007/879/EC per tregjet perkates (C(2007) 5406), tarifate telefonise mobile rekomandohen te liberalizohet madje edhe terminimi jo vetem origjinimi, por mos te harrojme faktin e pakundershtueshem se cmimet ne BE jane shume here me te ulat se aktualisht ne Shqiperi. Ne raport paraqitet fakti se AMC dhe Vodafone kane mundesi te imponojne cmime me te larta se ne BE(faqe 54) tregon se jemi afer pozitive te monopolist nga ana e tyre dhe jo nje treg i liberalizuar.

Ne mendojme se per faktin qe tregu celular ka nje trend te larte ne vendin tone tarifate duhet te jene te kontrolluara dhe rregulluara nga nje autoritet si AKEP.

Ndaj eshte mundesia qe te mos lihet shteg per abuzim dhe diskriminim te kompanise sone te vihen rregulla te qarta.

Ne kete kuader ne propozojme;

1.Kompanite celulare ne Shqiperi(TE GJITHA) te shpallen FNT per tarifate e origjinimit te thirrjeve me karte te parapaguar dhe tarifa e origjinimit te jete e barabarte me ate te terminimit.

2.Te percaktohet qarte dhe pa lene asnje shteg per keqkuptim apo keqinterpretim tarifate per origjinimin e thirrjeve me karte te parapaguar mbi rrjetet celulare.

Qendrimi AKEP:

AKEP konsideron sherbimin e kartave te parapaguara si nje nder sherbimet qe ka ndikuar ne zhvillimin e konkurrences ne tarifate e thirrjeve telefonike, si nje mundesi shtese per konsumatorët e thirrjeve, ndaj ne vijimesi do te tregojne nje vemendje rregullatore te kujdesshme ne respekt te percaktimeve ligjore dhe akteve rregullatore ne fuqi. AKEP gjykon se aplikimi i nenit 51 do te ishte me i pershtatshem, nese kjo justifikohet si mase e nevojshme per rritjen e mundesive dhe perfitimeve maksimale te perdoruesve te sherbimeve ne tregun e komunikimeve elektronike celulare.

Gjithsesi duke qene se implementimi i detyrimeve sipas nenit 51 do te behej per here te pare nga AKEP, kjo kerkon nje analize te detajuar e cila mund te ndermerret ne nje faze te mevonshme kur te konsiderohet e arsyeshme nga AKEP. Gjithsesi, AKEP siguron operatoret se cdo hap i ri qe mund te ndermerret ne kete drejtim do jete ne nje bashkerendim veprimesh me operatoret dhe transparent sipas praktikave me te mira te ndjekura edhe nga rregullatore te tjere ne kete drejtim.